Stoku i borxhit të jashtëm të Shqipërisë ka zbritur në 61.6% ndaj PBB-së nominale në nëntëmujorin e vitit 2019. Nga pikëpamja e qëndrueshmërisë, treguesit e aftësisë ripaguese afatgjatë të borxhit të jashtëm të Shqipërisë janë përmirësuar gjatë periudhave të fundit.

Në fund të vitit 2019, rezervat valutore bruto shënojnë nivelin 3,360 milionë euro ose rreth 24.5% e PBB-së. Tregues të mjaftueshmërisë së rezervës tregojnë se ato janë të mjaftueshme për të mbuluar 6.6 muaj importe mallrash dhe shërbimesh dhe 155% të borxhit të huaj afatshkurtër, duke qenë ndjeshëm mbi nivelet kritike.


Mbiçmimi i lekut i vërejtur vitet e fundit, pasi kulmoi në fund të vitit 2018, filloi të reduktohet në mënyrë të qëndrueshme gjatë vitit 2019. Kjo dinamikë u diktua nga zhvillime më pak të favorshme në sektorin e jashtëm të ekonomisë krahasuar me vitet e mëparshëm. Në terma nominalë efektivë, mbiçmimi i lekut zbriti në 1.9% në dhjetor të vitit 2019, nga 10.2% që ishte në dhjetorin e kaluar. I njëjti trend shihet edhe në kursin euro/lek, ku mbiçmimi vjetor i lekut ra në 1.0% në dhjetor, nga 7.4% që ishte në fund të vitit 2018. Presionet e forta mbiçmuese të shfaqura gjatë vitit 2018 u pakësuan gjatë vitit në vazhdim dhe luhatjet në tregun valutor duket të jenë normalizuar. Ndërhyrja e Bankës së Shqipërisë, vitin që kaloi u ndërmor në kohën e duhur dhe rezultoi efektive. Gjatë vitit 2019, luhatshmëria në tregun valutor ka qenë e ulët dhe mbiçmimi i lehtë i lekut kundrejt euros ka qenë në linjë me sjelljen sezonale të kursit.

Kredia për sektorin privat ka vijuar të rikuperohet gjatë vitit 2019, në përputhje me pritshmëritë. Deri në muajin nëntor, ky portofol është zgjeruar mesatarisht me 6.9% në terma vjetorë, rreth 1.7 pikë përqindjeje më shumë se në vitin 2018. Ndryshe nga viti 2018, kontribuesi kryesor në rritjen e kredisë gjatë këtij viti ka rezultuar kredia për biznese (kryesisht për likuiditete),

⁵ Nënkomponentët përbërës të grupit të produkteve energjetike janë karburant për mjete personale transporti, lëndë djegëse (bombola gazi) dhe dru zjarri.

e cila ka kontribuar me rreth 4.7 pikë përqindjeje në këtë rritje. Kredia për individë vijon të shfaqet e qëndrueshme, mbështetur kryesisht nga kredia për blerje banese. Zgjerimi i kredisë për sektorin privat është nxitur më së shumti nga kredia në lekë, e cila shënoi rritje vjetore me 8.6% mesatarisht deri në muajin nëntor. Në fund të periudhës, kredia në monedhë vendëse përbën rreth 48.2% ndaj totalit të kredisë për sektorin privat, krahasuar me 42.6% tre vjet më parë.

Rritja më e shpejtë e kredisë reflekton si rritjen e kërkesës, ashtu edhe përmirësimin e kushteve të ofertës. Kjo e fundit është mbështetur nga primet e ulëta të rrezikut dhe rritja e konkurrencës në tregje si pasojë e procesit të konsolidimit të sistemit bankar. Raporti i kredive me probleme ka vijuar të ulet, duke arritur në 9.5% në muajin nëntor dhe duke regjistruar kështu një rënie me rreth 25% krahasuar me një vit më parë.



Burimi: Banka e Shqipërisë. *E dhëna më e fundit është në nëntor 2019.

Stoku i depozitave të rezidentëve ka shënuar rritje mesatare vjetore me rreth 4.4% deri në muajin nëntor. Zhvillimet në kahun e pasivit të sistemit bankar janë ndikuar nga zhvendosja e vazhdueshme e depozitave drejt dy ekstremeve në terma të maturitetit – depozitat pa afat (46.5% ndaj totalit) dhe depozitave me afat maturimi mbi dy vjet (13.4% ndaj totalit). Normat e ulëta të interesit kanë ndikuar në zhvendosjen e kursimeve drejt letrave me vlerë të qeverisë, edhe pse më pak e ndjeshme se një vit më parë. Depozitat e individëve mbeten kontribuesi kryesor në zhvendosjen e strukturës kohore të pasasë.

Në tërësi, kushtet financiare mbeten mbështetëse të rritjes së konsumit dhe të investimeve. Tregjet financiare karakterizohen nga norma të ulëta interesi, prime rreziku në rënie dhe likuiditet i bollshëm. Politika monetare ka ruajtur natyrën e saj stimuluese: norma bazë mbeti e pandryshuar në 1.00%, pritjet e tregjeve janë orientuar për drejtimin e ardhshëm të politikës monetare nëpërmjet *orientimit të politikës monetare* dhe Banka e Shqipërisë ka furnizuar tregun me likuiditetin e nevojshëm. Këto kushte kanë mundësuar reduktimin e mëtejshëm të normave të interesit të depozitave dhe kredive gjatë këtij viti. Normat më të ulëta të interesit të kredive, si për individët, ashtu edhe për bizneset, kanë reflektuar, gjithashtu, uljen e rrezikut të kredisë, si rrjedhojë e uljes së kredive me probleme, si dhe rritjen e konkurrencës mes bankave. *Yield*-et e letrave me vlerë të qeverisë janë luhatur në vlerat më të ulëta të tyre dhe kurba e tyre është sheshuar gjatë këtij viti, duke reflektuar reduktim të primeve të rrezikut.

3.2 Skenari makroekonomik afatmesëm

Sektori real

Rritja ekonomike parashikohet të qëndrojë në nivelin 4% përgjatë tri viteve 2020–2022. Më konkretisht, rritja ekonomike afatmesme në Shqipëri parashikohet të shënojë nivelet prej 4.1% në vitin 2020 dhe 4.0% në vitet 2021 dhe 2022.

Rritja për vitin 2019 pritet të jetë rreth nivelit 2.7%, çka shënon një ngadalësim krahasuar me rritjen e vazhdueshme dhe të konsiderueshme që prej vitit 2014, e cila arriti pikën më kulmore

prej 4.1% në vitin 2018. Ky ngadalësim i rritjes vjen, kryesisht, si shkak i faktorëve të paqëndrueshëm dhe të përkohshëm. Në muajin nëntor të vitit 2019, Shqipëria është goditur nga një tërmet shumë i fortë, pasojat ekonomike të të cilit mbeten për t'u vlerësuar në periudhën afatmesme, për shkak të dëmeve të mëdha të shkaktuara në rrethet e Durrësit dhe të Tiranës, ku u shpall dhe gjendja e jashtëzakonshme nga qeveria.

Gjatë periudhës afatmesme rritja pritët të gjenerohet kryesisht nga kërkesa e brendshme, si konsumi privat, ashtu edhe investimet. Konsumi privat pritët të nxitet, kryesisht, nga përmirësimi i besimit të konsumatorit, si dhe nga përmirësimet në tregun e punës. Këto të fundit pritët të transmetohen në një rritje graduale të pagave, të cilat më tej pritët të stimulojnë të ardhurat reale të disponueshme të individëve, duke krijuar efektin e raundit të dytë në nxitjen e kërkesës për konsum, si dhe duke intensifikuar prirjen e konsumatorëve për financimin e mëtejshëm të konsumit nëpërmjet një kredimarrjeje më të lartë. Ndërkohë, kredimarrja për konsum parashikohet të nxitet si nga përmirësimi i kushteve financiare të individëve, ashtu edhe nga lehtësimi i pritshëm i standardeve të huadhënies nga sistemi bankar.

Ndërsa rritja e investimeve pritët të reflektojë shfrytëzimin më intensiv të kapaciteteve ekzistuese të prodhimit të vërejtur së fundmi, përsheptimin e aktivitetit ekonomik gjatë periudhës së parashikuar, si dhe perceptimin e përgjithshëm të përmirësuar të biznesit stabilitetin makroekonomik të vendit dhe riskun e ulët përgjatë periudhës afatmesme dhe afatgjatë. Njëkohësisht edhe vijimësia e përmirësimit të kushteve financiare, të lehtësimit të standardeve të huadhënies, si dhe politika monetare akomoduese dhe politikat e huamarrjes së qeverisë, priten të jenë faktorë të rëndësishëm incentivues për investimet private në afatin e mesëm.


Konsumi final, për periudhën afatmesme (2020–2022), parashikohet të rritet në terma realë, me mesatarisht 2.7% në vit, duke kontribuar me mesatarisht 2.5 pikë përqindjeje në vit në rritjen totale. Ndërsa investimet parashikohen të rriten në terma realë, me mesatarisht 5.1% në vit, me një kontribut mesatar në rritjen totale prej 1.2 pikë përqindjeje në vit.

Kërkesa e jashtme neto pritët të ketë efekt pozitiv marxhinal, pothuajse neutral në periudhën afatmesme. Eksportet e mallrave priten të kenë një trend pozitiv, duke supozuar se nuk do të ketë goditje të ndjeshme negative të çmimeve të naftës dhe mineraleve në tregjet ndërkombëtare. Eksportet e shërbimeve, veçanërisht shërbimet turistike, priten, gjithashtu, të vijnë performancën pozitive të regjistruar në periudhën e kaluar, dhe do të jenë elementi kryesor për të kompensuar kontributin negativ të ardhur prej rritjes së importeve.

Eksportet e mallrave dhe të shërbimeve, për periudhën 2020–2022, parashikohen të rriten me mesatarisht 7.2% në vit në terma realë, me një kontribut mesatar pozitiv prej 2.3 pikë përqindjeje në vit në rritjen totale. Ndërsa, importet e mallrave dhe të shërbimeve për këtë periudhë afatmesme parashikohen të zgjerohen me 4.2%, me një kontribut mesatar negativ në rritjen totale me rreth -1.9 pikë përqindjeje në vit. Rrjedhimisht, në terma neto, kërkesa e huaj parashikohet të ketë një kontribut lehtësisht pozitiv në rritjen totale, me mesatarisht 0.4 pikë përqindjeje në vit.

Grafiku 3.2.1 Rritja reale (në %)

*Grafiku 3.2.2 Kontributet në rritje (në p.p.), sipas
komponentëve të kërkesës*



Tabelë 3.2.1 Rritja reale (në të majtë, në %) dhe kontributet në rritje (në të djathtë, në p.p.), sipas komponentëve të kërkesës:

	Rritja Reale (%)								Kontributet në rritje (në p.p)							
	2015	2016	2017	2018	2019	2020	2021	2022	2015	2016	2017	2018	2019	2020	2021	2022
					Para.	Para.	Para.	Fore.					Para.	Para.	Para.	Fore.
Konsumi Final (a+b+c)	0.9	2.4	2.3	2.7	3.0	2.2	3.3	2.6	0.8	2.2	2.1	2.4	2.7	2.1	3.0	2.4
Konsumi Final i Popullatës	0.9	2.0	2.3	3.2	2.7	1.9	3.5	2.7	0.7	1.6	1.9	2.5	2.1	1.6	2.7	2.1
Konsumi Final i Administratës Publike	-1.1	4.7	2.9	-1.2	5.4	4.4	2.2	2.2	-0.1	0.5	0.3	-0.1	0.6	0.5	0.3	0.3
Konsumi Individual	-3.9	1.3	1.3	-0.9	7.8	3.4	1.7	2.2	-0.2	0.1	0.1	0.0	0.4	0.2	0.1	0.1
Konsumi Kolektiv	1.7	7.9	4.3	-1.5	3.2	5.3	2.7	2.3	0.1	0.5	0.3	-0.1	0.2	0.3	0.2	0.1
Konsumi i Institucioneve Jo-fitimprurëse	41.7	16.4	-14.2	2.8	1.0	1.0	2.0	2.0	0.2	0.1	-0.1	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0
Fomimi Bruto i Kapitalit Fiks	3.5	2.4	5.5	2.9	0.5	8.4	1.5	5.2	0.8	0.6	1.3	0.7	0.1	2.0	0.4	1.2
Publik	4.6	0.6	10.6	8.8	1.9	23.1	-10.3	6.0	0.2	0.0	0.5	0.5	0.1	1.3	-0.7	0.3
nga e cila qeveria qendrore	5.4	1.4	5.4	14.6	-3.9	28.1	-12.8	6.5	0.2	0.1	0.2	0.6	-0.2	1.3	-0.7	0.3
Privat	3.2	2.9	4.1	1.2	0.1	3.8	5.9	5.0	0.6	0.6	0.8	0.2	0.0	0.7	1.0	0.9
Kërkesa e brendshme (1+2)	1.4	2.4	2.9	2.7	2.5	3.5	2.9	3.1	1.7	2.8	3.4	3.1	2.9	4.0	3.4	3.6
Eksporti neto^ (a-b)	-8.6	-0.1	-0.3	5.7	1.1	-0.5	-4.7	-3.4	1.6	0.0	0.1	-0.9	-0.2	0.1	0.6	0.4
Eksportet e mallrave e shërbimeve (fob)	1.0	11.3	12.9	3.0	3.9	6.7	7.4	7.6	0.3	3.1	3.8	1.0	1.2	2.1	2.3	2.4
Eksportet e mallrave	-17.1	-5.8	5.5	15.0	-9.0	8.2	8.3	8.4	-1.6	-0.4	0.4	1.0	-0.7	0.5	0.6	0.6
Eksportet e shërbimeve	9.9	17.9	15.1	-0.3	8.1	6.2	7.1	7.4	1.9	3.5	3.4	-0.1	1.9	1.5	1.8	1.9
Importet e mallrave e shërbimeve (fob)	-2.9	6.9	8.1	3.9	3.1	4.4	3.8	4.5	-1.4	3.1	3.7	1.8	1.4	2.0	1.7	2.0
Importet e mallrave	-1.9	7.9	7.8	2.6	3.0	4.8	3.9	4.1	-0.6	2.4	2.4	0.8	0.9	1.4	1.2	1.2
Importet e shërbimeve	-4.9	4.9	8.7	6.5	3.2	3.6	3.4	5.3	-0.8	0.72	1.3	1.0	0.5	0.5	0.5	0.8
Ndryshimet e gjendjeve	-1.9	-36.5	-37.4	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	-0.5	-0.3	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0
Mospërputhje statistikore	-99.0	-275.4	-110.9	-154.1	0.0	0.0	0.0	0.0	-1.1	1.0	0.7	1.9	0.0	0.0	0.0	0.0
PRODIMI I BRËNDSHËM BRUTO (3+4+5)	2.2	3.3	3.8	4.1	2.7	4.1	4.0	4.0	2.2	3.3	3.8	4.1	2.7	4.1	4.0	4.0

Megjithëse politika fiskale do të vazhdojë të jetë e orientuar drejt konsolidimit në periudhën afatmesme dhe afatgjatë, politika buxhetore e qeverisë për të ruajtur një nivel të investimeve publike në rreth 6.3% të PBB, në vitet 2020–2022 (qeveria qendrore dhe lokale së bashku) do të stimulojë formimin e kapitalit fiks bruto në ekonomi, esenciale kjo për të mbështetur nivele relativisht të larta rritjeje në periudhën afatmesme dhe afatgjatë. Nga ana tjetër, nivele relativisht të ulëta të huamarrjes së brendshme neto të qeverisë, të parashikuara për periudhën afatmesme, do të lënë më shumë hapësirë për sektorin privat dhe do të krijojnë stimuj për grumbullimin e investimeve private. Në të njëjtën kohë, vijimi i politikës monetare akomoduese të parashikuar në periudhën afatmesme, duke marrë parasysh presionet e ulëta inflacioniste, do të mbështesë konsumin privat dhe investimet.


Konsolidimi fiskal i synuar nga qeveria do të kufizojë kërkesën e përgjithshme të sektorit publik. Si i tillë, nuk pritet të jetë një nxitës i rritjes në periudhën afatmesme, përveç vitit 2020, ku shpenzimet publike shtesë që do të përdoren për rindërtimin pas tërmetit, do të japin një kontribut pozitiv në rritjen e PBB-së. Megjithatë, konsolidimi fiskal do të ulë primin e riskut në

periudhën afatmesme dhe do të rrisë hapësirat për stimulimin e sektorin privat. Në të njëjtën kohë, komponentët e politikave buxhetore të planifikuara do të mbështesin rritjen dhe për këtë arsye efekti shtrëngues i konsolidimit fiskal pritet të kompensohet.

Në të njëjtën kohë, konsolidimi fiskal në drejtim të borxhit publik dhe deficitit fiskal do të vazhdojë të mbështesë një balancë të shëndetshme midis shpenzimeve korrente dhe shpenzimeve kapitale (investimet publike). Shpenzimet kapitale të parashikuara në buxhetin e vitit 2020, si dhe në periudhën afatmesme do të vazhdojnë të qëndrojnë rreth nivelit 5.5% të PBB-së, që është mesatarisht rreth 3.5–4 pikë përqindjeje të PBB-së më shumë se deficitit buxhetor i planifikuar. Në këtë mënyrë, bilanci aktual fiskal do të vazhdojë të mbetet pozitiv, në përputhje të plotë me rregullin fiskal specifik ose “rregullin e artë” të parashikuar në ligjin e buxhetit organik.

Nga pikëpamja e ofertës agregate pritet që të gjithë sektorët kryesorë të vazhdojnë rreth të njëjtit trend të mesatares së tyre historike. Specifikisht, bujqësia pritet të rritet mesatarisht me 1.3% në vit në terma realë, me një kontribut mesatar prej 0.2 pikë përqindjeje në vit; industria me një mesatare vjetore prej 5.3%, me një kontribut mesatar prej 0.6 pikë përqindjeje në vit; ndërtimi me 5.2%, me një kontribut mesatar prej 0.5 pikë përqindjeje në vit dhe shërbimet me një mesatare 4.5% në vit, me kontributin më të lartë në rritje në saje të peshës së tyre, me një mesatare prej 2.2 pikë përqindjeje në vit.

Grafiku 3.2.3 Rritja reale (në %)



Grafiku 3.2.4 Kontributet në rritje (në p.p.), sipas komponentëve të ofertës






Tabela 3.2.2 Rritja reale (në të majtë, në %) dhe kontributet në rritje (në të djathtë, në p.p.), sipas komponentëve të ofertës

	Rritja Reale (%)								Kontributet në rritje (në p.p)							
	2015	2016	2017	2018	2019	2020	2021	2022	2015	2016	2017	2018	2019	2020	2021	2022
	Para	Para	Para	Para	Para	Para	Para	Fore	Para	Para	Para	Para	Para	Para	Para	Para
Bujqësia, pyjet dhe peshkimi	0.8	2.0	0.8	0.9	1.2	1.3	1.3	1.4	0.2	0.4	0.2	0.2	0.2	0.2	0.2	0.2
Industria nxjerrëse	-8.0	-12.1	4.2	8.3	12.1	6.3	6.2	6.4	-0.4	-0.4	0.1	0.2	0.3	0.2	0.2	0.2
Industria përpunuese	5.0	4.5	12.2	6.4	4.1	4.4	4.7	5.1	0.3	0.3	0.7	0.4	0.3	0.3	0.3	0.3
Energjia elektrike, gazi, avulli dhe furnizimi me ajër të kondicionuar	7.7	9.9	-32.6	49.5	-25.3	7.8	5.1	5.6	0.1	0.3	-1.1	1.0	-0.7	0.2	0.1	0.1
Furnizimi me ujë, aktivitetet e trajtimit dhe menaxhimit të mbeturinave	1.1	1.3	14.8	3.7	3.1	3.7	3.4	3.9	0.0	0.0	0.1	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0
Ndërtimi	6.2	2.5	7.0	2.8	0.3	8.9	3.6	3.2	0.5	0.2	0.6	0.3	0.0	0.8	0.3	0.3
Tregtia me shumicë dhe me pakicë; riparimi i automjeteve dhe motr	-1.9	2.0	1.9	5.3	5.1	4.7	5.3	5.4	-0.2	0.2	0.2	0.6	0.6	0.5	0.6	0.6
Transporti dhe magazinimi	6.5	5.8	4.9	3.9	4.8	4.6	5.3	4.9	0.2	0.2	0.2	0.1	0.2	0.2	0.2	0.2
Akomodimi dhe shërbimi ushqimor	6.7	11.7	14.2	9.2	9.1	7.3	8.4	7.0	0.1	0.2	0.3	0.2	0.2	0.2	0.2	0.2
Informacioni dhe komunikimi	7.6	5.9	4.2	-1.7	6.9	3.2	3.1	2.9	0.2	0.2	0.1	-0.1	0.2	0.1	0.1	0.1
Aktivitetet financiare dhe të sigurimit	5.1	8.7	11.1	3.2	11.9	4.2	7.8	4.4	0.1	0.2	0.3	0.1	0.3	0.1	0.2	0.1
Aktivitetet të pasurive të paluajtshme	0.8	1.1	1.6	1.0	8.4	3.0	3.6	3.2	0.0	0.1	0.1	0.1	0.5	0.2	0.2	0.2
Aktivitetet profesionale, shkencore dhe teknike	6.1	-0.8	14.3	7.8	6.2	3.5	4.4	5.2	0.2	0.0	0.4	0.2	0.2	0.1	0.1	0.2
Shërbime administrative dhe mbështetëse	13.9	12.9	8.9	8.1	6.0	4.4	4.7	4.5	0.3	0.4	0.3	0.3	0.2	0.2	0.2	0.2
Administrim publik dhe mbrojtja; sigurimi social i detyrueshem	2.2	5.3	7.8	1.1	2.8	1.7	3.1	4.5	0.1	0.2	0.3	0.0	0.1	0.1	0.1	0.2
Arsimimi	-0.4	-2.6	8.0	2.1	4.7	4.3	4.8	4.7	0.0	-0.1	0.3	0.1	0.2	0.2	0.2	0.2
Shëndetësia dhe aktivitetet të punës sociale	2.7	5.8	10.6	1.3	4.9	4.2	4.6	4.8	0.1	0.2	0.3	0.0	0.1	0.1	0.1	0.1
Arte, argëtim dhe lodhje	-0.2	-0.7	-1.6	3.0	-49.8	2.6	4.1	4.7	0.0	0.0	0.0	0.0	-0.5	0.0	0.0	0.0
Aktivitetet të tjera shërbimi	12.7	24.1	7.9	4.3	2.7	2.4	3.9	4.3	0.1	0.3	0.1	0.0	0.1	0.0	0.1	0.1
Vlera e Shtuar Bruto me çmime bazë	2.3	3.2	3.9	4.3	2.7	4.1	4.0	4.0	2.0	2.8	3.4	3.7	2.4	3.6	3.5	3.5
Taksa neto mbi produktet	1.8	4.2	3.4	3.2	2.8	4.2	4.1	4.1	0.2	0.5	0.4	0.4	0.3	0.5	0.5	0.5
PBB ME ÇMIMET E TREGUT	2.2	3.3	3.8	4.1	2.7	4.1	4.0	4.0	2.2	3.3	3.8	4.1	2.7	4.1	4.0	4.0

Grafiku 3.2.5 Punësimi (rritja vjetore në %)



Grafiku 3.2.6 Norma e papunësisë (në %)



Politika monetare, kursi i këmbimit dhe inflacioni

Objektivi parësor i Bankës së Shqipërisë është stabiliteti i çmimeve, të cilin banka e përmbush nëpërmjet një regjimi inflacioni të shënjestruar. Banka gjykon se norma 3% në termin afatmesëm është e përshtatshme për të mbështetur stabilitetin e çmimeve dhe për të krijuar kushte për vazhdimin e rritjes ekonomike të vendit. Instrumenti kryesor i përdorur është norma e interesit e marrëveshjeve të anasjella të riblerjes me maturitet një javor. Pozicioni ciklik i ekonomisë dhe presionet e ulëta inflacioniste kanë justifikuar politikën monetare ekspansioniste në vitet e fundit. Sinjalizimi për të ardhmen i përdorur nga banka ka informuar agentët e tregut për vazhdimin e stimulit monetar, duke përbërë kështu një garanci për uljen e primeve të rrezikut.

Banka e Shqipërisë zbaton një regjim të kursit të lirë të këmbimit, ku lëvizjet e kërkesës dhe të ofertës në tregun e valutës përcaktojnë kursin e këmbimit. Banka e Shqipërisë ndërhyr rregullisht në tregjet valutore, me qëllimin e mbajtjes së niveleve të përshtatshme të rezervave valutore, nëpërmjet një skeduli ankandesh të paracaktuar. Në vitin 2018, Banka e Shqipërisë nisi një sërë ndërhyrjesh në tregun e brendshëm valutor, që ndihmuan ndalimin e trendit mbiçmues të kursit

të këmbimit, i cili u shkaktua nga goditje të përkohshme në ekonomi. Ndonëse banka vlerëson se ndërhyrjet valutore janë një instrument në dispozicionin e saj për të mbështetur kthimin e inflacionit në objektiv, nuk kishte ndonjë nevojë të dukshme për përdorimin e tyre në vitin 2019.

Stimuli monetar gjatë këtyre viteve ka mundësuar kosto më të ulëta financimi për ekonominë, duke mbështetur kërkesën e brendshme nëpërmjet rritjes së konsumit dhe investimeve, të cilat kanë qenë kontribuesit kryesorë në rritjen ekonomike. Kushtet e favorshme atmosferike në vitin 2018, sollën një rritje të fortë të prodhimit të energjisë elektrike. Ky zhvillim, si një ngjarje që ndodh një herë, krijoi një efekt të lartë të bazës krahasuese, duke shkaktuar një kontribut negativ të sektorit të prodhimit në gjysmën e parë të vitit 2019. Presionet inflacioniste janë rritur, duke reflektuar përmirësimin e pozicionit ciklik të ekonomisë, në një mjedis rritjeje të shfrytëzimit të kapaciteteve dhe të forcimit të tregut të punës. Sidoqoftë, këto presione ende nuk janë transferuar te norma e inflacionit, e cila ka mbetur nën shënjestrën e Bankës së Shqipërisë gjatë kësaj periudhe. Projektionet e bankës tregojnë se rritja ekonomike do të vijojë në termin afatmesëm, dhe hendeuku i prodhimit do të vijojë të ngushtohet. Norma e inflacionit pritet të nisë të rritet prej vitit 2020, duke iu afruar gradualisht objektivit prej 3% në gjysmën e dytë të vitit 2021. Përmeshja e objektivit të stabilitetit të çmimeve do të kërkojë ruajtjen e kahut stimulues të politikës monetare edhe në afatin e mesëm.

Balanca e rreziqeve vijon të anojë në kahun e poshtëm. Rreziqet kryesore lidhen me zhvillimet në ekonominë botërore dhe ato në ekonominë vendëse që pritet të vuajë pasojat e tërmetit shkatërrues që goditi Shqipërinë në muajin nëntor të vitit të kaluar.

Kombinimi aktual i politikave përfshin një politikë monetare akomoduese nga Banka e Shqipërisë dhe një tendencë konsoliduese të politikës fiskale nga qeveria. Kjo tendencë konsiderohet si një lëvizje e nevojshme, duke qenë se niveli i borxhit publik është i lartë. Qeveria uli huamarrjen e saj në tregun vendës, duke lënë hapësirë për kreditimin e sektorit privat. Ky kombinim i politikave vlerësohet se është i përshtatshëm për të krijuar kushtet që ushqejnë rritjen ekonomike dhe sigurojnë konvergimin e vendit në një shteg rritjeje të qëndrueshme.

Sektori i jashtëm dhe qëndrueshmëria e tij afatmesme

Zhvillime në bilancin e pagesave dhe në tregtinë në mallra


Deficiti i llogarisë korrente u zgjerua ndjeshëm gjatë 9 muajve të parë të vitit 2019 (rreth 38.9% në bazë vjetore). Kjo erdhi, kryesisht, si pasojë e përkeqësimit të gjendjes në tregtinë e mallrave. Eksportet e mallrave u pakësuan me rreth 7.3% vit mbi vit, kryesisht, për shkak të rënies së eksportit të energjisë elektrike. Në të njëjtën kohë, importet u rritën ndjeshëm (me rreth 7.5%) si rezultat i rritjes së importit të energjisë elektrike. Këto zhvillime janë simetrikisht të kundërta me ato të vëna re gjatë 9-mujorit të parë 2018, kur kushtet e favorshme atmosferike mundësuar rritje të shpejtë të prodhimit dhe eksportit të energjisë elektrike dhe, rrjedhimisht, pakësim të importit, veçanërisht gjatë gjysmës së parë të vitit.

Sektorët e tjerë eksportues nuk ndihmuan shumë në balancimin e gjendjes. Kushtet e pafavorshme të kërkesës dhe çmimeve ndërkombëtare ishin faktorë në performancën e dobët për disa sektorë kyç, sikurse “tekstilet” dhe “metalet”. Rritja në sektorë të tjerë ka qenë, gjithashtu, e dobët me përjashtim të “ushqimeve”.


Mbiçmimi real i lekut ka ndjekur një prirje rënëse gjatë 2019-ës. Kursi real efektiv ka ndjekur një trajektore të ngjashme me atë nominal, meqë edhe diferenciali i inflacionit mes vendit tonë dhe partnerëve tregtarë vazhdon të jetë i vogël. Mbiçmimi i kursit real efektiv të këmbimit ishte 0.7% në dhjetor 2019, kundrejt 9.1% në fund të vitit 2018.

Për sa i përket orientimit të eksporteve, përpjesët e vendeve ku eksportohet energji elektrike nga Shqipëria, sikurse Zvicra dhe Serbia janë pakësuar. Megjithatë, struktura e përgjithshme nuk ka ndryshuar në mënyrë të qenësishme. Italia mbetet partneri kryesor i eksporteve shqiptare (me rreth 49% të totalit). Po ashtu, pavarësisht vështirësive të fundit, “tekstilet dhe veshjet” përbëjnë pjesën dërrmuese të eksporteve me rreth 40% të totalit.

Grafik 3.2.7 Hapja tregtare, eksportet, importet dhe IHD neto si përqindje ndaj PBB-së



Grafik 2.2.8 Ndryshimet vjetore të kursit nominal dhe real efektiv të këmbimit (%)



Burimi: Banka e Shqipërisë, INSTAT

Sipas metodës së dekompozimit të eksporteve shqiptare, sipas Përpjesëve Konstante të Tregut (PKT)⁶, rritja e konkurrueshmërisë (komponenti mbetje) ka dhënë kontributin kryesor në rritjen e eksporteve drejt EU-15 gjatë vitit 2018, pasuar nga rritja e eksporteve botërore. Nga ana tjetër, kontribute negative lidhen me shpërndarjen e tregut dhe strukturën sipas kategorive. Në rastin e vendeve anëtare të CEFTA-s, konkurrueshmëria ishte përsëri faktori themelor. Gjithë faktorët e tjerë gjeneruan, gjithashtu, kontribute pozitive.

Tabelë 3.2.3 Dekompozimi i eksporteve shqiptare sipas metodës PKT (milion euro)

	2018	
	EU-15	CEFTA
Rritja e eksporteve botërore	82.4	17.5
Struktura sipas kategorive	-9.0	8.0
Shpërndarja e tregut	-0.7	7.8
Konkurrueshmëria	162.6	65.1
TOTAL	235.3	98.4

Burimi: Banka e Shqipërisë, INSTAT, UN Comtrade

Nënlogaria e shërbimeve ka gjeneruar kontribute të kundërta krahasuar me mallrave në terma të deficitit të përgjithshëm korrent. Teprica e shërbimeve u zgjerua me 11.0% në terma vjetorë, gjatë 9-mujorit të parë 2019, me eksportin e shërbimeve që u rrit me 9.9%. “Shërbimet e udhëtimit”, “shërbimet e tjera” dhe “shërbimet e inputeve fizike” ishin faktorët themelorë në këtë rritje. Megjithëse, vetë normat e rritjes mbeten të larta, kanë humbur disi intensitetin. Norma më të ulëta janë vënë re që në vitin 2018. Kjo ka ardhur për faktin se eksportet e “shërbimeve të udhëtimit” nuk janë rritur aq shpejt sa më parë dhe sepse “inputet fizike” (të përbëra, kryesisht, nga eksportet e fasonit) kanë hasur vështirësi. Në të njëjtën kohë, shërbimet e udhëtimit janë rritur ndjeshëm, për shkak të “shërbimeve të udhëtimit”. Rritja vjetore ka shënuar 8.7%. Norma të larta rritjeje janë vënë re prej vitit 2017.

Të ardhurat parësore pasqyruar një deficit prej EUR 82.6 milionë, gjatë 9-mujorit të parë 2019, krahasuar me një deficit prej EUR 20.1 milionë në periudhën korresponduese të vitit të

⁶ Shihni: <http://go.worldbank.org/KQCHUD4JN0> për një diskutim mbi PKT-në.

mëparshëm. Këto dinamika lidhen me rritjen e shpejtë të të ardhurave dalëse nga investimet direkte.

Teprica pozitive e të ardhurave dytësore u zgjerua me rreth 3.6%, gjatë 9-mujorit të parë 2019. Remitancat neto u rritën me 3.6%, duke përcaktuar ecurinë e nënlogarisë. Nga ana tjetër, “të ardhurat hyrëse të qeverisë së përgjithshme” janë pakësuar me 28.3%, për shkak të efektit të fortë bazë nga viti i kaluar.

Zhvillimet në llogarinë korrente priten të jenë më të moderuara në tremujorin e fundit të vitit 2019, meqë efekti bazë i “energjisë elektrike” pritet të zhduket. Rritja në remitancat pritet të mbetet e ulët, sikur ishte në gjysmën e parë të vitit. Si rrjedhojë, deficitit korrent pritet të zgjerohet në tërësi për gjithë vitin 2019, por me një normë më të ulët krahasuar me gjysmën e parë të vitit. Përgjatë vitit 2020, situata e vështirë në rastin e eksporteve pritet të vazhdojë, duke pasur parasysh që zhvillimet në kërkesën e huaj dhe çmimet ndërkombëtare nuk do të jenë të favorshme. Shërbimet do të kompensojnë disi në terma të rritjes së eksporteve. Nga ana tjetër, parashikimet për rritje të kërkesës së brendshme, pritet të ndikojnë në zgjerim të importeve. Importi i energjisë elektrike do të gjenerojë një efekt bazë në kalimin nga 2019-ta te 2020-ta, por rritja në importin e shërbimeve do të ndikojë në zgjerimin e gjithë strukturës importuese. Së fundi, remitancat nuk priten të japin ndonjë efekt të fortë pozitiv vitin e ardhshëm. Në këto kushte, deficitit korrent pritet të zgjerohet edhe më tej gjatë vitit 2020.

Investimet e huaja direkte neto janë rritur me 0.1% në terma vjetorë gjatë 9 muajve të parë të vitit 2019. IHD-të e lidhura me projektet madhore të sektorit energjetik (në veçanti, gazsjellësi Trans Adriatik) kanë hyrë në fazat e fundit të ndërtimit. Ecuria në këto projekte do të ketë ndikim gjatë gjysmës së dytë 2019 dhe në vitin 2020. Megjithatë, IHD-të, në tërësi, kanë përfutur nga disa burime të papritura në “sektorin e pasurive të paluajtshme”, për shkak të blerjes së banesave nga jorezidentët në Shqipëri (kontribuesi kryesor në rritjen e IHD-ve hyrëse për vitin 2018). Gjithashtu, sektori minerar ka dhënë shenja rigjallërimi. Këto zhvillime mund të krijojnë njëfarë balancimi ndaj rënies së IHD-ve në sektorin energjetik.



Investimet e portofolit pasqyruan mjete neto në masën EUR 8.2 milionë gjatë 9-mujorit të parë 2019, krahasuar me mjete neto në masën EUR 126.9 milionë në periudhën korresponduese të vitit të kaluar. Si mjetet, ashtu edhe detyrimet janë pakësuar, por në masë më të madhe në rastin e mjeteve. Kjo u vu re, kryesisht, në rastin e “mjeteve të borxhit”. Gjithashtu, mjetet e rezervës u pakësuan me rreth EUR 4.7 milionë gjatë 9-mujorit të parë 2019. Për sa i përket financimit të deficitit korrent, flukset joborxhkrijuese nga investimet direkte përbëjnë faktorin kryesor.

Zhvillime në borxhin e jashtëm

Stoku i borxhit të jashtëm të Shqipërisë arriti EUR 8,328.5 milionë në tremujorin e tretë të vitit 2019, duke u vlerësuar në 61.6% ndaj PBB-së nominale. Raporti i borxhit ndaj PBB-së është pakësuar ndjeshëm gjatë 2 viteve të fundit. Borxhi afatgjatë përbën 80.0% të totalit me kontribut kryesor nga huat afatgjata për qeverinë e përgjithshme dhe sektorët e tjerë. Borxhi afatshkurtër përbën 20.0% të totalit të borxhit të jashtëm.

Nga pikëpamja e qëndrueshmërisë, treguesit e aftësisë ripaguese afatgjatë të borxhit të jashtëm të Shqipërisë janë përmirësuar gjatë periudhave të fundit. Raporti i borxhit të jashtëm ndaj eksportit të mallrave dhe të shërbimeve qëndron në 156.2% në tremujorin e tretë 2019, krahasuar me 161.5% një vit më parë. Po ashtu, raporti i borxhit të jashtëm ndaj të ardhurave fiskale qëndron në nivelin 221.5% krahasuar me 237.8% një vit më parë. Raporti i stokut të borxhit të qeverisë së përgjithshme ndaj të ardhurave fiskale qëndron në nivelin 101.1% krahasuar me 104.3% një vit më parë. Treguesit e likuiditetit dëshmojnë për presione të dobëta nga shërbimi i borxhit. Raporti i amortizimit të borxhit ndaj eksportit të mallrave dhe shërbimeve qëndron në nivelin 9.4%.

Grafik 3.2.9 Borxhi i huaj ndaj eksportit të mallrave dhe shërbimeve (majtas) dhe ndaj të ardhurave fiskale (djathtas)





Burimi: Banka e Shqipërisë

Stoku i borxhit të jashtëm afatshkurtër ndaj PBB-së qëndron në nivelin 12.1% në fund të tremujorit të tretë 2019, kundrejt 13.1% në fund të tremujorit të tretë 2018. Në të njëjtën kohë, raporti i eksportit të mallrave dhe të shërbimeve ndaj borxhit të jashtëm afatshkurtër qëndron në nivelin 326.7%, kundrejt 304.7% në fund të tremujorit të tretë 2018.

Në skenarin bazë për 2019, vlerësohet që raporti i borxhit të huaj ndaj PBB-së do të ruajë trendin rënës të vënë re gjatë 3 vjetëve të fundit për të arritur rreth 52.2%. Megjithatë, ky projektion rrethohet nga rreziqe në kahun e sipërm të cilët merren parasysh në hartimin e analizës së ndjeshmërisë së borxhit të jashtëm ndaj disa goditjeve negative. Këtu, simulohen goditje të normave të interesit dhe të kursit të këmbimit. Në skenarin e parë, norma mesatare e interesit që paguhet për borxhin e jashtëm rritet në mënyrë permanente me dy devijime standarde. Në skenarin e dytë, monedha vendëse merr një goditje të vetme prej 10% në kahun nënçmues. Devijimi i borxhit të jashtëm nga skenari bazë është më i dukshëm në rastin e skenarit me nënçmim kursi.

Grafik 3.2.10 Borxhi i jashtëm bruto ndaj PBB-së në skenarin bazë dhe sipas atyre të riskut: goditje e normës së interesit (majtas) dhe nënçmimi real (djathtas)




Burimi: Banka e Shqipërisë

Rezerva valutore

Kriteret e mjaftueshmërisë së rezervave valutore që mbahen në Bankën e Shqipërisë përcaktohen në terma të mbulimit me rezervë të 4 muajve importe mallrash dhe shërbimesh, si edhe të mbulimit në masën 100% të borxhit të jashtëm afatshkurtër. Në fund të vitit 2019, rezervat valutore të Bankës së Shqipërisë shënojnë nivelin 3,360 milionë euro, vlerësuar në rreth 25.4% ndaj PBB-së. Në terma të kriterëve të mjaftueshmërisë, niveli i rezervave valutore gjatë vitit 2019 vlerësohet të mbulojë mesatarisht rreth 6.4 muaj importe mallrash dhe shërbimesh dhe rreth 155% të borxhit të jashtëm afatshkurtër. Në afat të mesëm, të dyja këto kritere pritet të mbeten mbi nivelet e tyre të mjaftueshmërisë.

Grafik 3.2.11 Parashikimi i rezervave valutore në raport me importet e mallrave dhe të shërbimeve (majtas) dhe në raport me borxhin e huaj afatshkurtër (djathtas)



Burimi: Banka e Shqipërisë

Sektori financiar

Sektori financiar dhe roli i tij ndërmjetësues, i reflektuar në madhësinë e aktiveve, kanë vijuar të zgjerohen gjatë 9 muajve të parë të vitit 2019. Thyerja strukturore në bilancin e një prej bankave sistematike (BKT), në fund të vitit 2018, ka rezultuar në një tkurrje të lehtë të bilancit të sektorit bankar dhe rënie të lehtë të peshës së aktiveve të sektorit bankar ndaj PBB-së. Deri në fund të qershorit 2019, aktivet e sektorit bankar arritën në 104.4% të PBB-së dhe ky raport ishte 2.5 p.p. më i ulët në krahasim me vlerën në dhjetor 2018. Fondet e investimit dhe të pensionit, kompanitë e sigurimit dhe shoqëritë e kursim-kreditit vijuan të zgjerimin aktivitetin e tyre, por pesha e tyre relative ndaj prodhimit të brendshëm qëndroi e pandryshuar në krahasim me fundin e vitit 2018. Segmenti i institucioneve financiare jobanka (IFJB-ve) regjistroi një rritje të fortë në terma nominalë dhe relativë. Deri në fund të qershorit 2019 aktivet e IFJB-ve u rritën me 23% në terma vjetorë, ndërkohë që niveli i kapitalizimit të këtyre subjekteve është i lartë dhe cilësia e kredisë është përmirësuar ndjeshëm⁷.

Autoriteti mbikëqyrës	Aktivet/PBB (%)	2011	2012	2013	2014	2015	2016	2017	2018	Qershor 2019
Banka e Shqipërisë	Bankat	88.1	92.1	94.8	97.6	97.3	100.5	99.4	96	93
	Institucionet financiare jobanka	2.7	2.7	2.7	3	2.9	3	3.1	3.5	3.9
	Sh.K.K.të dhe unionet e tyre	0.8	0.8	0.7	0.8	0.8	0.6	0.6	0.6	0.7
Autoriteti i Mblikëqyrjes Financiare	Kompanitë e sigurimit	1.5	1.6	1.7	1.9	2.1	2.1	2.1	2.1	2.2
	Fondet e pensionit	0	0	0	0	0.1	0.1	0.1	0.2	0.2
	Fondet e investimit		1.2	3.9	4.8	5	4.7	5	4.5	4.5
	Aktivet e sektorit financiar / PBB	93.1	98.6	103.8	108.2	108	111	110.3	106.9	104.4

Nga janari deri në shtator 2019, bilanci i sektorit bankar u zgjerua me 2.5% ose me 35 miliardë lekë dhe arriti në 1,450 miliardë lekë. Kjo rritje u mbështet nga rritja me 4% në tepicën e kredisë dhe një zgjerim me rreth 2% në stokun e letrave me vlerë të mbajtura nga sektori bankar. Në anën e detyrimeve, rritja reflektoi rritjen me 22 miliardë lekë të stokut të depozitave dhe një rritje

⁷ Raporti i kredive me problem për IFJB-të ra në 9% në qershor 2019 nga 13% në dhjetor 2018.

me 15 miliardë lekë në veprimet me thesarin dhe ndërbankare. Depozitat e përgjithshme të mbajtura nga bankat vendëse arritën në 1,170 miliardë lekë në fund të shtatorit 2019 dhe përfaqësonin rreth 80% të detyrimeve të sektorit bankar. Shkalla e ndërmjetësimit nga bankat ka rënë lehtë gjatë periudhës 2014–2019, kur raporti kredi/depozita ra në 49% nga 56%, si pasojë e rritjes më të dobët të kredisë në krahasim me rritjen relativisht të shpejtë të depozitave, veçanërisht gjatë viteve 2014–2016. Megjithatë nga janari deri në shtator të vitit 2019, rritja në tepërcën e kredisë (3.6%) e nxitur nga rritja në kredinë afatgjatë në monedhën vendëse për sektorin privat (si për bizneset, ashtu edhe për individët) ishte dukshëm më e lartë se sa rritja në stokun e depozitave (1.9%).

	2014	2015	2016	2017	2018	Janar - Shtator' 2019
Kreditë (ndryshim vjetor, %)	5	-2	2	0	-3	3.6
Depozitat (ndryshim vjetor, %)	5	3	5	1	1	1.9
Kredi/Depozita (%)	56	54	52	52	49	49

Zgjerimi i kredisë për huamarrësit rezidentë gjatë gjysmës së parë të vitit 2019 reflektoi rritjen e huamarrjes për blerje banesash nga individët në monedhën vendëse dhe të huamarrjes për ndërtim nga ana e bizneseve, në një kohë kur normat e interesit për kreditë e reja vijuan të bien. Nga rezultatet e vërtetimit vërehet që barra e borxhit për kompanitë dhe familjet mbetet e përballeshme, ndërkohë që kërkesa për kredi në horizontin afatshkurtër pritet të jetë e moderuar. Borxhi i jashtëm i kompanive jofinanciare dhe i familjeve ka regjistruar një rritje të moderuar gjatë 4 vjetëve të fundit dhe arriti në 1,360 milionë euro në fund të gjashtëmujorit të parë të vitit 2019 nga 1,280 milionë euro në fund të vitit 2016. Gjatë së njëjtës periudhë, stoku i borxhit të jashtëm në formën e huamarrjes ndër kompani ra në 1,705 milionë euro nga 1,790 milionë euro.

Për vitin e ardhshëm presim që kredia të vijojë të rritet me një ritëm të moderuar deri të mirë. Pritet tona mbështeten në pozicionin e qëndrueshëm të likuiditetit dhe në nivelin e mirë të kapitalizimit të bankave, në faktin që cilësia e aktiveve po përmirësohet, në projeksionet relativisht pozitive për rritjen ekonomike dhe në faktin që niveli i borxhit në bilancet e familjeve dhe të kompanive është i ulët. Rreziqet për ecuri të dobët të kredisë lidhen kryesisht me mundësinë që rritja ekonomike të jetë më e vogël se sa pritjet (për shkak të rritjes më të ulët në ekonominë e rajonit dhe ato të Evropës dhe, për shkak të ndikimit të përkohshëm, veçanërisht në sektorin e turizmit, të tërmetit të 26 nëntorit) ose me kërkesën më të dobët për kredi.

Në fillim të nëntorit 2019, Banka e Shqipërisë dhe Shoqata Shqiptare e Bankave miratuan një platformë për rimëkëmbjen e kredisë. Platforma, e cila është e publikuar, përmban objektiva afatshkurtër dhe afatmesëm të lidhur me bankat dhe Bankën e Shqipërisë, si edhe me agjenci qeveritare. Qëllimi kryesor i aktiviteteve të propozuara është ulja e rrezikut të kredisë dhe mbështetja e kërkesës për kredi.

Sistemi financiar vendës dhe sektori bankar, aktivet e të cilit zënë rreth 90% të aktiveve të sistemit financiar, janë të qëndrueshëm, të mirëkapitalizuar dhe me një rezultat financiar pozitiv. Niveli i kapitalizimit të sektorit bankar arriti në 18.8% në fund të shtatorit dhe ka shënuar rritje të vazhdueshme gjatë viteve të fundit, kryesisht si rezultat i rritjes së kapitalit rregullator të bankave, por edhe për shkak të rritjes me norma më të ulëta të nivelit të aktiveve të peshuara me rrezik të sektorit bankar. Bankat dhe institucionet e tjera financiare vijuan të regjistronin rezultat financiar pozitiv dhe treguesit e përfitueshmërisë shënuan nivele të njëjta ose disi më të larta në krahasim me nivelet e viteve 2017 dhe 2018. Kthimi nga kapitali (RoE) për sektorin bankar në fund të shtatorit ishte 13.7%, por disa banka që kanë më shumë se 50% të aktiveve të sektorit bankar,

kanë një RoE më të lartë se sa 16.3%. Pozicioni i likuiditetit të sektorit bankar është i mirë dhe treguesit e likuiditetit (aktivet likuide ndaj totalit të aktiveve dhe aktivet likuide ndaj detyrimeve afatshkurtra) kanë vijuar të rriten dhe mbeten ndjeshëm mbi normat e përcaktuara në aktet rregullative. Sipas ushtrimeve të provave të rezistencës për sektorin bankar, në skenarin bazë, gjatë horizontit afatmesëm (2019–2020) bankat paraqiten të mirëkapitalizuara dhe në gjendje për të kryer aktivitetin e tyre normal pa pasur nevojë për injektim kapitali.

Cilësia e kredisë bankare është përmirësuar në mënyrë të qëndrueshme gjatë nëntë muajve të parë të vitit 2019, kryesisht, për shkak të rënies së ndjeshme (me 20% në terma vjetorë deri në fund të shtatorit 2019) në stokun e kredive me probleme (KMP), por edhe si pasojë e rimëkëmbjes së kredisë. Raporti i Kredive me Probleme (RKP) ra në 10.6% në fund të shtatorit, duke shënuar nivelin më të ulët që nga fundi i vitit 2009. Në të njëjtën kohë, pesha e kredive të humbura brenda tepricës së kredive me probleme ra nga 60% në fund të tremujorit të parë të vitit 2017, në 42% në fund të muajit shtator 2019. Rënia në stokun e KMP-së, gjatë periudhës janar–shtator 2019, ka ardhur nga shlyerja e një pjese të kredive me problem, si edhe nga fshirjet dhe ristrukturimi i një pjese të kredive me problem. Vëllimi i kredive të humbura (për më shumë se 3 vjet) që janë fshirë nga bilanci e bankave që nga tremujori i parë i vitit 2015 është rreth 60 miliardë lekë dhe kjo vlerë është e barabartë me vlerën aktuale të stokut të kredive me probleme.

Cilësia e kredisë pritet të vijojë të përmirësohet më tej, ndërkohë që rreziku i kredisë pritet të mbetet në nivele të kontrolluara në të ardhmen afatshkurtër dhe afatmesme. RKP-ja pritet të ruajë prirjen në rënie nën ndikimin e tkurrjes së mëtejshme të stokut të KMP-së dhe të rritjes më të fortë të kredisë. Duke filluar nga 1 janari 2020 bankave iu kërkohet të fshijnë nga bilanci kreditë e humbura për një periudhë të paktën 2-vjeçare. Kjo masë pritet t'i japë një shtysë të rënies së stokut të KMP-së dhe RKP-së dhe të rezultojë në rritje të hapësirave për kreditim nga ana e bankave. Masa e mbulimit të kredive me kolateral është përmirësuar ndjeshëm. Në fund të shtatorit 2019 ky raport shënoi 80% dhe ishte rreth 6 p.p. më i lartë se sa niveli mesatar i 4 vjetëve të fundit.

Sistemi financiar dhe sektori bankar mbeten, veçanërisht, të ekspozuar ndaj rreziqeve të tregut, dhe, në një masë më të vogël, ndaj rrezikut të rënies së përfitueshmërisë. Zhvillimet në pozicionet e hapura valutore dhe portofoli i kredive në valutë të pambrojtura nga rreziku i kursit të këmbimit tregojnë që ekspozimi i sektorit bankar ndaj rrezikut të drejtpërdrejtë dhe të tërthortë të kursit të këmbimit ka ardhur duke u zvogëluar gjatë vitit 2019. Megjithatë, raporti i kredive në valutë të pambrojtura nga rreziku i kursit ndaj tepricës së kredisë (24%) mbetet i lartë dhe kërkon monitorim të kujdesshëm dhe të vazhdueshëm nga industria dhe nga autoriteti mbikëqyrës. Diferenca midis mjeteve dhe detyrimeve të ndjeshme ndaj lëvizjeve në normat e interesit në raport me kapitalin rregullator të sektorit bankar është e vogël (rreth 2%), por mbizotërimi i kredive me normë interesi të ndryshueshme në portofolin e përgjithshëm të kredive dhe fakti që normat e interesit kanë arritur nivelet më të ulëta historike sugjerojnë një ekspozim më të lartë të huamarrësve ekzistues dhe atyre të ardhshëm në rastin e një korrektimi të normave të interesit në horizontin afatmesëm.

Mbikëqyrja makroprudenciale

Politika makroprudenciale

Pas një periudhe përgatitore dyvjeçare dhe një procesi konsultativ gjithëpërfshirës me sektorin bankar, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë miratoi rregulloren nr. 41, të datës 5.6.2019, “Për shtesat makroprudenciale të kapitalit”. Paketa e shtesave makroprudenciale të kapitalit përfshin shtesën konservuese, shtesën kundërciklike, shtesën për rrezikun sistematik dhe shtesën për institucionet me rëndësi sistemike. Deri në fund të muajit nëntor 2019 Banka e Shqipërisë ka aktivizuar shtesën konservuese të kapitalit në masën 0.5% për të gjitha bankat, shtesën kundërciklike të kapitalit të barabartë me 0% dhe shtesat përkatëse që variojnë nga 0.5% deri në 1.5% për 4 banka me rëndësi sistemike. Kjo rregullore përafron në një mënyrë gjithëpërfshirëse artikujt përkatës të direktivës së BE-së. Zbatimi i këtyre masave me bazë kapitalin e sektorit bankar pritet të kontribuojë në forcimin e rezistencës së sektorit bankar ndaj goditjeve.

Gjatë periudhës 2020–2022, Banka e Shqipërisë planifikon të zhvillojë:

- kuadrin për adaptimin e mundshëm të masave makroprudenciale që targetojnë sjelljen e huamarrësve, si kufijtë e sipërm për vlerën e kredisë ndaj vlerës së kolateralit dhe raportit të borxhit të huamarrësit ndaj të ardhurave;

- kuadrin për vlerësimin e rreziqeve që vijnë nga ndërlikohja midis segmenteve të sistemit financiar; zhvillimi i këtij kuadri do të trajtohet në mënyrë të plotë në projektin e binjakëzimit të Bankës së Shqipërisë me disa banka qendrore të Bashkimit Evropian, që ka filluar në fund të vitit 2019;

- ushtrimin e provës së rezistencës për rreziqet makroprudenciale.

Mbikëqyrja mikroprudenciale

Plani kombëtar për kreditë me probleme

Banka e Shqipërisë ka monitoruar vazhdimisht Planin Kombëtar për zgjidhjen e Kredive me Probleme. Për të përmbushur këtë angazhim, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë:

- me vendimin nr. 51, datë 3.7.2019, ka miratuar rregulloren e re “Për trajtimin jashtëgjyqësor nga bankat, të kredimarrësve në vështirësi financiare”; dhe

- me vendimin nr. 52, datë 3.7.2019, ka miratuar disa ndryshime në rregulloren nr. 62, datë 14.9.2011, “Për administrimin e rrezikut të kredisë nga bankat dhe degët e bankave të huaja”, duke reduktuar afatin e fshirjes së kredive të humbura nga bankat, nga 3 vjet në 2 vjet.

Sipas vlerësimit tonë, Plani i Veprimit për Kreditë me Probleme ka përfunduar. Përveç përmirësimeve në cilësinë e aktiveve, ky plan që synon nivele më të ulëta të kredive me probleme, do të mbetet në fokusin e punës sonë mbikëqyrëse dhe të komunikimit me bankat për vitin e ardhshëm.

Ndryshimet e fundit mbikëqyrëse dhe rregullative

Përveç vendimeve të mësipërme nr. 51 dhe 52, gjatë periudhës janar–tetor 2019, janë miratuar nga Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë edhe akte të tjera dhe ndryshime në rregulloret në fuqi, përkatësisht:

1. Me vendimin nr. 2, datë 9.1.2019, të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, u miratuan disa ndryshime në rregulloren ekzistuese nr. 69/2014, “Për kapitalin rregullator të bankës”, të cilat synojnë përafrimin me kërkesat e Bazel III, për raportet e kapitalit përpjesëtimisht me kërkesat e Bankës së Shqipërisë për normën e mjaftueshmërisë së kapitalit.

2. Me vendimin nr. 27, datë 28.03.2019, të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, u miratua rregullorja “Për raportin e mbulimit me likuiditet”, e cila përafron dispozitat e rregulloreve evropiane 575/2013/EC^[1] dhe 2015/61/EU^[2] dhe dispozitat e dokumentit të Bazel III. Kjo rregullore synon të plotësojë kuadrin rregullativ në fuqi për administrimin e rrezikut të likuiditetit, nëpërmjet prezantimit të këtij treguesi të ri (LCR), përcaktimit të kriterëve dhe të rregullave për llogaritjen e raportit të mbulimit me likuiditet (LCR) dhe të përcaktimit të kërkesave të autoritetit mbikëqyrës për nivelin minimal të këtij raporti.

3. Me vendim nr. 46, të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, datë 3.7.2019, u miratuan disa ndryshime në rregulloren ekzistuese nr. 14/2019, “Për licencimin dhe ushtrimin e veprimtarisë së bankave dhe degëve të bankave të huaja në Republikën e Shqipërisë” (rekomandimet e Raportit të Moneyval, në kuadër të vlerësimit të raundit V për Shqipërinë).

4. Me vendim nr. 47, të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, datë 3.7.2019, u miratuan disa ndryshime në rregulloren ekzistuese nr. 01/2013, “Për licencimin dhe ushtrimin e veprimtarisë nga subjektet financiare jobanka” (rekomandimet e Raportit të Moneyval, në kuadër të vlerësimit të raundit V për Shqipërinë).

¹ Anglisht: Regulation (EU) No 575/2013 of the European Parliament and of the Council “On prudential requirements for credit institutions and investment firms”.

² Anglisht: Commission Delegated Regulation (EU) 2015/61 to supplement Regulation (EU) No 575/2013 of the European Parliament and the Council with regard to liquidity coverage requirement for Credit Institutions.

5. Me vendim nr. 48, të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, datë 3.7.2019, u miratuan disa ndryshime në rregulloren ekzistuese nr. 104/2016, “Për licencimin dhe ushtrimin e veprimtarisë së shoqërive të kursim-kreditit dhe të unioneve të tyre” (rekomandimet e Raportit të Moneyval, në kuadër të vlerësimit të raundit V për Shqipërinë).

6. Me vendim nr. 49, të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, datë 3.7.2019, u miratuan disa ndryshime në rregulloren ekzistuese nr. 31/2017, “Për licencimin, organizimin, veprimtarinë dhe mbikëqyrjen e zyrave të këmbimit valutor” (rekomandimet e Raportit të Moneyval, në kuadër të vlerësimit të raundit V për Shqipërinë).

7. Me vendim nr. 50, të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, datë 3.7.2019, u miratuan disa ndryshime në rregulloren ekzistuese nr. 2/2013, “Për administrimin e rrezikut në veprimtarinë e subjekteve financiare jobanka” (rekomandimet e Raportit të Moneyval, në kuadër të vlerësimit të raundit V për Shqipërinë).

8. Me vendimin nr. 60, datë 4.9.2019, të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, u miratua udhëzimi i ri “Për *stress test*-et e bankave”, i cili synon përafrimin me udhëzuesin e EBA-s (EBA/GL/2018/04), “Udhëzues mbi përgatitjen e *stress test*-eve nga institucionet/bankat”. Ky udhëzues përcakton kërkesat dhe metodologjitë për kryerjen e *stress test*-eve nga bankat, si pjesë e procesit të tyre të administrimit të rrezikut dhe, veçanërisht, në kontekstin e Procesit të Vlerësimit të Brendshëm të Mjaftueshmërisë së Kapitalit (ICAAP). Ky udhëzues synon, gjithashtu, të sigurojë unifikimin e praktikave të ndjekura nga bankat, gjatë kryerjes së *stress test*-eve.

Ndryshimet mbikëqyrëse dhe rregullative në proces

- Në lidhje me përafrimin e mëtejshëm me kërkesat e bazel III:

- projektndryshimet në rregulloren “Për raportin e mjaftueshmërisë së kapitalit” kanë përfunduar, duke synuar përafrimin e mëtejshëm me Rregulloren Evropiane 575/2013. Këto ndryshime janë konsultuar, gjithashtu, edhe me industrinë bankare. Projektndryshimet pritet të paraqiten për miratim në Këshillin Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë brenda tremujorit të katërt të vitit 2019;

- projektndryshimet në rregulloren “Për administrimin e rrezikut nga ekspozimet e mëdha të bankave”, janë përgatitur me qëllim përafrimin e mëtejshëm me ndryshimet më të fundit në Rregulloren Evropiane 575/2013, në dokumentet e Komitetit të Bazelit mbi regjimin e ekspozimeve të mëdha dhe me udhëzuesin e EBA-s për personat e lidhur. Projektndryshimet do të paraqiten për konsultim me industrinë bankare dhe pritet të miratohen gjatë tremujorit të parë të vitit 2020.

- Në zbatim të dispozitave të reja dhe të ndryshuara të ligjit nr. 9917, “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit”, si dhe në përputhje me zbatimin e rekomandimeve të Raportit Moneyval, Banka e Shqipërisë ka përfunduar projektndryshimet në rregulloret e mëposhtme, të cilat janë konsultuar me subjektet e interesuara dhe do të paraqitet për miratim nga Këshilli Mbikëqyrës, brenda tremujorit të katërt të 2019-ës:

- rregullorja nr. 44/2019, “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit”;

- rregullorja nr. 4/2017, “Për mbikëqyrjen e konsoliduar”;

- rregullorja nr. 28/2005, “Për mbikëqyrjen e transaksioneve bankare në rrugë elektronike”.

Ndërhyrja e jashtëzakonshme në sektorin bankar si pjesë e reformave të sektorit financiar

Gjatë vitit 2019, Banka e Shqipërisë, në cilësinë e Autoritetit të Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme ka zhvilluar kuadrin rregullator, në përputhje me zhvillimet në kuadrin e ndërhyrjes së jashtëzakonshme në banka në nivel evropian dhe, në përputhje me kërkesat e paketës së re bankare, ka finalizuar ciklin e parë të planeve të ndërhyrjes së jashtëzakonshme, si dhe ka ndërmarrë hapat përkatës në ndërtimin dhe rritjen e Fondit të Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme.

Zhvillimet në kuadrin e ndërhyrjes së jashtëzakonshme në sektorin bankar gjatë vitit 2019

Për sa i përket kuadrit rregullator:

1. Me anë të vendimit nr. 33/2019, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë ka miratuar rregulloren “Për përcaktimin e nivelit të ushtrimit të kompetencave në Bankën e Shqipërisë për rimëkëmbjen dhe ndërhyrjen e jashtëzakonshme në banka”. Në këtë rregullore përcaktohen organet e brendshme të Bankës së Shqipërisë dhe të drejtuesve të njësive organizative të saj, të cilët nxjerrin aktet administrative individuale në zbatim të kompetencave të Bankës së Shqipërisë për rimëkëmbjen dhe ndërhyrjen e jashtëzakonshme, sipas ligjit nr. 133/2016, “Për rimëkëmbjen dhe ndërhyrjen e jashtëzakonshme në banka në Republikën e Shqipërisë”.

2. Me anë të vendimit nr. 44/2019, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë ka miratuar rregulloren “Vlerësimi për qëllime të ndërhyrjes së jashtëzakonshme” në të cilën përkufizohen kushtet dhe kriteret për përzgjedhjen e vlerësuesit të pavarur, kriteret dhe metodologjia e vlerësimit përpara dhe pas ndërhyrjes së jashtëzakonshme, si dhe vlerësimi i detyrimeve nga instrumentet derivative. Kjo rregullore është në përputhje me Standardet Teknike Rregullatore të Autoritetit Bankar Evropian – EBA, EBA/RTS 2017/05–06, “Mbi vlerësimin për qëllime të ndërhyrjes së jashtëzakonshme dhe mbi vlerësimin për përcaktimin e diferencës në trajtim pas ndërhyrjes së jashtëzakonshme, sipas direktivës së Bashkimit Evropian 2014/59/EU, “Mbi rimëkëmbjen dhe ndërhyrjen e jashtëzakonshme në institucionet e kreditit dhe firmat e investimit”, dhe EBA/RTS/2015/1, “Mbi vlerësimin e derivativëve”, sipas nenit 49(4) të direktivës “Për rimëkëmbjen dhe ndërhyrjen e jashtëzakonshme në banka – BRRD”.

3. Gjatë vitit 2019, Banka e Shqipërisë ka hartuar versionin e parë të rregullores “Mbi kërkesat minimale për instrumente të kapitalit rregullator dhe detyrimeve të pranuar – MREL”, e cila është pjesërisht në përputhje me direktivën 2019/879 (BRRD II), e cila amendon direktivën 2014/59/EU, lidhur me kapacitetin përthithës të humbjeve dhe atë të rikapitalizimit të institucioneve të kreditit dhe firmave të investimit dhe direktivën 2019/876 (CRR2), që amendon rregulloren e BE-së nr. 575/2013, lidhur me treguesin e levës financiare, treguesin e financimit të qëndrueshëm neto, kërkesat për instrumente të kapitalit rregullator dhe të detyrime të pranuar, rrezikun e kredisë së kundërpartisë, rrezikun e tregut, ekspozimin ndaj kundërpalëve qendrore, ekspozimin ndaj sipërmarrjeve të investimeve kolektive, ekspozimet e mëdha, kërkesat për raportim dhe publikim dhe rregulloren e BE-së nr. 648/2012.

Lidhur me planifikimin e ndërhyrjes së jashtëzakonshme, Banka e Shqipërisë ka finalizuar ciklin e parë të planeve të ndërhyrjes së jashtëzakonshme për bankat sistemike, në të cilin përfshihet identifikimi i funksioneve kritike, identifikimi i strategjisë së preferuar për ndërhyrjen e jashtëzakonshme, si dhe identifikimi i pengesave të mundshme për realizimin e ndërhyrjes së jashtëzakonshme. Banka e Shqipërisë ka realizuar, gjithashtu, një analizë të plotë dhe vlerësim të funksioneve ekonomike me rëndësi kritike, të identifikuara nga bankat si pjesë e planeve të rimëkëmbjes, vlerësim i cili iu është njoftuar në mënyrë individuale bankave.

Për sa i përket Fondit të Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme, gjatë vitit 2019 u derdhën kontributet e vitit të dytë të tij nga bankat, si dhe u finalizuan pasqyrat financiare të audituara për vitin e parë të veprimtarisë. Fondi i Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme, ashtu si përcaktohet në ligjin 133/2016, administrohet nga Agjencia e Sigurimit të Depozitave, në përputhje me dokumentin “Politika e administrimit të mjeteve financiare të Fondit të Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme”, i cili përgatitet dhe propozohet nga Agjencia e Sigurimit të Depozitave dhe miratohet nga Banka e Shqipërisë. Gjithashtu, Banka e Shqipërisë ka monitoruar ecurinë e mjeteve financiare të Fondit të Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme, përmes raportimit tremujor nga Agjencia e Sigurimit të Depozitave.

Pas nënshkrimit të Marrëveshjes së Bashkëpunimit midis Bankës së Shqipërisë dhe Bordit të Përbashkët të Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme – SRB, Banka e Shqipërisë është ftuar të marrë pjesë në mbledhjet e Kolegjeve të Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme të bankave evropiane nën juridiksionin e SRB-së e me prezencë sistemike në Shqipëri.

Fokusi kryesor më 2020–2022

Në horizontin kohor afatmesëm 2020–2022, në fushën e ndërhyrjes së jashtëzakonshme në fokusin e Bankës së Shqipërisë do të jenë çështjet e mëposhtme:

- forcimi i aftësisë për ndërhyrje të jashtëzakonshme në banka përmes hartimit dhe përditësimit të planeve të ndërhyrjes së jashtëzakonshme për të gjitha bankat që ushtrojnë aktivitetin në Shqipëri, duke identifikuar pengesat potenciale për ndërhyrjen e jashtëzakonshme e duke marrë masat përkatëse për të hequr këto pengesa. Planet e ndërhyrjes së jashtëzakonshme kanë për qëllim të lehtësojnë përdorimin në mënyrë efektive të instrumenteve të ndërhyrjes së jashtëzakonshme nga ana e Bankës së Shqipërisë, të mbështesin vijueshmërinë e funksioneve kritike dhe të bëjnë sa më të zbatueshme ndërhyrjen e jashtëzakonshme në banka;

- plotësimi i kuadrit rregullator, në përputhje me kuadrin rregullator të Bashkimit Evropian për përcaktimin e politikës përkatëse, lidhur me kërkesat minimale për instrumentet e kapitalit rregullator dhe detyrimeve të pranuar për bankat – MREL, si dhe përcaktimi fillimisht i kufijve informues e më pas i kufijve përfundimtarë për plotësimin e MREL-it, brenda një periudhe kohe të përshtatshme tranzitore;

- arritja e nivelit të synuar të Fondit të Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme nëpërmjet pagesës së kontributit vjetor nga bankat dhe monitorimi i politikës së investimit të mjeteve financiare të Fondit, në përputhje me dispozitat përkatëse në ligj dhe aktet rregullatore të hartuara për këtë qëllim;

- përmirësimi i koordinimit dhe i bashkëpunimit me njësi të tjera organizative brenda Bankës së Shqipërisë, institucione dhe agjenci kombëtare, si dhe institucione dhe organizata ndërkombëtare, në përputhje me dispozitat e ligjit “Mbi rimëkëmbjen dhe ndërhyrjen e jashtëzakonshme në banka në Republikën e Shqipërisë”;

- forcimi i kapaciteteve teknike të stafit të Bankës së Shqipërisë, lidhur me ndërhyrjen e jashtëzakonshme, nëpërmjet trajnimeve dhe bashkëpunimit me institucione homologe.

3.3 Alternative scenarios and risks

Skenari bazë vlerësohet të ketë probabilitet më të lartë për t’u materializuar. Megjithatë parashikimi i skenarëve alternativë, duke supozuar se një pjesë e risqeve të ndryshme që rrethojnë skenarin bazë mund të materializohen, është një komponent i rëndësishëm i planifikimit të financave publike. Në mënyrë që të rritet cilësia e planifikimit dhe të ketë një menaxhim më efikas të fondeve publike në çdo situatë që ka një probabilitet të caktuar për të ndodhur, më poshtë paraqiten shkurtimisht dy skenarë alternativë, në mënyrë specifike një skenar “pesimist” dhe një skenar “optimist”.

Secili nga skenarët alternativë supozon që një grup risqesh negative (në rastin e një skenari “pesimist”) ose risqesh pozitive (në rastin një skenari “optimist”) do të materializohen. Ky grup risqesh supozon devijime nga parashikimet në skenarin bazë për treguesit kryesorë makroekonomikë, duke përfshirë kreditimin e ekonomisë, ecurinë e ekonomisë së Eurozonës me efektet që ka në eksportin e mallrave dhe shërbimeve, në remitanca, në flukset e kapitaleve të huaja, si dhe në kursin e këmbimit, normën e interesit, ritmin dhe ndikimin e reformave të politikave strukturore të planifikuara për periudhën afatmesme etj. Efekti i përgjithshëm neto i të gjitha risqeve të supozuara, negative ose pozitive, për thjeshtësi analize (modelimi) jepet si një goditje fillestare në terma të një variabli të vetëm: rritjes ekonomike reale. Pra, skenarët alternativë bazohen në supozime të ndryshme të rritjes ekonomike nga skenari bazë për secilin vit 2020–2022.

Tabela 3.3.1 Supozimet alternative në secilin skenar

	2013	2014	2015	2016	2017	2018	2019 Vler	2020 Para	2021 Para	2022 Para
Rritja reale e PBB(%)										
<i>Bazë</i>	1.0	1.8	2.2	3.3	3.8	4.1	2.7	4.1	4.0	4.0
<i>Pesimist</i>								3.1	3.0	3.0
<i>Optimist</i>								4.6	4.5	4.5
PBB nominale (në miliard lek)										
<i>Bazë</i>	1,350	1,395	1,434	1,472	1,551	1,631	1,689	1,777	1,880	1,990
<i>Pesimist</i>								1,760	1,844	1,933
<i>Optimist</i>								1,786	1,898	2,019
Të ardhurat (% e PBB-së)										
<i>Bazë</i>	24.2	26.3	26.4	27.6	27.7	27.6	27.4	28.7	27.7	27.6
<i>Pesimist</i>								28.2	27.2	27.1
<i>Optimist</i>								28.7	27.7	27.6
Deficiti fiskal (në miliard lek)										
<i>Shënim: Deficiti i përgjithshëm fiskal në terma nominale për çdo skenar alternativ targetohet të jetë më tepër (më pak) në rastin e skenarit pesimist (optimist) se deficiti nominal i skenarit bazë me diferencë në 50% të të ardhurave totale ndërmjet skenarit bazë dhe skenarëve të tjerë alternativ.</i>										
<i>Bazë</i>	-66.9	-72.1	-58.2	-26.7	-31.0	-26.2	-32.9	-39.7	-36.9	-32.9
<i>Pesimist</i>								-46.5	-46.5	-45.6
<i>Optimist</i>								-38.5	-34.4	-28.9

Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë

4. KUADRI FISKAL

4.1 Politikat strategjike dhe objektivat afatmesëm

Politika fiskale në periudhën afatmesme 2020–2022 do të jetë e orientuar drejt konsolidimit fiskal, në përputhje me rregullat fiskale të parashtruara në ligjin e buxhetit organik (shih kutinë më poshtë mbi parimet dhe rregullat fiskale).

Konsolidimi fiskal dhe reduktimi i borxhit publik janë thelbësore për të ulur dobësitë e lidhura me borxhin që pengojnë rritjen dhe shkaktojnë paqëndrueshmëri makroekonomike. Për të reduktuar dobësitë e lidhura me borxhin publik, janë ndërmarrë disa masa për rregullime fiskale gjatë viteve të fundit. Bilanci i përgjithshëm fiskal është përmirësuar me rreth 3.5 p.p. të PBB-së nga viti 2014 më 2019–ën, mbështetur nga mobilizimi i të ardhurave, kufizimi i shpenzimeve dhe zbatimi i disa reformave administrative. Që nga viti 2016, kemi arritur një bilanc primar pozitiv (suficit primar), krahasuar me një deficit primar prej 2.3% në vitin 2014. Të ardhurat tatimore janë rritur ndjeshëm gjatë viteve të fundit, nga 22.2% e PBB-së në vitin 2013 në rreth 26% të PBB-së më 2019–ën, nxitur nga politika tatimore dhe përmirësimi i administratës tatimore. Reforma kundër informalitetit, gjithashtu, ndihmoi në rritjen e mbledhjes së të ardhurave, duke mbetur një prioritet i vazhdueshëm. Nga ana e shpenzimeve, kursime të konsiderueshme janë realizuar nga reformat në sektorin e pensioneve dhe të energjisë, si dhe nga rendimenti në administratën publike. Gjithashtu, sa i përket menaxhimit të borxhit gjatë këtyre viteve, kemi zvogëluar risqet e ndryshimit të termave, duke diversifikuar dhe duke zgjatur ndjeshëm maturitetin e borxhit tonë.

Politika fiskale konsoliduese synon të mbajë trajektoren e rënies së borxhit publik në raport me PBB-në që nga viti 2016. Borxhi publik pritet të bjerë në rreth 65.4% të PBB-së në vitin 2020; 62.3% e PBB-së në vitin 2021 dhe 62.0% në vitin 2022, duke mundësuar një reduktim të konsiderueshëm nga niveli prej 72.7% në vitin 2015. Në aspektin e borxhit publik neto nga asetet likuide të qeverisë (depozita në para të qeverisë që mbahen në bankën qendrore), ulja do të jetë nga 64.5% që pritet në fund të vitit 2019 në 60.5% në vitin 2022, që përfshin një reduktim kumulativ prej rreth 4 p.p. për tre vjet ose një reduktim kumulativ prej 11.4 p.p. që prej vitit 2015. Për të arritur objektivin tregues të politikës fiskale afatmesme mbi borxhin publik, skenari fiskal bazë synon një deficit fiskal në nivelin 2.2% të PBB-së më 2020–ën, një nivel prej 2.0% të PBB-së në vitin 2021 dhe synon ulje të mëtejshme në 1.7% në vitin 2022. Në të njëjtën kohë, synohet një bilanc primar pozitiv në vitet 2020–2022, respektivisht 0.1% të PBB-së në vitin 2020; 0.5% në

vitin 2021; dhe 0.8 për qind në vitin 2022. Gjithashtu, balanca korrente, e definuar këtu si diferenca midis investimeve publike dhe deficitit vjetor, synohet të arrijë nivele të larta në periudhën afatmesme. Balanca korrente në periudhën afatmesme synon nivelin 3.5 për qind të PBB-së më 2020-ën, 2.8 për qind në vitin 2021 dhe 3.1 për qind në vitin 2022.

Në të njëjtën kohë, ky kuadër fiskal përshtat politikat buxhetore që mbështesin rritjen ekonomike. Investimet publike të qeverisë qendrore në afat të shkurtër dhe të mesëm ruhen me një mesatare prej mbi 4.5% të PBB-së, e cila është e rëndësishme për të nxitur kërkesën agregate në afat të shkurtër dhe për të zhvendosur rritjen potenciale në periudhën afatmesme dhe afatgjatë. Vazhdimi i reformave të menaxhimit financiar publik është thelbësor për rritjen e efikasitetit të shpenzimeve buxhetore, si dhe për krijimin e hapësirave për shpenzime më produktive në periudhën afatmesme dhe afatgjatë.

PARIMET DHE RREGULLAT FISKALE

Në përputhje të plotë me obligimet që rrjedhin prej ligjit organik të buxhetit (LOB) nr. 57/2016, kuadri fiskal 2021–2023, materializon parimet dhe rregullat fiskale të mëposhtme:

1. Në çdo ligj vjetor të buxhetit, fillestar apo të rishikuar, si dhe në planifikimet e buxhetit afatmesëm, raporti i borxhit publik ndaj Produktit të Brendshëm Bruto do të planifikohet më i ulët se niveli i vlerësuar për vitin pararendës, deri atëherë kur niveli i borxhit të arrijë dhe të qëndrojë poshtë nivelit 45 për qind të Produktit të Brendshëm Bruto.

Në përputhje me këtë dispozitë (rregull fiskal) të LOB-së, kuadri fiskal 2021–2023 **targeton çdo vit një nivel të borxhit publik total në përqindje të PBB-së më të ulët se sa niveli i vitit pararendës.**

2. Vlera e Produktit të Brendshëm Bruto, nominale në lekë, e cila do të përdoret për llogaritjen e raportit të borxhit publik ndaj Produktit të Brendshëm Bruto, për vitet buxhetore që planifikohen dhe për vitin pararendës, nuk mund të jetë më e lartë se vlera respektive e parashikuar ose e vlerësuar në raportin “Perspektiva ekonomike botërore” (World Economic Outlook), të Fondit Monetar Ndërkombëtar, më i fundit i publikuar në kohën kur ligji vjetor i buxhetit dorëzohet për miratim në Kuvend. Kjo dokumentohet qartësisht në relacionin shoqërues të ligjit vjetor të buxhetit.

Në përputhje me këtë dispozitë (rregulla fiskale) të LOB-së, kuadri 2021–2023 **bazohet në projeksionet e mëposhtme të PBB-së nominale, të cilat paraqiten në mënyrë krabasimore kundrejt projeksioneve të raportit “Perspektiva ekonomike botërore” (World Economic Outlook)**⁸, të Fondit Monetar Ndërkombëtar, më i fundit i publikuar në tetor 2019.

Parashikimet e PBB nominale te FMN dhe MFE				(në miliardë Lekë)		
	2017	2018	2019 Para.	2020 Para.	2021 Para.	2022 Para.
FMN - Perspektiva Ekonomike Botërore	1,551.3	1,626.2	1,705.4	1,809.0	1,926.0	2,062.7
MFE	1,551.3	1,630.9	1,688.9	1,777.2	1,879.8	1,990.2
Diferenca FMN - MFE						
(diferenca e vlerave të parashikuara duhet të jetë jo më e vogël se zero)	0.0	-4.7	16.5	31.8	46.1	72.5

3. Në çdo vit buxhetor të planifikuar duhet të përfshihet një kontingjencë e veçantë, prej jo më pak se 0.7 për qind e shpenzimeve totale të buxhetit, për të kompensuar rreziqe potenciale nga luhatjet në kurset e këmbimit ose normat e interesit, me ndikim në nivelin e borxhit.

⁸ Linku për aksesimin e raportit WEO – <https://www.imf.org/en/Publications/WEO/Issues/2019/10/01/world-economic-outlook-october-2019>.

Në përputhje me këtë dispozitë (rregulla fiskale) të LOB-së, kuadri 2021–2023 përfshin për çdo vit në një zë të veçantë të tij, emërtuar “Kontigjencë për luhatjet e normave të interesit etj.” ***një kontigjencë prej të paktën 0.7 për qind e shpenzimeve totale.***

4. Të ardhurat nga privatizimi nuk janë pjesë e procesit të programimit buxhetor. Në rastet e arkëtimit ato përdoren, jo më pak se 50 për qind, për uljen e borxhit publik dhe pjesa tjetër për investime publike.

Në përputhje me këtë dispozitë (rregulla fiskale) të LOB-së, kuadri 2021–2023 ***nuk përfshin të hyra nga privatizimet e mundshme.***

5. Masa e deficitit buxhetor nuk mund të tejkalojë masën e shpenzimeve kapitale të parashikuara çdo vit në ligjin e buxhetit.

Në përputhje me këtë dispozitë (rregulla fiskale – “rregulla e artë”) të LOB-së, deficit i targetuar në kuadrin 2021–2023 ***është çdo vit më i ulët se sa shpenzimet kapitale të planifikuara.*** Rrjedhimisht, balanca korrente e targetuar është pozitive prej mesatarisht 3 për qind të PBB-së në çdo vit të programuar.


4.2 Implementimi i buxhetit për vitin 2019

Ecuria e treguesve kryesorë të shpenzimeve buxhetore për periudhën janar–nëntor 2019

Shpenzimet e përgjithshme publike, për muajin e njëmbëdhjetë të vitit 2019, arritën në 431.95 miliard lekë me një realizim në masën 94.6 për qind të planit të periudhës. Ndërkohë që, krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2018, ky zë ka rezultuar 5.7 për qind më i lartë ose 23.3 miliardë lekë më shumë.

Në terma vjetorë, shpenzimet e përgjithshme për 11-mujorin e vitit 2019 u realizuan në masën 83.1 për qind të planit vjetor, sipas buxhetit fillestar dhe aktit normativ nr. 2, datë 2.10.2019, (AN2).


Grafiku 4.2.1 Shpenzimet e përgjithshme dhe ritmi i rritjes së tyre (në miliard lekë)



Shpenzimet korrente dhe ato kapitale, kanë shënuar një realizim respektivisht në masën 98 për qind dhe 78.6 për qind të planit të periudhës. Ndërkohë që, në terma vjetorë, ato janë realizuar përkatësisht:

- shpenzimet korrente 88.3 për qind të planit vjetor, sipas buxhetit fillestar dhe 87.8 për qind, sipas AN2;
- shpenzimet kapitale 61.5 për qind të planit vjetor, sipas buxhetit fillestar dhe 63.6 për qind sipas AN2.

Grafiku 4.2.2 Shpenzimet korrente dhe kapitale plan vs fakt 11-mujor (në miliard lekë)



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë

Tabela 4.2.1 Treguesit fiskalë të konsoliduar për 11-mujorin e vitit 2019 (në milion lek)

Emërtimi	Nëntor 2019		Diferenca		Viti 2019			
	Plan	Fakt	Fakt-Plan	në % mbi Plan	Plani Vjetor Buxhet Fillestar	Plani Vjetor AN2	% e realizimit vjetor Buxhet Fillestar	% e realizimit vjetor AN2
Të Ardhurat e Përgjithshme	435,529	421,129	-14,400	96.7%	486,676	486,676	86.5%	86.5%
Shpenzimet e Përgjithshme	456,832	431,954	-24,878	94.6%	519,576	519,577	83.1%	83.1%
Shpenzimet Korrente	383,735	376,215	-7,520	98.0%	426,068	428,719	88.3%	87.8%
Shpenzimet Kapitale	70,824	55,686	-15,138	78.6%	90,608	87,508	61.5%	63.6%
Deficit/Suficit	-21,303	-10,825	-10,477	50.8%	-32,900	-32,901	32.9%	32.9%

Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë

Tabela 4.2.2 Treguesit fiskalë të konsoliduar për 11-mujorin e vitit 2018 dhe 2019 (në milion lek)

Emërtimi	Fakt Nëntor 2018	Nëntor 2019		Diferenca Fakt 2019 Plan 2019	Në % ndaj Plan 2019	Diferenca Fakt 2019 Fakt 2018	Në % ndaj Fakt 2018
		Plan	Fakt				
Të Ardhurat e Përgjithshme	407,429	435,529	421,129	-14,400	96.7%	13,700	103.4%
Shpenzimet e Përgjithshme	408,700	456,832	431,954	-24,878	94.6%	23,254	105.7%
Shpenzimet Korrente	351,008	383,735	376,215	-7,520	98.0%	25,207	107.2%
Shpenzimet Kapitale	57,512	70,824	55,686	-15,138	78.6%	-1,825	96.8%
Deficit/Suficit	-1,271	-21,303	-10,825	-10,477	50.8%	9,554	851.6%


Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë

Shpenzimet korrente, për periudhën 11-mujore të vitit 2019, rezultuan në rreth 376.2 miliardë lekë, ndërsa krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë, ky zë ka rezultuar 7.2 për qind më i lartë ose rreth 25.2 miliard lek më shumë. Shpenzimet korrente, për muajin e njëmbëdhjetë të vitit 2019, zënë 87.1 për qind të totalit të shpenzimeve, ndërkohë që krahasuar me PBB-në zënë 21 për qind. Për shpenzimet korrente, për periudhën 11-mujore, niveli mesatar ndër vite kundrejt PBB-së është 21 për qind.

Shpenzimet kapitale, për muajin e njëmbëdhjetë të vitit 2019, paraqesin një realizim në masën rreth 55.69 miliardë lekë. Krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2018, ky zë është 3.2 për qind më i ulët ose 1.83 miliardë lekë më pak. Shpenzimet kapitale për muajin e njëmbëdhjetë të vitit 2019 zënë 12.9 për qind të totalit të shpenzimeve, ndërkohë që krahasuar me PBB-në zënë 3.2 për qind. Për shpenzimet kapitale, për periudhën 11-mujore ndër vite, niveli mesatar kundrejt PBB-së është 4 për qind.

Niveli i deficitit, në muajin e njëmbëdhjetë të vitit 2019, rezultoi në rreth 10.83 miliardë lekë ose rreth 10.48 miliardë lekë më pak se plani i periudhës. Krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2018, në të cilën niveli i deficitit arriti në masën rreth 1.27 miliardë lekë, për 11-mujorin e vitit 2019, niveli i deficitit është rritur me rreth 9.55 miliardë lekë më shumë në terma nominalë.

Grafiku 4.2.3 Struktura e shpenzimeve të përgjithshme dhe raporti me PBB-në, për periudhën 11-mujore




Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë


Shpenzimet korrente, në raport me planin 11-mujor të këtij viti, paraqesin një realizim prej 98 përqindësh, duke rezultuar në rreth 376.2 miliardë lekë. Zërat kryesorë që ndikuan në nivelin e realizimit të shpenzimeve korrente, kundrejt planit 11-mujor janë përkatësisht:

- shpenzimet për subvencione arritën në nivelin rreth 1.24 miliardë lekë ose 104.8 për qind e planit të periudhës;
- shpenzimet e tjera sociale arritën në nivelin 22.6 miliardë lekë ose 101.9 për qind e planit të periudhës;
- shpenzimet për buxhetin vendor arritën në nivelin rreth 51.8 miliardë lekë ose 100.4 për qind e planit të periudhës.

Grafiku 4.2.4 Shpenzimet korrente dhe ritmi i rritjes së tyre (në miliard lek)



Grafiku 4.2.5 Struktura e shpenzimeve korrente




Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë

Në shpenzimet korrente peshën kryesore e zënë shpenzimet për fondet speciale me 41.7 për qind të totalit të shpenzimeve korrente.

Shpenzimet e personelit, gjatë muajit nëntor 2019, përfaqësuan 18.6 për qind të totalit të shpenzimeve korrente. Niveli i shpenzimeve faktike të personelit prej rreth 70.1 miliardë lekësh realizon nivelin e parashikuar për këtë zë në planin e periudhës 11-mujore, në masën 97.4 për qind. Krahësohet me të njëjtën periudhë të vitit 2018, ky zë është 4.7 për qind më i lartë ose rreth 3.1 miliardë lekë më shumë.

Grafiku 4.2.6 Shpenzimet e personelit dhe ritmi i rritjes së tyre (në miliard lek)




Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë

Shpenzimet për paga, në fund të muajit të njëmbëdhjetë të vitit 2019 u realizuan në masën rreth 59.9 miliardë lekë, duke qenë 5.5 për qind më të larta se e njëjta periudhë e vitit 2018 ose 3.1 miliardë lekë më shumë. Për rrjedhojë, edhe shpenzimet për sigurime shoqërore rezultuan në masën 3.7 për qind më të larta se një vit më parë ose 344 milionë lekë më shumë. Realizimi faktik

i këtyre zërave së bashku është në nivelin 98.4 për qind krahasuar me planin e periudhës ose 91.2 për qind e planit vjetor, sipas buxhetit fillestar dhe sipas AN2.


Grafiku 4.2.7 Shpenzimet e pagave dhe ritmi i rritjes së tyre (në miliard lek)



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë

Shpenzimet për interesa, gjatë periudhës 11-mujore 2019, kanë përfaqësuar 8.85 për qind të shpenzimeve korrente. Niveli faktik i tyre prej rreth 33.3 miliardë lekë ka rezultuar në masën 98.7 për qind të planit të periudhës. Në raport me planin vjetor, në nivel 11-mujori, këto shpenzime janë realizuar në masën 79.8 për qind të planit vjetor, sipas buxhetit fillestar dhe 83 për qind sipas AN2. Ndërsa, krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2018, ky zë ka rezultuar 2.7 për qind më i ulët ose 920 milionë lekë më pak.


Grafiku 4.2.8 Shpenzimet për interesa (në miliard lek)



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë

Shpenzimet Operative dhe Mirëmbajtjeje, gjatë periudhës 11-mujore të vitit 2019, kanë shënuar një realizim në masën rreth 40.1 miliardë lekë ose 95.9 për qind të planit të periudhës. Niveli faktik i tyre ka rezultuar në masën 85.6 për qind të planit vjetor, sipas buxhetit fillestar dhe 83.5 për qind sipas AN2. Krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2018, ky zë ka rezultuar 9.8 për qind më i lartë ose rreth 3.57 miliardë lekë më shumë.


Grafiku 4.2.9 Shpenzimet operative dhe ritmi i rritjes së tyre (në miliard lek)



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë

Shpenzimet për subvencione, në fund të muajit të njëmbëdhjetë të vitit 2019, arritën nivelin rreth 1.24 miliardë lekë, me një realizim në masën 104.8 për qind të planit të periudhës ose 57 milionë lekë më shumë në terma nominalë. Në raport me planin vjetor ky zë është realizuar në masën 83.1 për qind të planit vjetor, sipas buxhetit fillestar dhe 86.6 për qind sipas AN2, ndërkohë që, kundrejt së njëjtës periudhë të vitit 2018, shpenzimet për subvencione rezultojnë 11.6 për qind më të larta ose 129 milionë lekë më shumë.

Grafiku 4.2.10 Shpenzimet për subvencione dhe ritmi i rritjes së tyre (në miliard lek)




Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë

Shpenzimet për fondet speciale, për muajin e njëmbëdhjetë të vitit 2019, rezultuan në nivelin rreth 157.1 miliardë LEKë, me një realizim prej 97.4 për qind, kundrejt planit të periudhës. Përkatesisht:

- shpenzimet për sigurime shoqërore u realizuan në masën rreth 116.9 miliardë lekë;
- shpenzimet për sigurime shëndetësore në rreth 38 miliardë lekë; dhe
- shpenzimet për kompensimin e pronarëve në rreth 2.1 miliardë lekë.

Kundrejt së njëjtës periudhë të vitit 2018, shpenzimet për sigurime shoqërore janë 6.65 miliardë lekë më të larta, shpenzimet për sigurime shëndetësore janë 2.76 miliardë lekë më të larta, ndërsa shpenzimet për kompensimin e pronarëve 203 milionë lekë më të ulëta.

Grafiku 4.2.11. Shpenzimet për sigurime shoqërore dhe shëndetësore (në miliard lek)



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë


Shpenzimet për papunësinë, për 11-mujorin e vitit 2019, janë realizuar në masën 96 për qind e planit të periudhës ose 92.6 për qind e planit vjetor, sipas buxhetit fillestar dhe 85.7 për qind sipas AN2. Kundrejt së njëjtës periudhë të vitit 2018, shpenzimet për këtë zë rezultojnë me një rritje në masën 53 për qind ose 160 milionë lekë më shumë në terma nominalë.

Shpenzimet për ndihmën ekonomike dhe pagesën e paaftësisë (PAK), për periudhën 11-mujore të vitit 2019, u realizuan në masën rreth 18.9 miliardë lekë, duke rezultuar 100 për qind e planit të periudhës. Në raport me planin vjetor ato janë realizuar në masën 92 për qind të planit vjetor, sipas buxhetit fillestar dhe 90.7 për qind sipas AN2. Kundrejt së njëjtës periudhë të vitit 2018, shpenzimet për këtë zë rezultojnë me një rritje në masën 5.5 për qind ose 989 milionë lekë më shumë në terma nominalë.

Shpenzimet për kompensimin e ish-të përndjekurve politikë, për periudhën 11-mujore të vitit 2019, u realizuan në masën 1.15 miliardë lekë, duke rezultuar 104.5 për qind krahasuar me planin e periudhës. Në raport me planin vjetor ato janë realizuar në masën 115.4 për qind të planit vjetor, sipas buxhetit fillestar dhe 96.2 për qind të AN2. Kundrejt së njëjtës periudhë të vitit 2018, shpenzimet për këtë zë rezultojnë me një rritje në masën 477 milionë lekë më shumë në terma nominalë.

Shpenzimet për bonusin e lindjeve për periudhën 11-mujore të vitit 2019 u realizuan në masën rreth 2.1 miliardë lekë, duke rezultuar 121.4 për qind e planit të periudhës ose 374 milionë lekë më shumë në terma nominalë. Në raport me planin vjetor ato janë realizuar në masën 106.2 për qind të planit vjetor, sipas buxhetit fillestar dhe 118 për qind sipas AN2.


Grafiku 4.2.12. Shpenzimet për ndihmën ekonomike, PAK-në dhe Papunësinë (në miliard lek)



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë

Shpenzimet për pushtetin vendor, gjatë periudhës 11-mujore të vitit 2019, kanë arritur në masën rreth 51.8 miliardë lekë, duke përbërë 13.8 për qind të shpenzimeve korrente. Kundrejt së njëjtës periudhë të vitit 2018, ky nivel rezulton 13.8 për qind më i lartë ose rreth 6.3 miliardë lekë më shumë.

Grafiku 4.2.13 Shpenzimet e pushtetit vendor dhe ritmi i rritjes së tyre (në miliard lek)




Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë

Shpenzimet kapitale, për muajin e njëmbëdhjetë të vitit 2019, kanë një realizim në masën rreth 55.69 miliardë lekë ose 78.6 për qind në raport me fondet e planifikuara për këtë periudhë. Respektivisht, projektet e investimeve me financim të brendshëm kanë shënuar një realizim në masën rreth 37.1 miliardë lekë, duke rezultuar 82 për qind krahasuar me planin e periudhës ose 8.16 miliardë lekë më pak, ndërkohë që ato me financim të huaj kanë shënuar një realizim në masën rreth 17.9 miliardë lekë, duke rezultuar 72.6 për qind krahasuar me planin e periudhës ose rreth 6.76 miliardë lekë më pak në terma nominalë. Krahasuar me planin vjetor, për 11-mujorin e vitit 2019 është konstatuar një realizim i përgjithshëm i investimeve publike në masën 61.5 për qind të planit vjetor, sipas buxhetit fillestar dhe 63.6 për qind sipas AN2 dhe, më konkretisht:


- financimi i brendshëm është realizuar 65.1 për qind e planit vjetor, sipas buxhetit fillestar dhe 67.6 për qind sipas AN2;
- financimi i huaj është realizuar 54.9 për qind e planit vjetor, sipas buxhetit fillestar dhe 56.6 për qind sipas AN2.

Grafiku 4.2.14 Shpenzimet kapitale dhe ritmi i rritjes së tyre (në miliard lek)



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë


Grafiku 4.2.15 Shpenzimet kapitale dhe burimi i financimit të tyre (në miliard lek)



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë

Grafiku i mëposhtëm paraqet ndarjen e **shpenzimeve publike faktike** për muajin nëntor të vitit 2019. Shpenzimet korrente për këtë periudhë përbëjnë pjesën më të madhe të shpenzimeve totale faktike me 87.1 për qind, ndërsa shpenzimet kapitale përbëjnë 12.9 për qind.


Grafiku 4.2.16 Detajimi i shpenzimeve buxhetore (në milionë lek)



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë

Sikurse evidentohet nga tabela e treguesve fiskalë të konsoliduar, realizimi i shpenzimeve të përgjithshme për muajin e njëmbëdhjetë të vitit 2019 është 431.95 miliardë lekë ose 94.6 për qind kundrejt planit të periudhës. Kjo situatë është shoqëruar me një deficit buxhetor prej rreth 10.83 miliardë lekësh. Grafiku i mëposhtëm tregon tendencat e treguesve kryesorë të buxhetit të shtetit.

Grafiku 4.2.17 Të ardhurat, shpenzimet dhe deficit/suficiti - plan vs fakt 11-mujori 2019 (në milion lek)



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë

Të ardhurat totale të mbledhura, për periudhën janar–nëntor 2019, ishin rreth 421 miliardë lekë ose 96.7%, kundrejt planit të periudhës, duke shënuar një rritje prej 3.3% ose 13.6 miliardë lekësh më shumë se viti mëparshëm. Të ardhurat nga grantet arritën në 5 miliardë lekë ose 32% të planit të periudhës dhe 0.75 miliardë lekë më pak se e njëjta periudhë e vitit të mëparshëm.

Të ardhurat e mbledhura nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave (DPD) dhe Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve (DPT), duke përfshirë kontributet shoqërore të mbledhura nga DPT-ja ishin 368.8 miliardë lekë, me një realizim prej 97.4% të planit dhe 2.9% ose 10.5 miliardë lekë më shumë se e njëjta periudhë e vitit të kaluar. Në krahasim me vitin e kaluar, këto të ardhura shënuan një përmirësim të ndjeshëm në performancën e të ardhurave, si rezultat i: i, përpjekjeve intensive për të zvogëluar informalitetin; ii. administrimin më të mirë në DPD dhe DPT gjatë vitit 2019; dhe iii. rritja e të ardhurave nga dividendi, si pasojë e uljes së normës së tatimit mbi dividendin nga 15% në 8%.

Tabela 4.2.3 Të ardhurat totale nga tatimet dhe doganat (në milion lek)

Lloji i tatimit	Fakti 11 Mujor	Plani 11 Mujor	Diferenca Fakt - Plan	
			Në vlerë	Në %
Tatimi mbi vlerën e shtuar (TVSH)	125,104	136,307	(11,203)	-8.2%
Tatimi mbi fitimin	32,744	29,587	3,157	10.7%
Akciza	42,020	44,195	(2,175)	-4.9%
Tatimi mbi të ardhurat personale	43,328	37,792	5,536	14.6%
Taksat nacionale dhe të tjera	33,093	37,597	(4,504)	-12.0%
Taksa Doganore	5,888	6,703	(815)	-12.2%
Total të ardhura tatimore	282,177	292,181	(10,004)	-3.4%
Kontributet e mbledhura nga DPT	86,630	86,369	261	0.3%
Totali i përgjithshëm (DPD+DPT+Kontribute)	368,807	378,550	(9,743)	-2.6%

Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë

Faktorët kryesorë që kanë ndikuar në performacën e 11-mujorit përkundrejt planit janë:

- ndikimi i një rënie (zhvlerësimi) të kursit të këmbimit USD dhe EUR ndaj monedhës vendëse, e cila pati efekte negative të rëndësishme në uljen e të ardhurave të TVSH-së nga importet për të gjitha kategoritë e mallrave;

- rënia e taksave kombëtare, për shkak të rënies së çmimeve ndërkombëtare të mallrave, si nafta bruto dhe metale të tjera dhe, pjesërisht për shkak të parashikimit shumë optimist të planit për vitin 2019.

Të ardhurat nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave arritën në 148 miliardë lekë, me një realizim prej 95.4% të planit. Në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit 2018, janë arkëtuar 2.4% ose 2.2 miliardë lekë më shumë.

Tabela 4.2.4 Të ardhurat e mbledhura nga DPD-ja (në milion lek)

Lloji i tatimit	Fakti 11 Mujor	Plani 11 Mujor	Diferenca Fakt - Plan	
			Në vlerë	Në %
TVSH në import	97,866	101,645	(3,779)	-3.7%
Akciza	42,020	44,195	(2,175)	-4.9%
Renta minerare	2,191	2,582	(391)	-15.1%
Taksa Doganore	5,888	6,703	(815)	-12.2%
Totali i të ardhurave doganore	147,965	155,125	(7,160)	-4.6%

Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë

Të ardhurat nga TVSH-ja në import janë 97.9 miliardë lekë me një realizim prej 96.3 % të planit me një rritje 1 miliard lekë ose 1% në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar. Performanca e TVSH-së në import është ndikuar nga disa faktorë, siç janë:

- zhvlerësimi i monedhës euro kundrejt monedhës vendëse me 4.2%, pati efekt të rëndësishëm negativ në uljen e të ardhurave të TVSH-së nga importi për të gjitha kategoritë e mallrave;

- rënia e importit të energjisë, si rezultat i rritjes së prodhimit vendës dhe i ndërgjegjësimit të konsumatorit, në lidhje me konsumin e tyre të energjisë;

- ulja e të ardhurave nga importi i projektit TAP, për shkak të përfundimit të periudhës së projektit.


Të ardhurat nga akciza ishin 42 miliardë lekë, me një realizim prej 95.1% të planit. Performanca e akcizës për periudhën janar – nëntor është ndikuar nga disa faktorë:

- gjatë kësaj periudhe rimbursimi i akcizës ishte 1.12 herë më shumë se 11-mujori 2018.

- performanca pozitive, si rezultat i rritjes së sasisë u shënuar nga: importi i karburantit +2% ose +5000 tonë; importi dhe prodhimi vendës i birrës me +6.2%; importi i cigareve me +4.2%, së bashku me rritjen e prodhimit të duhanit vendës nga 20 tonë në 27 tonë, të deklaruar në periudhën janar–nëntor 2018.

Performanca e të ardhurave nga renta minerare, gjatë periudhës janar–nëntor 2019 ishte 2.2 miliardë lekë, me një realizim prej 84.9% të planit, duke shënuar një rënie me 11.7% ose 291 milionë lekë më pak se e njëjta periudhë e vitit të kaluar. Në krahasim me vitin e kaluar, të ardhurat nga nafta bruto kanë pësuar një rënie, si rezultat i zvogëlimit të vëllimit të eksportit, për shkak të përpunimit brenda vendit dhe, gjithashtu, për shkak të uljes së çmimeve ndërkombëtare për 6.6%.

Grafiku 4.2.18 Kontribuesit kryesorë të të ardhurave doganore (janar–nëntor 2019/2018)



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë

Të ardhurat e mbledhura nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve (përfshirë kontributet për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore të mbledhura nga DPT-ja) për periudhën janar–nëntor 2019 janë 220.8 miliardë lekë, me një realizim prej 98.8% të planit dhe 3.9% ose 8.3 miliardë lekë më shumë se e njëjta periudhë e një viti më parë. Tabela e mëposhtme tregon të dhëna të hollësishme në lidhje me performancën tatimore.

Tabela 4.2.5 Performanca e të ardhurave të administratës tatimore (në milion lek)


Lloji i tatimit	Fakti 11 Mujor	Plani 11 Mujor	Diferenca Fakt - Plan	
			Në vlerë	Në %
TVSH Neto brenda vendit	27,238	34,662	(7,424)	-21.4%
TVSH Bruto	44,374	52,162	(7,788)	-14.9%
Rimbursimi	17,136	17,500	(364)	-2.1%
Tatimi mbi Fitimin	32,744	29,587	3,157	10.7%
Tatimi mbi të Ardhurat Personale	43,328	37,792	5,536	14.6%
Taksat nacionale	30,902	35,015	(4,113)	-11.7%
Totali i të ardhurave tatimore	134,212	137,056	(2,844)	-2.1%
Kontribute të mbledhura nga DPT	86,630	86,369	261	0.3%
Totali i të ardhurave nga DPT	220,842	223,425	(2,583)	-1.2%

Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë

Të ardhurat nga TVSH-ja neto e brendshme janë 27.2 miliardë lekë, me një realizim prej 78.6 për qind kundrejt planit dhe 6.7 miliardë lekë (19.8%) më pak se 11-mujori i vitit 2018. Në periudhën janar–nëntor 2019, shuma e rimbursuar e TVSH-së ishte 17.1 miliardë lekë, rreth 35.1% ose 4.5 miliardë lekë, më shumë se e njëjta periudhë e vitit 2018. Performanca negative në të ardhurat e TVSH-së së brendshme rezultoi nga ulja e prodhimit të energjisë elektrike vendëse dhe ndikimi i rritjes së madhe të rimbursimit.


Grafiku 4.2.19 Performanca e TVSH-së gjatë vitit (11-mujaj)/ milion lek

Grafiku 4.2.20 Rimbursimet e TVSH-së gjatë vitit (11-mujaj)/ milion lek




Të ardhurat nga tatimi mbi fitimin u realizuan në shumën 32.7 miliardë lekë me një realizim prej 110.7% të planit dhe shënuan një rritje me 8.5% ose 2.6 miliardë lekë me shumë se e njëjta periudhë e vitit paraardhës. Kjo performacë pozitive e tatimit mbi fitimin e shoqërive ka ardhur më së shumti nga situata pozitive e shoqërive që operojnë në sektorin energjetik, e cila i ka dhënë atyre më shumë mundësi të paguajnë tatimin mbi fitimin. Gjithashtu, rritja e tatimit mbi fitimin e vitit 2018 reflektoi rritjen dhe përmirësimin e fitimit të tatueshëm të shoqërive.

Grafiku 4.2.21 Performanca e tatimit mbi fitimit gjatë viteve për periudhën 11 muaj (në milion lek)




Të ardhurat nga tatimi mbi të ardhurat personale u realizuan me 43.3 miliardë, me një realizim prej 114.6% të planit me rritje 28.6% ose 9.6 miliardë lekë krahasuar me vitin 2018. Të ardhurat nga punësimi në sektorin privat dhe sektorin publik janë rritur, si rrjedhojë e rritjes së numrit të të punësuarve dhe të rritjes së nivelit të pagave. Gjithashtu, një rritje të madhe është realizuar në tatimin mbi dividendin, për shkak të politikave të ndërmarra nga qeveria, duke reduktuar normën e tatimit mbi dividendin nga 15% në 8%.

Grafiku 4.2.22 Të ardhurat nga tatimi mbi të ardhurat personale për periudhën 11-mujore (në milion lek)



Të ardhurat nga taksa nacionale për vitin 2019 ishte 30.9 miliardë lekë, me një realizim prej 88.3% të planit.

Grafiku 4.2.23 Të ardhurat nga taksat kombëtare gjatë viteve për periudhën 11-mujore (në milion lek)



Të ardhurat nga kontributet e sigurimeve shoqërore të arkëtuara nga DPT-ja arritën vlerën 79.2 milionë lekë, duke shënuar një rritje prej 5.9% ose 4.8 miliardë lekë në krahasim me vitin 2018 dhe 0.3% ose 261 milionë lekë më shumë se plani. Performanca e lartë dhe rritja e qëndrueshme ka ardhur si pasojë e situatës ekonomike pozitive dhe rritjes së numrit të të punësuarve. Nga ana tjetër, aksioni kundër informalitetit ka dhënë efekte të dukshme në formalizimin e tregut të punës.

4.3 Perspektiva buxhetore afatmesme

Parashikimi i të ardhurave tatimore, për vitin 2020, ka marrë në konsideratë të gjithë faktorët që ndikojnë në buxhet, përfshirë efektin e rritjes ekonomike, si dhe politika fiskale të përshtatshme për të mbështetur këtë rritje. Politikat e reja fiskale dhe efektet e luftës kundër informalitetit së bashku me masat antikorrupsion ndihmojnë në rritjen e pajtueshmërisë vullnetare të taksapagueve me legjislacionin.

Parashikimi i të ardhurave për vitin 2020 mbështet qëllimet e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë për konsolidimin e mëtejshëm fiskal, reduktimin e deficitit buxhetor dhe të borxhit publik. Ky program është bazuar në përmirësimin e administratës fiskale dhe minimizimin e informalitetit në ekonomi, duke mbështetur rritjen e qëndrueshme ekonomike, si dhe rritjen e prodhimit dhe eksportit.

Metodologjia e parashikimit të të ardhurave është bazuar në modelet bashkëkohore të modelimit, sugjeruar dhe aplikuar nga Fondi Monetar Ndërkombëtar dhe duke përfshirë analizën e detajuar të faktorëve të cilët ndikojnë në çdo taksë. Modelet bazë të përdorura janë:

- parashikimi në kuadrin makroekonomik;
- analiza e importit të 60 grup-produkteve bazë dhe në analizën e serive kohore;
- matja dhe vlerësimi i efekteve në treguesit makroekonomikë, duke analizuar efektin në ndryshimin e të ardhurave për çdo përqindje të ndryshimit të PBB (*“Buoyancy”* dhe *“Norma efektive tatimore”*).

Faktorët makroekonomikë, në lidhje me parashikimin e vitit 2020, janë kombinuar me treguesit kryesorë që ndikojnë në çdo taksë. Sasitë dhe çmimet e mallrave kryesore të importuara dhe prodhimi vendës (i cili mbulon 90% të të ardhurave totale) janë analizuar dhe vlerësuar si më poshtë:

- rritja nominale e PBB-së;
- kursi monetar i pritshëm i dy monedhave kryesore USD dhe EUR me lekë;
- çmimet në tregjet financiare që ndikojnë në të ardhurat nga TVSH-ja dhe renta minerare;
- sasitë e parashikuara për import dhe prodhim;
- rritja e të ardhurave nga akcizat për karburant, cigare, pije etj., si rezultat i rritjes së pritshme të sasisë së tyre, në përputhje me konsumin;
- rritja e të ardhurave nga tatimi mbi fitimin, duke reflektuar rritjen e deklarimit dhe qarkullimin e operatorëve ekonomikë;
- rritja e çmimit të naftës bruto për rreth 4% në krahasim me vitin 2019, sipas parashikimeve në EIA, *“Administrata e informacionit të energjisë të SHBA-së”*;
- rritja e të ardhurave nga TVSH-ja në importin dhe TVSH-në e brendshme, lidhur me planifikimin e fondeve të nevojshme për rimbursimin në kohë të tatimpaguesve;
- planifikimi i fondeve të nevojshme për rimbursimin e TVSH-së, me qëllim të zvogëlimit të stokut në vitin 2020 me 67% në krahasim me fundin e vitit 2019.

Të ardhurat totale të mbledhura nga DPD-ja dhe DPT-ja (përfshirë sigurimet shoqërore) vlerësohet të jenë 437.15 miliardë lekë ose 29 miliardë (7.2%) më shumë se viti pararendës 2019. Të ardhurat nga DPD-ja dhe DPT-ja për vitin 2020 vlerësohen të jenë 334.12 miliardë ose 24.5 miliardë (7.9%) më shumë se viti paraprak 2019, ndërsa të ardhurat nga kontributet shoqërore vlerësohet të jenë 103 miliardë ose 4.7 miliardë lekë (4.8%) më shumë se viti fiskal 2019.

Tabela 4.3.1 Të ardhurat totale nga administrata tatimore dhe doganore

Lloji i Tatimit	2017	2018	2019 Paraprak	2020 Plan	Diferenca 2020 - 2019	
					Në vlerë	Në %
1 Total TVSH Neto	139,541	143,464	137,970	151,621	13,651	9.9%
2 Tatimi mbi Fitimin	31,645	34,461	36,483	38,000	1,517	4.2%
3 Akciza	45,105	44,987	46,725	50,500	3,775	8.1%
4 Tatimi mbi të ardhurat personale	32,102	36,517	46,165	47,500	1,335	2.9%
5 Taksa Nacionale dhe të tjera	38,502	38,673	35,765	39,500	3,735	10.4%
6 Taksa Doganore	6,492	6,217	6,482	7,000	518	8.0%
Total DPT+DPD	293,387	304,319	309,590	334,121	24,531	7.9%
7 Kontributet e mbledhura nga DPT	85,601	91,850	98,300	103,025	4,725	4.8%
Total i përgjithshëm i të ardhurave	378,988	396,169	407,890	437,146	29,256	7.2%

Të ardhurat doganore janë projektuar në bazë të analizës së trendit historik të 60 grup-produkteve për një periudhë 6-vjeçare. Ky parashikim është korrigjuar me efektet e faktorëve të jashtëm në çdo taksë. E njëjta procedurë është përdorur për të ardhurat tatimore, bazuar në modelin statistikor të parashikimit të të ardhurave të pritshme, si dhe faktorët ekzogjenë që ndikojnë në çdo taksë.

Faktorët e jashtëm që duhet të merren në konsideratë në ndikimi e rritjes së të ardhurave për vitin 2020 janë:

Kuadri makroekonomik

Rritja nominale e PBB-së është aplikuar, duke analizuar këtë efekt në një metodë të integruar me faktorë të tjerë për çdo taksë në veçanti, në lidhje me të dhënat historike dhe parashikimet e çmimeve në tregjet ndërkombëtare, për tatimet në vlerë si TVSH-ja, renta minerare dhe taksa doganore.

Në parashikim janë përfshirë faktorët e mëposhtëm:

- rritja nominale e PBB-së;
- ndryshimi i kursit të këmbimit euro–lekë dhe dollar–lekë;
- çmimet *brent* të naftës bruto dhe mineraleve të tjera.

Efektet e politikave fiskale

Për vitin 2020 nuk parashikohen ndryshime të mëdha fiskale. Prioritet do të jetë zbatimi dhe matja e efekteve të politikave fiskale të miratuara në 3 vjetët e fundit, me qëllim konsolidimin e sistemit tatimor. Është e rëndësishme të theksohet se duhet të konsolidohet qëndrueshmëria e politikave fiskale, duke stimuluar thjeshtësinë, transparencën, zvogëlimin e kostove të administrimit, si dhe duke shmangur përjashtimet ose tarifat e favorshme.

Ndryshimi kryesor lidhet me ligjin për faturën dhe sistemin e monitorimit të qarkullimit, i cili pritet të ndikojë në transparencën dhe kontrollin e transaksioneve ekonomike, prej të cilëve lindin edhe detyrimet tatimore. Realizimi në kohë reale i transaksioneve biznes–konsumator dhe më pas transaksionet biznes–biznes, duke përdorur faturën elektronike, synon të rritë parametrat e TVSH-së neto brenda vendit nga 8.8% të GDP-së deri në 9.1% brenda një periudhe 2–3-vjeçare.

Parashikimi i të ardhurave për çdo taksë për vitin 2020

Të ardhurat nga TVSH-ja janë parashikohet të arrijnë 151.6 miliardë lekë, 13.6 miliardë lekë ose 8.1% më shumë se viti 2019. Burimi kryesor i rritjes së të ardhurave nga TVSH-ja, për vitin 2020 pritet, të jetë:

- rezultati i rritjes ekonomike dhe indeksit të çmimeve;
- rritja e vëllimit të tregtisë ndërkombëtare dhe rritja e çmimeve ndërkombëtare të naftës;
- rezultati i fushatës antinformalitetit dhe forcimi i bashkëveprimit midis administratave tatimore dhe doganore për të kontrolluar zinxhirin e transaksioneve dhe mbledhjen e kësaj takse në linjën që krijohet.

Të ardhurat nga akciza janë parashikuar të rriten me 3.8 miliardë lekë ose 5.9% më shumë se viti paraardhës, me një vlerë totale 50.5 miliardë lekë. Faktorët kryesorë, që parashikohet të ndikojnë në rritjen e të ardhurave nga akciza, janë si më poshtë:

- rritja me 4% e import/prodhim i karburantit vendës;
- rritja e të ardhurave nga akciza e cigareve me 0.75 miliardë lekë;
- kontroll më i rreptë i subjekteve të akcizës dhe disiplinim i mëtejshëm i procedurave për zbatimin e përjashtimeve dhe rimbursimeve nga kjo taksë.

Të ardhurat nga tatimi mbi fitimin parashikohet të realizohet në masën 38 miliardë lekë ose 1.5 miliardë lekë (+4.2%) më shumë se viti mëparshëm 2019, si rezultat i:

- rritjes ekonomike, e cila do të pasqyrohet edhe në deklaratat e tatimpaguesve;
- forcimi i kontrollit të deklaratave, bazuar në kriteret e riskut;
- rritja e vetëdeklarimit të tatimpaguesve.

Të ardhurat nga tatimi mbi të ardhurat personale parashikohet të realizohen në 47.5 miliardë lekë, 1.3 miliardë lekë ose 2.9% më shumë se viti 2019. Vlerësimi i të ardhurave nga tatimi mbi të ardhurat personale është bërë duke marrë në konsideratë disa faktorë, të tillë si:

- ulja e të ardhurave që vijnë nga taksa e dividendit, pasi në vitin 2019 (përveç dividendit të 2018), u mbledh edhe dividendi i viteve të kaluara. Pra, ky faktor prej rreth 6 miliardë lekësh konsiderohet si “një e ardhur jo e zakonshme”;

- rritja e numrit të kontribuesve aktivë bazuar në ecurinë e vitit 2018 dhe vitit 2019.

- rritja e të ardhurave të tjera personale.

Të ardhurat nga taksat kombëtare vlerësohet të realizohen në 39.5 miliardë lekë, 3.7 miliardë lekë, ose 10.4% më shumë se viti paraardhës 2019.

Të ardhurat nga taksa doganore parashikohet të realizohen në 7 miliardë lekë, 518 milionë lekë ose 8% më shumë se viti fiskal 2019. Në planifikimin e të ardhurave janë marrë parasysh, efektet e rritjes së importeve të tatueshme, si dhe disa efekte minimale nga ndryshimi i taksës doganore.

Të ardhurat nga kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore të mbledhura nga DPT-ja konsiderohen të realizohen në 103 miliardë lekë, 4.7 miliardë ose 4.8% më shumë se viti fiskal 2019, në të cilin të ardhurat nga kontributet për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore ishin 98.3 miliardë. Planifikimi i rritjes së të ardhurave nga kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore mbështetet nga këta faktorë:

- rritja ekonomike, e cila do të reflektohet në rritjen e numrit të të punësuarve;
- forcimi i administratës përmes kontrollit të nivelit të pagës së deklaruar dhe devijimit të saj nga paga reale;
- shkalla e rritjes së të ardhurave nga kontributet për 2 deri 3 vitet e fundit.

Risqet fiskale

Sipas parashikimeve të të ardhurave të vitit 2020 ekzistojnë disa rreziqe fiskale, që konsistojnë në:

Projeksioni i të ardhurave për vitin 2020 bazohet në rritjen nominale ekonomike prej 4.1% dhe indeksin e çmimeve 2.1%. Nëse ekonomia nuk performon në këta parametra, ekziston rreziku për të ardhurat buxhetore. Nëse ekonomia do të rritet jo 4.1% por 3.5% efekti negativ në të ardhurat tatimore do të jetë përafërsisht 3 miliardë lekë.

Në bazë të performancës së vitit 2019, parashikohet një rritje prej 4% në importet e karburantit dhe prodhimit të brendshëm. Mosarritja e kësaj rritjeje mund të rezultojë në një qarkullim më të ulët e cila mund të ketë një efekt negativ në të ardhura me 0.5 miliardë lekë, shkaktuar nga një rënie 0.22 miliardë në TVSH dhe 0.28 miliardë lekë në akcizë.

Shtyrja e afatit të implementimit të ligjit nr. 87/2019, “Për faturën dhe sistemin e monitorimit të qarkullimit”, e cila mund të shkaktojë një efekt negative në TVSH prej 3 miliardë lekësh.

Risku Fiskal	Efekti negativ në të ardhura (në milionë lekë)		
	Akciza	TVSH	TOTAL
Rritja ekonomike 3.5% (në vend të 4.1%)		3,000	3,000
Rritja e sasisë së karburantit (import+vendas) 2.4% (në vend të 4% siç ishte në 2019)	280	220	500
Shtyrja e afatit të implementimit të Ligjit "Për faturën dhe sistemin e monitorimit të qarkullimit"		3,000	3,000
Total	280	6,220	6,500

Huamarrja në periudhën afatmesme

Në periudhën afatmesme, nevojat për financim do të plotësohen duke përdorur burimet e brendshme dhe ato të huaja të financimit.

Burimet e brendshme të financimit do të vazhdojnë të jenë burimi kryesor i financimit (mbi 80% të financimit bruto), me qëllim zhvillimin e tregut të brendshëm të titujve shtetërorë, si edhe mbajtjen e riskut të kursit të këmbimit nën kontroll (borxhi në monedhë të huaj jo më shumë se 55% e totalit të borxhit shtetëror). Huamarrja e brendshme do të vazhdojë të bazohet kryesisht te sektori bankar, ndërkohë që ka pritshmëri pozitive për rritjen e aktivitetit të institucioneve jofinanciare dhe individëve.

Nëpërmjet titujve afatshkurtër, kryesisht do të synohet rifinancimi me sukses i titujve ekzistues që maturohen dhe menaxhimi aktiv i nevojave për likuiditet. Ndërkohë, nëpërmjet titujve afatgjatë do të synohet të mbulohet financimi i deficitit buxhetor. Struktura e financimit të brendshëm do të jetë fleksibël në terma të përzgjedhjes së titujve shtetërorë, në varësi të kushteve të tregut të brendshëm (niveli i kërkesës, normat e interesit etj.), duke garantuar në këtë mënyrë

optimizimin e kostove, në përputhje me objektivat e vendosur për të menaxhuar risqet e portofolit të borxhit.

Në periudhën afatmesme, huamarrja nëpërmjet burimeve të huaja do të plotësojë nevojat vjetore për hua të qeverisjes qendrore (në terma bruto) deri në 20%, si edhe do të kontribuojë në optimizimin e kostove të portofolit të borxhit, duke qenë se një pjesë e konsiderueshme e këtij financimi do synojë të sigurohet me terma koncesionalë dhe gjysmëkoncesionalë (nëpërmjet burimeve dypalëshe dhe shumëpalëshe të financimit). Huamarrja nga burime bilaterale dhe multilaterale do të përdoret kryesisht për të financuar projektet strategjike të qeverisë dhe reformat e ndërmarra nga qeveria. Gjithashtu, burimet private të financimit të siguruara në tregjet ndërkombëtare të kapitalit do të përdoren kryesisht për qëllime të menaxhimit të riskut, menaxhimit të detyrimeve të borxhit në valutë të huaj, si edhe për të shmangur konsumin e burimeve të brendshme dhe stimuluar kreditimin e sektorit privat.

4.4 Bilanci strukturor

Vlerësimi i PBB-së potenciale dhe i hendekut të prodhimit


Teknika e filtrimit *Hodrick-Prescott (HP)* është përdorur për të vlerësuar serinë e PBB-së potenciale.

Filtrimi HP është aplikuar në rritjen ekonomike aktuale vjetore, duke marrë parasysh vlerat më të përshtatshme të parametrave λ , në rastin e të dhënave vjetore, përkatësisht $\lambda = 100$; $\lambda = 30$; $\lambda = 6.5$. Rritja e PBB-së potenciale u nxor më pas si një mesatare e serive të filtrimit HP bazuar në këta tre parametra të ndryshëm të λ -s. Bazuar në rritjen potenciale të përfituar, u nxor më pas niveli i PBB-së potenciale dhe, në përputhje me të, u llogarit dhe niveli i *output*-it. Parashikimet e FMN-së WEO (tetor 2019), për periudhën 2020–2022, u përdorën për të adresuar problemin e të dhënës së fundit që shfaq teknika e filtrimit HP

$$\text{Hend. Pr odhimit}_t = \frac{PBB_{t,aktuale} - PBB_{t,potencial}}{PBB_{t,potencial}}$$

Hendeku i prodhimit është paraqitur në anën e majtë të figurës së mëposhtme.

Grafiku 4.4.1 Hendeku i prodhimit (në të majtë), rritja potenciale dhe aktuale (në të djathtë)



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë

Rezultatet na tregojnë se prodhimi aktual ka qenë nën potencialin e tij gjatë 2002–2006, thuhet në potencial në vitin 2017 dhe, më pas është tejkaluar në mënyrë të konsiderueshme në vitin 2008.

Lëvizja e fundit pozitive në hendekun e prodhimit vazhdoi disi dhe gjatë viteve 2009–2012, duke u ngushtuar gradualisht, si pasojë e rritjes aktuale më të ulët krahasuar me potencialin, në sajë të krizës globale financiare. Megjithatë Shqipëria arriti ta kalojë relativisht lehtë goditjen e parë nga kriza globale në vitin 2009, duke shmangur një recesion të mundshëm që ndodhi në pjesën më të madhe të vendeve të tjera, gjithsesi, rritja aktuale u dobësua ndjeshëm krahasuar me nivelet e para krizës dhe me rritjen potenciale. Në vitin 2013 u shënua rritja më e ulët dhe në të

njëjtën kohë hendeku i prodhimit u zhvendos në negativ dhe qëndroi i tillë deri në vitin 2017, me maksimumin e arritur në vitin 2015. Hendeku i prodhimit u mbyll më 2018 dhe pritet të kthehet lehtësisht në terma negativë në vitet 2019 dhe 2020. Duke vazhduar më tej në vitet 2021 dhe 2022, pritet që hendeku i prodhimit të konvergojë në potencialin e tij.

Vlerësimi i elasticiteteve dhe i ndjeshmërisë së buxhetit ndaj hendekut të prodhimit

Pasi u hoqën faktorët që kanë pasur ndikime vetëm në një periudhë të caktuar, u vlerësuan elasticitetet e të ardhurave dhe të shpenzimeve edhe me metodën e disagregimit (sipas qasjes së OECD-së 2005) dhe me metodën agregate (sipas qasjes së FMN-së 2010). Gjithsesi, elasticitetet finale totale të marra nga secila metodë ishin pothuajse të ngjashme. Për të qenë më konkretë, elasticiteti i përgjithshëm i të ardhurave, i nxjerrë nga elasticitetet specifike të zërave kryesorë të të ardhurave me metodën e disagregimit ishte 1.03, ndërsa elasticiteti i vlerësuar nga metoda agregate ishte 1.45⁹. Të ardhurat totale u rregulluan për efektet e ciklit, duke aplikuar mbi to elasticitetin mesatar të përfituar nga të dyja qasjet, i cili është:

$$\bar{\epsilon}_{R,Y} = \text{mesatare}(1.03, 1.45) = 1.24$$

Për sa u përket elasticiteteve të shpenzimeve, ato nuk ishin të ndryshme nga niveli zero. Analiza e regresionit na prodhoi elasticitete të shpenzimeve me shenjë negative, sipas të dyja metodave, por asnjëra prej tyre nuk ishte statistikisht e rëndësishme, duke na treguar se

koeficienti i elasticitetit është i barabartë me zero $\epsilon_{G,Y} = 0$. Për më tepër shpenzimet totale nuk u rregulluan për efekte ciklike. Aplikimi direkt i formulës së ndjeshmërisë për bilancin e buxhetit ndaj hendekut të prodhimit (ose i ashtuquajtur elasticitet i pjesshëm) na dha vlerën e mëposhtme:

$$\epsilon_B = r(\bar{\epsilon}_{R,Y} - 1) - g(\epsilon_{G,Y} - 1) = 0.251(1.24 - 1) - 0.261(0 - 1) = 0.321$$

ku: $r = 0.251$ është norma mesatare e të ardhurave totale ndaj PBB-së (duke përjashtuar faktorët njëndikimësh) për 5 vjetët e fundit (2013–2017), $g = 0.261$ është norma mesatare e shpenzimeve primare ndaj PBB-së (duke përjashtuar faktorët njëndikimësh) për 5 vjetët e fundit (2013–2017). Parametri i vlerësuar i ndjeshmërisë buxhetit na thotë se për çdo pikë përqindjeje negative (pozitive) të hendekut të prodhimit, bilanci i përgjithshëm fiskal primar do të përkeqësohet (përmirësohet) me 0.321 pikë përqindjeje të PBB-së potenciale.

Llogaritja e bilancit fiskal të rregulluar ciklikisht dhe vlerësimi i politikës fiskale në ekonomi

Bazuar te hendeku i prodhimit (OG) dhe parametri i ndjeshmërisë së buxhetit (ϵ_B), komponenti ciklik i bilancit fiskal primar (CPB) në terma të PBB-së potenciale është llogaritur si: $CBT_t = \epsilon_B * OG_t$. Ndërkohë, stabilizatorët automatikë janë përkufizuar si ndryshimi i CPB-së të dy

viteve rresht (AS), pra: $AS_t = CPB_t - CPB_{t-1}$

Bilanci primar i rregulluar ciklikisht (CAPB) llogaritet si diferencë mes bilancit primar fiskal aktual (PB) dhe komponentit të tij ciklik (CPB): $CAPB_t = PB_t - CPB_t$.

Bilanci i përgjithshëm i rregulluar ciklikisht (CAB) del pasi bilancit primar të rregulluar ciklikisht i hiqen shpenzimet për interesat (INT): $CAB_t = CAPB_t - INT_t$

Impulsi fiskal (FI) në terma të PBB-së potenciale është ndryshimi i bilancit primar të rregulluar ciklikisht çdo vit, relativisht me vitin e kaluar: $FI_t = CAPB_{t-1} - CAPB_t$.


Bazuar në drejtimin e impulsit fiskal (ngushtues apo zgjerues) dhe hendekut të prodhimit (negative ose pozitive), ne po japim një paraqitje të thjeshtë për sa i përket natyrës së politikës fiskale, n.q.s. ajo ka qene prociklike, kundërciklike apo neutrale. Rezultatet e marra janë paraqitur në tabelën dhe grafikun më poshtë.

⁹ Për shkak të mungesës së të dhënave dhe serive relativisht të shkurtra, në rastin e qasjes së disagregimit, disa nga elasticitetet/koeficientët e vlerësuar nuk ishin të rëndësishëm në nivelet konvencionale dhe disa supozime u vendosën.

Tabela 4.4.1 Politika fiskale

Viti	Hendeku I Prodimit	Balanca e Pergjithshme fiskale Aktuale	Balanca Primare Fiskale	Balanca Primare Giklike	Balanca Primare e rregulluar Giklikisht	Shpenzimet e Interesit	Balanca e Pergjithshme e rregulluar (CAB)	Stabilizuesit Automatik	Impulsi Fiskal (FI)	Politika Fiskale krahasuar me hendekun e prodhimit
1999	1.4	-9.6	-1.7	0.4	-2.2	7.9	-10.0	-	-	-
2000	0.5	-8.0	-2.1	0.1	-2.2	5.9	-8.1	-0.3	0.1	Neutrale
2001	1.5	-7.2	-3.0	0.5	-3.5	4.2	-7.7	0.3	1.2	Pro-ciklike
2002	-0.4	-6.2	-2.2	-0.1	-2.0	4.1	-6.1	-0.6	-1.4	Pro-ciklike
2003	-1.0	-5.0	-0.6	-0.3	-0.3	4.4	-4.7	-0.2	-1.7	Pro-ciklike
2004	-1.3	-5.2	-1.3	-0.4	-0.9	3.9	-4.7	-0.1	0.6	Kunder-Giklike
2005	-1.4	-3.5	-0.3	-0.5	0.2	3.2	-3.0	0.0	-1.1	Pro-ciklike
2006	-1.0	-3.4	-0.5	-0.3	-0.2	2.9	-3.1	0.1	0.4	Kunder-Giklike
2007	-0.1	-3.5	-0.9	0.0	-0.8	2.7	-3.5	0.3	0.7	Kunder-Giklike
2008	2.6	-5.6	-2.7	0.8	-3.5	2.9	-6.4	0.9	2.7	Pro-ciklike
2009	1.9	-7.1	-3.9	0.6	-4.5	3.2	-7.7	-0.2	1.0	Pro-ciklike
2010	2.2	-3.1	0.3	0.7	-0.4	3.4	-3.8	0.1	-4.1	Kunder-Giklike
2011	1.8	-3.5	-0.4	0.6	-0.9	3.2	-4.1	-0.1	0.5	Pro-ciklike
2012	0.6	-3.4	-0.3	0.2	-0.5	3.1	-3.6	-0.4	-0.4	Kunder-Giklike
2013	-0.7	-5.0	-1.7	-0.2	-1.5	3.2	-4.7	-0.4	1.0	Kunder-Giklike
2014	-1.4	-5.2	-2.3	-0.4	-1.9	2.9	-4.7	-0.2	0.3	Kunder-Giklike
2015	-1.8	-4.1	-1.4	-0.6	-0.8	2.7	-3.5	-0.1	-1.1	Pro-ciklike
2016	-1.4	-1.8	0.7	-0.5	1.1	2.5	-1.4	0.1	-1.9	Pro-ciklike
2017	-0.8	-2.0	0.1	-0.3	0.3	2.1	-1.7	0.2	0.8	Kunder-Giklike
2018	0.0	-1.6	0.6	0.0	0.6	2.2	-1.6	0.2	-0.3	Kunder-Giklike
2019	-0.8	-1.9	0.2	-0.2	0.4	2.1	-1.7	-0.2	0.2	Kunder-Giklike
2020	-0.2	-2.2	0.1	-0.1	0.1	2.3	-2.2	0.2	0.3	Kunder-Giklike
2021	0.2	-2.0	0.5	0.0	0.4	2.5	-2.0	0.1	-0.3	Kunder-Giklike
2022	0.6	-1.7	0.8	0.2	0.6	2.5	-1.9	0.1	-0.2	Kunder-Giklike

Grafiku 4.4.2 Politika fiskale



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë

Tabela 4.4.2 Politika fiskale lidhur me ciklin e ekonomisë

Politika Fiskale	Njesia	Vitet	
		2000 - 2019	2020 - 2022
Pro-ciklike	numër	9	0
Kunder-Ciklike	numër	10	3
Neutrale	numër	1	0
Hendeku i Prodhimit Kumulativ v.s. Politika Fiskale Kumulative --> Politika Fiskale			
Hendeku i Prodhimit Kumulativ	p.p.të PBB-së	-1.1	0.5
Impulsi Fiskal Kumulativ	p.p.të PBB-së	-2.6	-0.2
Politika Fiskale e Përgjithshme		Pro-ciklike	Kunder-Ciklike

Kjo analizë e thjeshtë empirike tregon se gjatë viteve 2000–2019, politika fiskale ka qenë prociklike në nëntë raste (vite), kundërciklike në dhjetë raste dhe neutrale në një rast. Ndërsa për horizontin afatmesëm, politika fiskale parashikohet të jetë kundërciklike në të gjitha vitet (2020 dhe 2022).

Kur matet si shumë kumulative e impulseve fiskale të çdo viti, në lidhje me hendekun kumulativ të prodhimit, politika fiskal rezulton prociklike gjatë viteve 2000–2019. Më konkretisht, hendeku kumulativ i prodhimit për vitet 2000–2019 rezulton negativ, me 1.1 pikë përqindjeje të PBB-së potenciale, ndërkohë që impulsset fiskale kumulative për periudhën përkatëse rezultojnë gjithashtu negative në 2.6 pikë përqindjeje të PBB-së. Kjo tregon një politikë fiskale prociklike që pasqyron borxhin publik relativisht të lartë dhe, për këtë arsye nënkupton që i është dhënë një rëndësi më e madhe objektivit të sigurimit të qëndrueshmërisë afatgjatë të financave publike, kundrejt objektivit të stabilizimit afatshkurtër të cikleve ekonomike. Në periudhën afatmesme 2020–2022, impulsi fiskal kumulativ është parashikuar të jetë negativ, në përputhje me objektivin kryesor të reduktimit të borxhit publik, megjithëse gjatë kësaj periudhe pritet të mbështetet edhe objektivi i stabilizimit ekonomik, për aq kohë sa hendeku kumulativ i prodhimit do të jetë pozitiv.

4.5 Ecuria e borxhit të qeverisjes qendrore

Përgjatë nëntëmuorit të vitit 2019, borxhi i qeverisjes qendrore përgjithësisht u karakterizua nga një ecuri pozitive, duke qenë në përputhje me buxhetin e planifikuar për vitin 2019 dhe objektivat e Strategjisë Afatmesme të Menaxhimit të Borxhit (SAMB). Nevojat e qeverisë për financim janë plotësuar me sukses, duke mbajtur raporte të pranueshme ndërmjet kostos dhe risqeve, ndërkohë që janë ndërmarrë aktivitete të cilat synojnë zhvillimin e mëtejshëm të tregut primar të titujve shtetërorë.

Në linjë me buxhetin e vitit 2019 është realizuar me sukses huamarrja, e cila ka mundur rifinancimin e borxhit ekzistues dhe menaxhimin e nevojave për likuiditet. Nëpërmjet burimeve të brendshme dhe të huaja, huamarrja është realizuar përkatësisht në nivelin 45.2% dhe 67.1% të planit vjetor¹⁰.

Në linjë me objektivat e Strategjisë Afatmesme të Menaxhimit të Borxhit u menaxhua ulja e mëtejshme e ekspozimit ndaj risqeve në portofolin e borxhit të brendshëm, duke mbajtur nën kontroll kostot e borxhit.

Borxhi i qeverisjes qendrore

Në fund të muajit shtator 2019, borxhi i qeverisjes qendrore u vlerësua në nivelin 1,109.9 miliardë lekë ose 65.1% e PBB¹¹. Në terma nominalë, stoku i borxhit të qeverisjes qendrore është rritur me rreth 3.3 miliardë lekë, krahasuar me fundin e vitit 2018, nga të cilat 9.6 miliardë lekë i korrespondojnë rritjes së borxhit të brendshëm dhe -6.2 miliardë lekë borxhit të jashtëm. Pavarësisht sa më sipër, rritja e borxhit në terma nominalë është brenda kufijve të parashikuar në ligjin vjetor të buxhetit dhe në përputhje me objektivat afatmesëm makrofiskalë për uljen e nivelit

¹⁰ Plan i vjetor referuar aktit normativ nr. 2, datë 2.10.2019, “Për buxhetin e vitit 2019”.

¹¹ PBB mbi bazë vjetore, sipas draftkuadrit makroekonomik dhe fiskal, 2021–2023.

të borxhit, në raport me PBB-në. Në përputhje me objektivat makrofiskalë, parashikimet sinjalizojnë se borxhi i qeverisjes qendrore, në raport me PBB-në do të vazhdojë të qëndrojë në trajektoren rënëse dhe pritet të ulet me rreth 2.5 pikë përqindjeje deri në fund të vitit 2019.


Tabela 4.5.1 Stoku i borxhit të qeverisjes qendrore (në milion lek)

	2015	2016	2017	2018	Sht. 2019
Stoku i borxhit gjithsej (I+II)	1,042,272.0	1,065,709.0	1,087,341.9	1,106,568.8	1,109,893.6
I. Stoku i borxhit të brendshëm	551,375.0	561,120.0	577,055.7	580,310.3	589,870.5
Shtetëror	520,936.0	530,834.0	546,938.7	565,092.5	574,703.0
Garanci	30,439.0	30,286.0	30,117.0	15,217.8	15,167.5
II. Stoku i borxhit të jashtëm	490,897.0	504,589.0	510,286.2	526,258.5	520,023.1
Shtetëror	465,306.0	481,407.0	490,517.9	496,804.2	492,066.2
Garanci	25,591.0	23,182.0	19,768.2	29,454.3	27,956.9
PBB	1,434,308.0	1,472,479.6	1,551,281.4	1,630,904.8	1,705,246.4
Stoku i borxhit gjithsej /PBB	72.7%	72.4%	70.1%	67.8%	65.1%
Stoku i borxhit të brendshëm/PBB	38.4%	38.1%	37.2%	35.6%	34.6%
Stoku i borxhit të jashtëm/PBB	34.2%	34.3%	32.9%	32.3%	30.5%

Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë

Borxhi i qeverisjes qendrore ka ndjekur të njëjtën tendencë si në vitin 2018, për sa i përket kompozimit sipas maturitetit dhe instrumenteve. Peshën më të madhe (60%) në stokun e borxhit të qeverisjes qendrore vazhdojnë ta mbajnë instrumentet e tregtueshme (bono thesari, obligacione, eurobond), duke reflektuar kushtet e favorshme të tregut të brendshëm dhe tregjeve ndërkombëtare.


Grafiku 4.5.1 Kompozimi i borxhit të qeverisjes qendrore sipas instrumenteve



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë

Në përputhje me objektivat për reduktimin e ekspozimit të portofolit të borxhit ndaj risqeve, pesha e instrumenteve afatgjata u rrit me 0.4 pikë përqindjeje.

Grafiku 4.5.2 Kompozimi i borxhit sipas maturitetit original të instrumenteve të huas



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë

Burimet e financimit

Gjatë periudhës janar–shtator 2019, Ministria e Financave dhe Ekonomisë ka emetuar në tregun e brendshëm tituj shtetërorë në vlerën 246.3 miliardë lekë, nga të cilat 235.9 miliardë lekë kanë shërbyer për rifinancimin e titujve ekzistues. Në linjë me objektivin për reduktimin e ekspozimit ndaj risqeve, financimi neto (huamarrja e re) është siguruar kryesisht nëpërmjet titujve afatgjatë.

Tabela 4.5.2 Huamarrja e brendshme

Lloji i instrumentit	Janar–shtator 2019			
	Emetime (në mld lekë)	Maturime (në mld lekë)	Financimi neto (në mld lekë)	Financimi neto (në %)
Instrumente afatshkurtra	164.3	163.2	1.1	10.6%
Bono thesari	164.3	163.2	1.1	10.6%
Instrumente afatgjata	82.0	72.8	9.2	89.4%
Obligacione 2-vjeçare	31.8	45.8	-14.0	-135.3%
Obligacione 3-vjeçare	14.1	10.7	3.4	32.6%
Obligacione 5-vjeçare	17.7	11.3	6.4	61.4%
Obligacione 7-vjeçare	8.9	5.0	3.9	38.0%
Obligacione 10-vjeçare	9.6	0.0	9.6	92.7%
Total	246.3	235.9	10.3	100.0%

Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë

Gjatë nëntëmujorit të vitit 2019, huamarrja e huaj bruto u realizua në vlerën 107.5 milionë euro dhe është siguruar kryesisht nëpërmjet burimeve shumëpalëshe dhe dypalëshe në formën e huave që financojnë projektet ekzistuese. Niveli i realizimit të huamarrjes së huaj ka qenë në nivele të krahasueshme me të njëjtën periudhë të një viti më parë.

Tabela 4.5.3 Huamarrja e huaj

	9m. 2018		9m. 2019	
	Shuma (në mln euro)	%/Total	Shuma (në mln euro)	%/total
Disbursimet total	104.4	100.0%	107.5	100.0%
Mbështetje buxhetore	0.2	0.2%	14.0	13.0%
Hua për financim projektsh	104.1	99.8%	93.5	87.0%


Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë

Kosto dhe risqet

Kushtet e favorshme në tregjet e brendshme dhe të jashtme për sa i përket kërkesës për borxh, si edhe mjedisi i favorshëm i normave të interesit gjatë vitit 2019, shoqëruar me një strategji huamarrje të mbështetur kryesisht në titujt afatgjatë me norma interesi fikse, mundësuan reduktimin e mëtejshëm të ekspozimit ndaj risqeve, si edhe mbajtjen e koston nën kontroll gjatë vitit 2019.

Në portofolin e borxhit të brendshëm ka vazhduar ulja e koston për njësi. Ulja e koston për njësi të borxhit të brendshëm ndërkohë që maturiteti i borxhit vazhdon të rritet, reflekton një përmirësimin në raportin ndërmjet koston dhe riskut.


Grafiku 4.5.3 Borxhi i brendshëm afatshkurtër/ borxhi i brendshëm afatgjatë dhe NMP



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë

Shpenzimet për interesa gjatë periudhës janar–shtator të vitit 2019 janë vlerësuar në 25.4 miliardë lekë. Krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2018, në përputhje me parashikimet për buxhetin e vitit 2019, shpenzimet për interesa të borxhit shtetëror janë rritur me 2.1 miliardë lekë. Rritja e shpenzimeve për interesa i atribuohet kryesisht rritjes së stokut të borxhit në vlerë nominale.


Grafiku 4.5.4 Interesat e borxhit shtetëror në vlerë absolute dhe relative ndaj PBB-së



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë

Në periudhën afatmesme, pritet një rritje graduale e shpenzimeve për interesa në vlerë nominale, si rezultat i rritjes së stokut të borxhit. Megjithatë, në terma relativë ndaj PBB-së dhe të ardhurave tatimore, kostoja e borxhit pritet të qëndroje në nivele të qëndrueshme dhe nën mesataren e pesë vjetëve të fundit.

Grafiku 4.5.5 Shpenzimet për interesa dhe interesa ndaj PBB-së dhe të ardhurave tatimore



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë

Reduktimi i riskut të rifinancimit dhe i riskut të normave të interesit në tregun e brendshëm është ndër objektivat parësorë në menaxhimin e portofolit të borxhit. Në këtë drejtim, progres është bërë edhe gjatë nëntëmuorit të vitit 2019.

Borxhi i jashtëm paraqet më pak risk se borxhi i brendshëm, kryesisht pasi është i kompozuar nga instrumente me afat të gjatë maturimi dhe një pjesë e konsiderueshme e tij është me terma koncesionalë.

Risku i rifinancimit është përmirësuar, pasi jetëgjatësia e borxhit të brendshëm është rritur, duke prekur nivelin e 819 ditëve në fund të muajit shtator 2019, krahasuar me 783 ditë në fund të vitit 2018.

Risku i normave të interesit, gjithashtu, është përmirësuar si rezultat i reduktimit të peshës së instrumenteve me afat të shkurtër maturimi dhe instrumenteve me norma interesi të ndryshueshme, përkatësisht me 0.38 dhe 1.57 pikë përqindjeje, krahasuar me fundin e vitit 2018. Gjithashtu, pesha e instrumenteve që rivlerësojnë normën e interesit në harkun kohor të një viti është ulur nga 54.3% në dhjetor 2018 në 50.8% në shtator 2019.

Tabela 4.5.4 Treguesit e riskut të normave të interesit në borxhin e brendshëm

Treguesi	2017	2018	Sht-2019
Obligacione me norma interesi të ndryshueshme/totalit	8.8%	6.5%	4.9%
Obligacionet me norma interesi fikse/totalit	55.6%	59.1%	61.0%
Borxhi i rivlerësuar në një vit/totalit	56.7%	54.3%	50.8%

Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë


Pavarësisht zhvillimeve pozitive të tregut të brendshëm, portofoli i borxhit vazhdon të jetë i ekspozuar ndaj riskut të rifinancimit dhe riskut të normave të interesit. Nisur nga ky fakt, në të ardhmen, menaxhimi i borxhit të vazhdojë përpjekjet për zgjatjen e mëtejshme të jetëgjatësisë së borxhit të brendshëm, si edhe mbajtjen nën kontroll të peshës së instrumenteve me norma interesi të ndryshueshme.

Zhvillimi i tregut

Tregu primar i titujve shtetërorë gjatë periudhës janar–shtator të vitit 2019, përgjithësisht është karakterizuar nga zhvillime pozitive, ndër të cilat mund të përmenden kërkesa e kënaqshme e tregut në raport me nevojat e qeverisë për huamarrje dhe rënia e normave të interesit në krahasim me ato të vitit 2018.

Gjatë periudhës janar–shtator të vitit 2019, kërkesa për tituj shtetërorë ka rezultuar në vlerën 318.7 miliardë lekë, nga të cilat 190.1 miliardë lekë për bono thesari dhe 128.7 miliardë lekë për obligacione. Kërkesa gjatë nëntëmuorit të vitit 2019 ka qenë relativisht më e lartë se oferta e qeverisë për tituj shtetërorë, duke rezultuar në një raport të përgjithshëm mbulimi prej 1.26.


Grafiku 4.5.6 Kërkesa dhe oferta për tituj shtetërorë në tregun e brendshëm



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë

Në vazhdim të angazhimit të marrë, në lidhje me përmirësimin e mëtejshëm të tregut primar të titujve shtetërorë, si edhe hedhjen e hapave për funksionimin e tregut sekondar, përgjatë vitit 2019 janë ndërmarrë aktivitete që kanë për qëllim reduktimin e fragmentizimit të kërkesës dhe krijimin e madhësive *benchmark* për titujt afatgjatë. Për sa i përket krijimit të madhësive *benchmark*, ka vazhduar implementimi i projektit pilot për emetimin e obligacioneve 5-vjeçare referencë, pasi rezultatet paraprake të këtij projekti kanë qenë pozitive në kuadër të rritjes së aktivitetit të tregtimit të titujve në tregun sekondar. Nisur nga këto rezultate, gjatë vitit 2019 ky projekt është shtrirë edhe te obligacionet 3-vjeçare. Për më tepër, numri i titujve të emetuar është konsoliduar duke përdorur ankandet e rihapjes së titujve ekzistues në vend të emetimeve të reja.

Grafiku 4.5.7 Ecuria e ankandave në tregun primar



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë

Në periudhën afatmesme, zhvillimi i tregut primar do të bazohet kryesisht në aktivitetet të cilat kanë për qëllim rritjen e likuiditetit, eficiencës dhe transparencës.

Ecuria e normave të interesit

Krahasuar me fundin e vitit 2018, normat e interesit gjatë vitit 2019, kanë shfaqur tendencë rënëse, duke reflektuar vazhdimin e politikave lehtësuese të ndërmarra nga Banka e Shqipërisë, si edhe reduktimin e nevojave për hua të qeverisë në gjysmën e parë të vitit, për shkak të likuiditetit të mjaftueshëm të siguruar nga emetimi i eurobondit gjatë vitit 2018.

Grafiku 4.5.8 Yield-i mesatar i ponderuar




Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë

Gjatë periudhës afatmesme normat e interesit në tregun e brendshëm pritet të rriten gradualisht, por gjithsesi duke qëndruar në nivele të krahasueshme me mesataren e normat të viteve të fundit.

Detyrimet kontingjente

Në fund të muajit shtator 2019, portofoli i borxhit të garantuar vlerësohet në 43.1 miliardë lekë (2.5% e PBB-së) ose 3.9% e portofolit të borxhit të qeverisjes qendrore. Garancitë në tregun e brendshëm përfaqësojnë 35.2% të totalit të stokut të borxhit të garantuar ose 15.2 miliardë lekë, ndërsa garancitë e emetuara në favor të kreditorëve të huaj përfaqësojnë 64.8% të stokut të borxhit të garantuar ose 28.0 miliardë lekë. Garancitë e brendshme përbëhen nga linja kredie afatshkurtra dhe me norma interesi tregtare, të cilat i janë akorduar KESH sh.a. nga bankat tregtare vendëse. Në dallim nga garancitë e brendshme, garancitë e huaja janë kredi afatgjata të akorduara kryesisht me norma interesi koncesionare.

Grafiku 4.5.9 Garancitë shtetërore



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë

Në periudhën afatmesme, niveli i garancive është planifikuar të qëndrojë në nivelin 5%–6% ndaj PBB-së dhe garancitë e reja do të emetohen, kryesisht:

- për të mbështetur projektet zhvillimore të cilat kontribuojnë në përmirësimin e infrastrukturës, zhvillimin rajonal, mbrojtjen e mjedisit dhe krijimin e vendeve të reja të punës;
- për të mbështetur masat e mundshme të ndërmarra në rast të përkeqësimit të sistemit financiar;
- për të menaxhuar risqet dhe kostot e portofolit ekzistues të detyrimeve kontingjente.

Koncesionet dhe PPP-të

Ministria e Financave vlerëson dhe miraton paraprakisht të gjitha projektet koncesionare dhe të partneritetit publik privat (PPP), si edhe çdo ndryshim të tyre, nga pikëpamja e implikimeve individuale apo në grup, për shpenzimet buxhetore, deficitin buxhetor, qëndrueshmërinë e borxhit publik dhe detyrimet kontingjente eventuale. Shuma e përgjithshme e pagesave vjetore neto, që kryhen nga njësitë e qeverisjes së përgjithshme, të cilat rezultojnë nga kontrata koncesionare apo partneriteti publik privat (PPP), si rregull, nuk duhet të tejkalojnë kufirin prej 5 për qind të të ardhurave tatimore faktike të vitit paraardhës buxhetor. Në rast tejkalimi të këtij kufiri, Këshilli i Ministrave merr masa korrektuese në krahun e të ardhurave buxhetore, të nevojshme dhe të mjaftueshme, për t'u rikthyer brenda kufirit të lejuar, gjatë dy viteve të ardhshme buxhetore.

Aktualisht, janë aktive 13 kontrata koncesionare apo partneriteti publik privat (PPP)¹² sipas tabelës 4.5.5 të mëposhtme:

Tabela 4.5.5 Koncesionet/PPP aktive me mbështetje financiare nga buxheti i shtetit

Autoriteti Kontraktor	Nr.	Emërtimi i Kontratës PPP	Viti i fillimit	Viti i përfundimit	Programi	Lloji i shpenzimit	në mijë lekë				
							2019 11 majori	2019 Plan	2020 Parashikimi	2021 Parashikimi	2022 Parashikimi
Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë	1	Ndërtimi, operimi dhe transferimi i inceneratorit për përpunimin e mbetjeve urbane të Bashkisë së Elbasanit	2015	2021	06220	Investime	484,916	661,500	661,500	331,000	0
	2	Ndërtimi, operimi dhe transferimi i inceneratorit për përpunimin e mbetjeve urbane të Bashkisë Fier	2016	2023	06220	Investime	504,576	752,772	752,770	752,770	752,770
	3	Ndërtimi, Operimi dhe Transferimi (BOT) HEC mbi lumin Devoll, rimbursimi i ndërtimit të rrugëve zëvendësuese ¹	2015	2019	04320	Investime	1,505,821	1,580,406	0	0	0
	4	Ndërtimi dhe Operimi i Rugës së Arbit	2018	2030	04520	Investime	2,654,774	2,701,500	3,925,000	3,325,000	3,000,000
	5	Ndërtim, Operim dhe Mirëmbajtje e Rugës Milot-Morinë	2017	2047	04520	Investime	558,598	685,000	720,000	720,000	692,000
	6	Ndërtimi dhe Operimi i Porti Jahteve Orikum - Dukat	2018	2030	04520	Investime	0	0	393,147	1,087,880	1,036,300
	7	Ndërtimi dhe Operimi i Rugës Milot - Ballëdren	2018	2032	04520	Investime	0	0	100,000	100,000	312,000
Ministria e Financave dhe Ekonomisë	1	Shërbimi i Skanimit në Dogana	2013	2030	01150	Komente	1,384,497	1,512,571	1,540,896	1,587,123	1,634,737
Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale	1	Koncesioni/PPP Kontrolli bazë i popullsisë (check up)	2015	2024	07220	Komente	803,076	876,083	876,083	876,083	876,083
	2	Koncesioni/PPP (Ofrimi i setit të personalizuar të instrumenteve kirurgjikale, material mjekësor steril njëpërdorimësh në sallat kirurgjikale, trajtimi i mbetjeve biologjike dhe dezinfektimi i sallave kirurgjikale)	2015	2024	07330	Komente	1,907,940	2,134,827	1,655,322	1,704,982	1,756,211
	3	Koncesioni/PPP (Ofrimi i shërbimit të dializës në 5 spitale rajonale)	2016	2025	07330	Komente	719,650	751,448	688,581	734,021	756,200
	4	Ofrimi i Shërbimeve laboratorike spitale	2019	2028	07330	Komente	0	0	1,280,444	1,290,241	1,300,136
Bashkia Tiranë / Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë	1	Për përmirësimin e infrastrukturës arsimore në Bashkinë Tiranë	2017	2024	09120	Investime	0	0	1,018,303	1,528,336	1,401,505
Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë / Bashkia Tiranë	1	Për ndërtimin e landfillit, inceneratorit dhe rehabilitimin e vendeve ekzistuese Tiranë dhe prodhimin e energjisë elektrike	2017	2046	06220	Komente	977,125	977,125	998,410	1,165,124	1,165,124
TOTALI							11,560,973	12,633,232	14,610,456	15,202,560	14,683,066
Totali i të Ardhurave Tatimore parashikuar për periudhën 2019-2021							448,336,713	465,089,688	490,815,966	...	...
Respektimi i Rregullit Fiskal (përpjesa e pagesave të PPP ndaj totalit të të ardhurave tatimore të vitit paraardhës buxhetor më pak se 5%)							2.8%	3.0%	3.3%	3.3%	3.0%

*Kontrata PPP "Ndërtimi, Operimi dhe Transferimi (BOT) HEC mbi lumin Devoll, rimbursimi i ndërtimit të rrugëve zëvendësuese përfundon në fund të vitit 2019, vit në të cilin parashikohet të kryhet dhe pagesa e fundit.

Për sa i përket respektimit të nenit 4/2, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor", ku përcaktohet, se: "... shuma e përgjithshme e pagesave vjetore neto, që kryhen nga njësitë e qeverisjes së përgjithshme, të cilat rezultojnë nga kontrata koncesionare apo partneriteti publik privat (PPP), si rregull, nuk duhet të tejkalojnë kufirin prej 5 për qind të të ardhurave tatimore faktike të vitit paraardhës buxhetor", për vitin 2020, vërehet se:

- për vitin 2020, kufiri i lejuar i pagesave neto për kontratat koncesionare/PPP, prej 5% të të ardhurave tatimore të pritshme të vitit 2019, është rreth 22.42 miliardë lekë;
- referuar tabelës X, për vitin 2020 pagesat vjetore neto që parashikohen të kryhen nga njësitë e qeverisjes së përgjithshme për kontratat koncesionare apo PPP-ve, kapin vlerën rreth 14.6 miliardë lekë;
- rrjedhimisht, në buxhetin 2020 është respektuar kufizimin ligjor i sipërcituar në zbatim të rregullës fiskale respektive, pasi vlera e parashikuar prej 14.6 miliardë lekësh për pagesat vjetore neto të kontratave koncesionare

¹ Kontrata PPP "Ndërtimi, operimi dhe transferimi (BOT) HEC mbi lumin Devoll, rimbursimi i ndërtimit të rrugëve zëvendësuese përfundon në fund të vitit 2019, vit në të cilin parashikohet të kryhet dhe pagesa e fundit.

apo PPP për vitin 2020, përbën vetëm 3.3 për qind të totalit të të ardhurave tatimore të parashikuara për vitin 2019, prej rreth 448.3 miliardë lekësh.

Gjatë vitit 2019, Ministria e Financave dhe Ekonomisë ka intensifikuar monitorimin e performancës së kontratave koncesionare/PPP-ve me mbështetje buxhetore, duke monitoruar jo vetëm ecurinë e pagesave faktike buxhetore, por edhe treguesit e performancës të planifikuar/të realizuar për secilën kontratë koncesionare/PPP. Duke filluar nga viti 2019, monitorimi dhe raportimi mbi kontratat koncesionare/PPP është institucionalizuar përmes përfshirjes në udhëzimin plotësues nr. 1, datë 17.1.2019, “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2019”, të skedulit të detyrueshëm kohor të raportimit të tyre nga çdo autoritet kontraktor dhe të formateve standarde respektive, me qëllim thellimin e analizës dhe rritjen e transparencës. Ky monitorim është kryer në bazë mujore.

Për sa i përket ecurisë faktike të pagesave koncesionare, për periudhën janar–nëntor 2019 dhe pritshmëritë deri në fund të vitit 2019, në vijim jepet një tablo përmbledhëse:

Fondet buxhetore të planifikuara për vitin 2019, me destinacion mbështetjen nga buxheti për kontratat koncesionare/PPP, janë në total rreth 12.63 miliardë lekë. Nga këto, rreth 6.38 miliardë lekë janë investime dhe 6.25 miliardë lekë shpenzime korrente.

Kundrejt faktit të vitit 2018 që kapi vlerën 8.76 miliardë lekë, plani 2019 rezulton 44.2% më i lartë ose rreth 3.87 miliardë lekë më shumë.

Pagesat faktike, në total për 11-mujorin 2019, rezultojnë 11.56 miliardë lekë ose 91.5% e planit vjetor 2019, të ndryshuar. Nivelin më të lartë të pagesave e ka shënuar muaji janar, me 2.9 miliardë lekë nga të cilat 2.52 miliardë lekë është pagesa për kontratën e MIE-s “Ndërtimi dhe operimi i Rrugës së Arbrit”, specifikisht për ndërtimin, operimin dhe mirëmbajtjen e kësaj kontrate.

Krahasuar me pagesat faktike për 11-mujorin e vitit 2018, fakti 11-mujor i vitit 2019 rezulton në masën 4.1 miliardë lekë më shumë ose 55.9 për qind më i lartë.

Theksojmë faktin, se për kontratën koncesionare/PPP, “Ndërtimi i rrugës së Arbrit”, në vitin 2018 nuk ka pasur asnjë pagesë buxhetore.

Bazuar në parashikimin e ecurisë së pagesave për muajin e fundit të vitit 2019, fondi i planifikuar për t’u shpenzuar është 742.5 milionë lekë, nivel ky që do të përmbushte 97.4% planin vjetor për vitin 2019.

4.4 Analiza e ndjeshmërisë dhe krahasimi me programin e mëparshëm


Ky seksion paraqet ndikimet e pritshme në kuadrin fiskal, si dhe rregullimet e mundshme të politikave fiskale. Kjo është në përputhje me të dy skenarët alternativë makroekonomikë të paraqitura në nenin 3.3.

Në rastin e skenarit “pesimist”, i cili supozon një rritje të konsiderueshme më të ulët se parashikimi i skenarit bazë gjatë çdo viti, kuadri fiskal përkatës do të bazohet në elasticitetin më të ulët të taksave se në skenarin bazë. Ky supozim reflekton arsyetimin se në përgjithësi një nivel dukshëm më i ulët i rritjes ekonomike pritet të çojë në arkëtim më të ulët të taksave për një numër komponentësh kryesorë të taksave. Ndërsa në rastin e skenarit “optimist” makroekonomik, të ardhurat ndaj PBB-së janë supozuar më të larta se në skenarin bazë.

Politika e konsoliduar fiskale është planifikuar të ruhet në çdo skenar makroekonomik. Megjithatë, objektivi sasior i deficitit fiskal vjetor ndryshon pak në çdo skenar, duke pasqyruar një rregullim kundër ciklik ndaj dinamikave të ndryshme të supozuara të ciklit ekonomik. Më konkretisht, është parashikuar një relaksim i objektivit të deficitit fiskal në rastin e skenarit “pesimist” dhe një konsolidim i fortë fiskal në rastin e skenarit “optimist”. Pjesa e humbur (shtrëngim) e objektivit nominal të deficitit në skenarin “pesimist” (“optimist”) është sa gjysma e devijimit të të ardhurave totale në secilin prej skenarëve alternativë kundrejt skenarit bazë. Borxhi publik pritet të reduktohet në çdo skenar. Megjithatë, në kundërshtim me skenarin bazë makroekonomik, trajektorja e reduktimit të borxhit publik është më i zbutur në rastin e skenarit “pesimist”, si dhe në rastin e skenarit “optimist”.

Pjesa kryesore e shpenzimeve të cilat janë planifikuar për të absorbuar shumicën e efekteve fiskale në rastin e secilit skenar alternativ janë: Shpenzimet korrente me financim të brendshëm. Edhe pse ekziston një linjë e qartë e kontigjencave për goditjet në normat e interesit në buxhetet afatmesme, si dhe kontingjenca të tjera të nënkuptuara, ne nuk llogarisim përdorimin *ex ante* të tyre për të përmbushur objektivat e deficitit në skenarin pesimist. Sidoqoftë, në praktikë (*ex post*), në rast se të ardhurat rezultojnë të jenë më të ulëta se në skenarin bazë, por në të njëjtën kohë nuk do të ketë goditje të normave të interesit dhe për më tepër nuk ka shpenzime shtesë në zërin e interesave, si te skenari i buxhetimit bazë (që është rasti më i besueshëm), atëherë një hapësirë fiskale që varion prej 0.3% të PBB-së për çdo vit do të ishte automatikisht në dispozicion për të absorbuar një pjesë të presioneve fiskale në rast të një skenari pesimist. Gjithashtu, nevojat më të larta për financimin e deficitit në rastin e skenarit “pesimist” pritet të mbulohen nga huamarrja e brendshme neto më e lartë. Implikimet fiskale të skenarëve alternativë makroekonomikë janë paraqitur në tabelën dhe grafikët në vijim.

Grafiku 4.6.1 Indikatorët kryesorë fiskalë për çdo skenar



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë

Tabela 4.6.1 Indikatorët kryesorë fiskalë për çdo skenar

	2013	2014	2015	2016	2017	2018	2019	2020	2021	2022
							Vler	Para	Para	Para
Të ardhurat totale (në miliard Lek)										
Bazë	327.2	366.7	379.2	407.0	430.4	449.9	462.5	509.7	520.4	549.5
Pesimist								496.0	501.2	524.2
Optimist								512.1	525.4	557.5
Shpenzimet totale (në miliard Lek)										
Baza nga e cila :	394.1	438.8	437.4	433.7	461.4	476.1	495.4	549.4	557.3	582.4
(% PBB)	29.2%	31.5%	30.5%	29.5%	29.7%	29.2%	29.3%	30.9%	29.6%	29.3%
Shpenzimet korrente	328.6	341.0	350.8	368.7	382.3	397.3	420.0	446.0	466.8	486.0
(% PBB)	24.3%	24.4%	24.5%	25.0%	24.6%	24.4%	24.9%	25.1%	24.8%	24.4%
Shpenzimet kapitale nga të cilat:	65.5	60.7	63.1	59.5	68.5	78.4	75.4	101.6	88.6	94.4
(% PBB)	4.8%	4.4%	4.4%	4.0%	4.4%	4.8%	4.5%	5.7%	4.7%	4.7%
Financim i brëndshëm	36.7	34.0	38.1	39.1	46.2	52.2	50.4	52.3	52.6	58.2
Financim i jashtëm	28.8	26.8	24.9	20.4	22.3	26.2	24.9	29.3	31.1	34.2
Pesimist nga e cila :								542.5	547.7	569.7
(% PBB)								30.8%	29.7%	29.5%
Shpenzimet korrente								446.0	466.8	486.0
(% PBB)								25.3%	25.3%	25.1%
Shpenzimet kapitale nga të cilat:								94.8	79.0	81.7
(% PBB)								5.4%	4.3%	4.2%
Financim i brëndshëm								45.5	43.0	45.6
Financim i jashtëm								29.3	31.1	34.2
Optimist nga e cila :								550.6	559.8	586.4
(% PBB)								30.8%	29.5%	29.0%
Shpenzimet korrente								446.0	466.8	486.0
(% PBB)								25.0%	24.6%	24.1%
Shpenzimet kapitale nga të cilat:								102.9	91.1	98.4
(% PBB)								5.8%	4.8%	4.9%
Financim i brëndshëm								49.3	52.1	59.2
Financim i jashtëm								29.3	31.1	34.2
Deficiti i Përgjithshëm (% e PBB-së)										
Bazë	-5.0	-5.2	-4.1	-1.8	-2.0	-1.6	-1.9	-2.2	-2.0	-1.7
Pesimist			-4.1	-1.8	-2.0	-1.6	-1.9	-2.6	-2.5	-2.4
Optimist			-4.1	-1.8	-2.0	-1.6	-1.9	-2.2	-1.8	-1.4
Financimi i deficitit të përgjithshëm (në miliard Lek)										
Bazë nga e cila :	66.9	72.1	58.2	26.7	31.0	26.2	32.9	39.7	36.9	32.9
Huamarrja e brëndshme neto	46.3	38.2	-17.3	10.6	16.3	19.6	18.5	29.9	22.9	22.9
Huamarrja neto e jashtme nga e cila:	10.8	29.9	64.6	17.5	29.1	33.1	-7.5	14.2	-16.1	37.7
Mbështetje buxhetore nga IFIs	0.0	30.5	111.5	21.1	31.3	0.9	1.6	3.5	7.0	0.0
Tjetër, huamarrja e jashtme	9.6	1.3	-43.9	-3.2	-2.4	32.1	-9.1	10.7	-23.1	37.7
Pesimist nga e cila :								46.5	46.5	45.6
Huamarrja neto e brëndshme								36.7	32.5	35.6
Huamarrja neto e jashtme nga e cila:								14.2	-16.1	37.7
Mbështetje buxhetore nga IFIs								3.5	7.0	0.0
Tjetër, huamarrja e jashtme								10.7	-23.1	37.7
Optimist nga e cila :								38.5	34.4	28.9
Huamarrja neto e brëndshme								28.7	20.4	18.9
Huamarrja neto e jashtme nga e cila:								14.2	-16.1	37.7
Mbështetje buxhetore nga IFIs								3.5	7.0	0.0
Tjetër, huamarrja e jashtme								10.7	-23.1	37.7
Balanca primare (% të PBB-së)										
Bazë	-1.7	-2.3	-1.4	0.7	0.1	0.6	0.2	0.1	0.5	0.8
Pesimist			-1.4	0.7	0.1	0.6	0.2	-0.3	0.0	0.2
Optimist			-1.4	0.7	0.1	0.6	0.2	0.1	0.6	1.0
Borxhi publik NET i stokut të likuiditetit në TSA (% e PBB-së)										
Bazë	69.4	71.4	71.9	71.7	68.7	64.9	64.5	63.6	62.2	60.5
Pesimist			71.9	71.7	68.7	64.9	64.5	64.6	64.3	63.8
Optimist			71.9	71.7	68.7	64.9	64.5	63.3	61.4	59.2
Borxhi publik total (% PBB-së)										
Bazë	70.4	72.0	72.7	72.4	70.1	67.9	66.2	65.4	62.3	62.0
Pesimist			72.7	72.4	70.1	67.9	66.2	66.5	64.4	65.3
Optimist			72.7	72.4	70.1	67.9	66.2	65.0	61.5	60.7

Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë

4.7 Qeverisja fiskale dhe kuadri buxhetor

Qeverisja fiskale dhe kuadri buxhetor janë çështjet kryesore të ciklit të Menaxhimit të Financave Publike (MFP). Reforma e MFP-së është në zbatim. Gjatë vitit 2019, Ministria e Financave dhe Ekonomisë ka përgatitur strategjinë e re të MFP-së, 2019-2022. Strategjia u miratua me vendim të Këshillit të Ministrave më 18 dhjetor 2019. Ajo zëvendëson strategjinë e mëparshme të periudhës 2014-2020, duke u bazuar në rishikimin afatmesëm të vitit 2018 (RA) të Strategjisë, e cila synon zgjatjen e strategjisë dhe planin e veprimit për MFP përtej vitit 2020, me dy vite shtesë deri në vitin 2022, për të mundësuar një kalim të lehtë në Instrumentin e Ndhmës Paraadherimit (IPA) pas vitit 2020.

Programi do të përshkruajë ndryshime të parashikuara në qeverisjen fiskale të vendit, d.m.th., në grupin e mekanizmave, rregullave dhe institucioneve që mbështesin politikën fiskale, siç janë:

1. Rregullat fiskale numerike

Objektivi kryesor i qeverisë në strategjinë e re të MFP-së, 2019-2022, do të vazhdojë të jetë forcimi i kuadrit afatmesëm makrofiskal, duke përmirësuar rregullat procedurale që do të kërkojnë të eliminojnë riskun e paragjyqimeve sistematike optimiste në parashikimet e PBB-së dhe të ardhurave nga buxheti. Gjithashtu, qeveria do të përpikët të forcojë më tej monitorimin dhe menaxhimin e riskut fiskal. Qeveria e Shqipërisë do të punojë për të adresuar rekomandimin e bërë nga vlerësime të ndryshme që kuadri fiskal duhet të strukturohet rreth një spirance fiskale më operative, siç është bilanci primar, se sa raporti i borxhit dhe që në mënyrë që borxhi të jetë në një rënie derisa të arrijë 45 për qind të PBB-së, dhe të përgatisë një udhëzim operacional.

2. Institucionet e pavarura fiskale për të monitoruar performancën fiskale dhe/ose këshillojnë qeverinë për çështje të politikës fiskale

Qeveria, krijimin e planifikuar, fillimisht të një këshilli fiskal, e zëvendësoi me futjen e rregullave fiskale në LOB, i cili ka bërë të mundur që MFE-ja të ketë një spirancë efektive për përcaktimin e hapësirave fiskale, duke filluar me buxhetin e vitit 2017. Ndryshimet në LOB janë të hollësishme dhe të qarta. Ata arrijnë të njëjtin objektiv me atë të një këshilli fiskal, d.m.th., parashikime më realiste të të ardhurave dhe shpenzimeve. Në kontekstin e administratës publike shqiptare, ato kanë përparësinë e të qenit të përfshirë në ligj dhe të jenë menjëherë të zbatueshëm.

3. Kuadri buxhetor afatmesëm

Shumë boshllëqe janë identifikuar në procesin e PBA-së. Me ndihmën e asistencës teknike të MFP-së, janë adresuar disa nga këto dobësi, për shembull, miratimi i një metodologjie të re për përgatitjen e PBA-së dhe udhëzimeve të reja për përgatitjen e buxhetit. Këto ndryshime rregullatore kanë kontribuar në forcimin e kapacitetit të MFE-së dhe të ministrive të linjës për formulimin dhe përgatitjen e PBA-së dhe të buxhetit, por ende duhet të punohet për të forcuar rolin udhëzues të dokumentit të PBA-së dhe cilësinë e fazës strategjike të përgatitjes së buxhetit. Për më tepër, rishikimi i parashkrimeve të kërkesave buxhetore të institucioneve buxhetore zbuloi se më shumë theks duhet t'i kushtohet zbatimit të buxhetimit, bazuar në performance, ku bëhet përcaktimi i qëllimeve strategjike, objektivave dhe treguesve të rezultatit në nivel programi. Buxhetimi i Përgjegjshëm Gjinnor (BPGJ) në Shqipëri ka përparuar gjatë pesë vjetët e fundit. Ndryshimet e fundit në LOB më 2016, si dhe ligji i financave vendore i miratuar në vitin 2017, kanë bërë që të gjithë institucionet e pushtetit qendror dhe vendor të menaxhojnë të gjitha politikat dhe buxhetet e tyre, në përputhje të plotë me parimet e barazisë gjinore. Megjithatë, ekzistojnë ende sfida të konsiderueshme në strategjinë e MFP-së, 2019-2022, në mënyrë që të zbatohet plotësisht BPGJ-ja në ciklin MFP, në nivelin qendror dhe vendor.

4. Përdorimi i parashikimeve reale, të paanshme për planifikimin e buxhetit dhe vlerësimin e rregullt të tyre

Siç u shpjegua më lart, përmirësimi i rregullave procedurale do të çojë në eliminimin e rrezikut sistematik optimist të paragjyqimeve në parashikimet e PBB-së dhe të ardhurave buxhetore. Për këtë qëllim, në Strategjinë e re të MFP-së, MFE-ja ka planifikuar të blejë dhe të përdorë një softuer të përshtatshëm të TI-së, për modelet e parashikimit të të ardhurave dhe të përgatisë udhëzimet për përdoruesit që të përdorin, siç duhet modelet e të ardhurave nga taksat.

5. Disponueshmëria dhe cilësia e të dhënave fiskale dhe përputhja me standardet ESA

Progres është arritur drejt fuqizimit të INSTAT-it, megjithatë në strategjinë e MFP-së, 2019–2022, është përfshirë përgatitja e një sistemi statistikor gjithëpërfshirës, të standardizuar për njësitë e qeverisë së përgjithshme, i cili do të duhet të përgatitet dhe do të shoqërohet me rishikime të politikave, procedurave standarde dhe formateve për të mundësuar përgatitjen e raporteve sipas ESA 2010. Në këtë kontekst, forcimi i grupit ndërinstitucional të punës dhe zhvillimi i një sistemi të integruar të përpilimit të SFQ-së do të jetë në fokus në vitet e ardhshme, si pjesë e strategjisë së MFP-së, 2019–2022. Për më tepër, tabelat e njoftimeve për EDP-në janë dërguar rregullisht në EUROSTAT që nga viti 2014, megjithatë kërkojnë zhvillime të mëtejshme.

4.8 Fiscal governance and budgetary frameworks

Autoritetet pritet të shpalosin strategjinë e tyre të politikave, në lidhje me qëndrueshmërinë e financave publike. Në mbështetje të kësaj strategjie, programet do të paraqesin një analizë të qëndrueshmërisë afatgjatë të financave publike, veçanërisht, në dritën e tendencave të parashikuara në shpenzimet e pensioneve dhe kujdesit shëndetësor. Politikat themelore duhet të përshkruhen siç duhet dhe parashikimet duhet të bazohen në “skenari aktual i politikës”. Në rast të reformave të planifikuara, por ende jo të implementuara, duhet të ofrohet një tabelë alternative e “skenarit të reformës” dhe të përshkruhen reformat, siç janë në fushën e pensioneve dhe kujdesit shëndetësor.

Strategjia e MFP-së, 2019–2022, synon të konsolidojë mësimet e marra dhe rezultatet e rena dakord pas rishikimit afatmesëm të realizuar në 2018 dhe të shërbejë si një kuadër dhe udhëzues për të udhëhequr përmirësimet në rezultatet e MFP-së, për vitin 2019–2022. Kjo strategji e rishikuar mundëson që qeveria e Shqipërisë të përfshijë masat e kërkuara të MFP-së që janë shfaqur që nga viti 2014, brenda këtij kuadri, në mënyrë që këto prioritetet të adresohen në mënyrë efektive. Edhe pse janë bërë ndryshime në strategji, themeli mbetet i njëjtë me vizionin dhe objektivin e përgjithshëm që ruhet:

Vizioni i Strategjisë së Reformës së MFP-së është të sigurojë një sistem të financave publike që promovon transparencën, përgjegjshmërinë, disiplinën fiskale dhe efikasitetin në menaxhimin dhe përdorimin e burimeve publike për ofrimin e shërbimeve më të mira dhe zhvillimin ekonomik.

Objektivi i përgjithshëm i Strategjisë së Reformës së MFP-së është të arrihet një buxhet më i balancuar dhe i qëndrueshëm me një raport të zvogëluar të borxhit përmes menaxhimit më të fortë financiar dhe proceseve të kontrollit dhe auditimit dhe, kur ekzekutimi i buxhetit është i lidhur siç duhet me politikat e qeverisë. Strategjia është riorganizuar për të reflektuar prioritetet në ndryshim të reformave të MFP-së, që nga viti 2014, dhe tani adresohet përmes shtatë (jo gjashtë) “Objektivave specifike” (më parë shtyllat), në përputhje me kuadrin e rishikuar strategjik të planifikimit dhe monitorimit që është prezantuar së fundmi nga Kryeministria (KM):

Objektivi specifik 1. Kuadri fiskal i qëndrueshëm dhe i matur. Përmes këtij objektivi, qeveria pret që të ketë një kuadër të kujdesshëm makroekonomik dhe politikë fiskale që synon uljen e raportit të borxhit/PBB-së, për një periudhë afatmesme në 60 për qind dhe të mbajë në mënyrë më efektive risqet fiskale.

Krijimi i kadastrës fiskale në vetvete nuk parashikon ndikim të drejtpërdrejtë në treguesit socialë, siç janë: punësimi, ulja e varfërisë, punësimi kombëtar dhe gjinia. Ndikimi i vetëm i drejtpërdrejtë në punësim është punësimi i stafit për agjencitë e reja në nivelin e qeverisë qendrore dhe lokale. Në planin afatgjatë, masa pritët të stimulojë investimet e huaja direkte përmes sigurisë juridike, duke krijuar kështu më shumë biznese dhe duke rritur punësimin, por

Kadastrës Fiskale, nëpërmjet një projekti totalisht të financuar, i cili filloi në vitin 2018. Sidoqoftë aktivitetet e mëparshme nuk janë anuluar por janë riorganizuar si pjesë e ristrukturimit të aktiviteteve të projektit. Duke e krahasuar me PRE 2019–2022, së fundmi është prezantuar një aktivitet shtesë për vitin 2020, që prezantohet për herë të parë në PRE 2020–2022.

¹⁷ Nuk ka aktivitete të planifikuara më 2020–ën. Gjithsesi, nëse ka rishikime ose nëse merren në konsideratë aktivitete të reja këtë vit ato do të reflektohen në të ardhmen

¹⁸ DPTP-ja ka organizuar një cikël trajnimesh me punonjësit e bashkive në vend, të cilat kanë pasur qëllime të ndryshme, si: prezantimi i sistemit, familjarizimi me funksionalitetet e sistemit të cilat janë në përditësim të vazhdueshëm dhe prezantimi i metodologjisë. Ndërsa, me prefekturat trajnimet janë përqendruar në kompetencat dhe çështjet që ato duhet të mbështeten, kur vlerësojnë vendimet e Këshillit Bashkiak në lidhje me taksën e pasurisë. Ky proces do të vazhdojë edhe në të ardhmen.

asnjë efekt nuk parashikohet me dallimet gjinore. Sidoqoftë, në sistemin e kadastrës, numri i pronarëve femra tashmë është rritur.

7. Ndikimi i pritsbëm në mjedis

Krijimi i kadastrës fiskalë në vetvete nuk parashikon ndikim të drejtpërdrejtë në mjedis.

8. Rreziqet e mundshme

Rreziku	Probabiliteti (i ulët, i lartë)	Veprimi i planifikuar për uljen e rrezikut
Pasaktësia e të dhënave ekzistuese për ndërtesat	E lartë	Të gjitha ndërtesat do të regjistrohen në sistem. Tashmë 586,164 nga 1.500,000 ndërtesa janë regjistruar, të cilat përmbajnë informacion për pronarin (poseduesin) dhe për sipërfaqen. Drejtoria e Përgjithshme e Taksës së Pasurisë tashmë zotëron të dhëna nga ALUIZNI dhe ZRPP-ja, por cilësia e të dhënave është shumë e ulët. Sidoqoftë kjo drejtori është e vetëdijshme për cilësinë e këtyre të dhënave dhe është duke punuar, me qëllim që të identifikojë mjetet e duhura për t'i bërë këto të dhëna të disponueshme për të gjitha bashkitë.
Mungesa e fondeve/burimeve financiare të mjaftueshme	E ulët	Ky risk është reduktuar nga asistenca ndërkombëtare. SIDA e cila ka siguruar ndihmën teknike dhe mbështetjen financiare përmes një grandi për zhvillimin e sistemit financiar të IT-së.
Mungesa e burimeve në bashki	E ulët	Burimet në bashki duhet të jenë të disponueshme për të trajtuar regjistrimin, informacionin dhe ankesat, pasi të fillojë taksimi. Rritja e eficientës së administrimit të taksës së pasurisë së paluajtshme do të reduktojë riskun, por gjithsesi Ministria e Financave dhe Ekonomisë duhet të ndërmarre hapa të tjerë dhe bashkitë duhet të sigurojnë stafin e duhur.

Reforma 08: Zhvillimi i kuadrit ligjor në mbështetje të start up inovative

1. Përshkrimi

Vitet e fundit, roli i *start up*-eve inovative ka fituar në mënyrë të qëndrueshme rolin si një forcë nxitëse për zhvillimin ekonomik dhe shoqëror drejt një shoqërie të bazuar në dije. Suksesi i ndërmarrjeve *start-up* dhe potenciali i tyre për t'u rritur varet nga një sërë faktorësh.

Kuadri i politikave për inovacionin në Shqipëri është i shpërndarë në tri dokumente: Strategjia kombëtare e shkencës, teknologjisë dhe inovacionit (2017–2022); Strategjia e zhvillimit të biznesit dhe investimeve (2014–2020); dhe Plani i veprimit për inovacionin brenda kuadrit të politikave për inovacionin (2017–2022), i cili u përgatit në bashkëpunim me OECD-në.

Qeveria e Shqipërisë, është e përkushtuar të krijojë një kornizë të favorshme ligjore për *start-up*-et e dhe, për këtë qëllim ka kërkuar mbështetje financiare nga projektet dhe donatorët e huaj, për të kuptuar tërësisht kuadrin legjislativ të bizneseve të reja dhe mënyrat e mundshme të krijimit të politikave mbështetëse.

Është objektivi specifik i këtyre projekteve përmirësimi i ekosistemit inovator dhe nxitja për krijimin e *start-up*-ve në Shqipëri.

2. Aktivitetet e planifikuara

a) Aktivitetet e planifikuara më 2020-ën:

- fillimi i konsultimit publik me palët e interesuara për hartimin e ligjit për *start-up*;
- hartimi i ligjit për *start-up*.

b) Aktivitetet e planifikuara më 2021-shin:

- miratimi i ligjit për *start-up*;
- hartimi dhe miratimi i akteve nënligjore bazuar në ligjin e miratuar;

- hartimi dhe miratimi i kuadrit politik dhe skemave mbështetëse me fokus në produktet apo shërbimet inovative dhe krijimi i një modeli të ri biznesi.

c) Aktivitetet e planifikuara më 2022-shin:

- zbatimi i ligjit të ri dhe i skemave mbështetëse.

3. Indikatorët e rezultateve

Indikatori	Bazë (viti)	Objektivi i ndërmjetëm (viti)	Objektivi (viti)
Miratimi i ligjit të ri “Mbi <i>start-up</i> inovative” dhe akteve nënligjore		Miraturar (2021)	Në zbatim (2022)
Miratimi i kuadrit politik dhe skemave mbështetëse për <i>start-up</i>		Miraturar (2021)	Në zbatim (2022)
Të paktën 2 thirrje për aplikim për skemat mbështetëse për <i>start-up</i> dhe të paktën 5 <i>start-up</i> të financuara nga thirrjet		1 thirrje; 2 <i>start-up</i> të financuara	2 thirrje; 5 <i>start-up</i> të financuara

4. Ndikimi i pritshëm në konkurrueshmëri

Politikat në mbështetje të sipërmarrjeve dhe start-ups mund të nxisin zhvillimin dhe rritjen e start-ups, duke siguruar një mjedis të përshtatshëm për këto ndërmarrje (p.sh., përmes lehtësimit të pengesave financiare për start-ups). Duke u përqendruar në idetë dhe shërbimet inovative të biznesit, start-ups paraqesin një segment specifik të ekonomisë, i cili ka potencialin për të përcaktuar suksesin dhe mirëqenien e ekonomisë në planin afatgjatë. Start-ups sjellin prurje të reja dhe adaptojnë teknologjitë ekzistuese në treg dhe, për këtë arsye krijojnë mundësi për komercializimin e rezultateve të kërkimit shkencor.

5. Kostoja e parashikuar e aktiviteteve dhe burimi i financimit

Kostot e aktiviteteve dhe burimi i financimit janë të detajuara në tabelat 10a dhe 10b.

6. Ndikimi i pritshëm në rezultatet sociale, si: punësimi, ulja e varfërisë, barazia dhe gjinia

Start-ups krijojnë vende pune në sektorët e orientuar nga e ardhmja në ekonomi dhe sjellin një impuls proaktiv për ekonominë përmes mënyrës së tyre konkurruese dhe dinamike të funksionimit. Ky ligj dhe programet e tjera janë, gjithashtu, veçanërisht të rëndësishme për zhvillimin e sipërmarrjes nga femrat, pasi ato zakonisht lehtësojnë kërkesat në lidhje me elementet e sigurisë (kolateral, letër garancie etj.) me rastin e aprovimit të financimit, gjë që është e rëndësishme për gratë sipërmarrëse, pasi ato zakonisht zotërojnë më pak kolateral.

7. Ndikimi i pritshëm në mjedis

Reforma nuk parashikon ndikim të drejtpërdrejtë në mjedis.

8. Rreziqet e mundshme

Ekziston mungesa e bashkëpunimit dhe e koordinimit midis qeverive kompetente dhe organizatave joqeveritare. Ekosistemi shqiptar i start-ups dhe i inovacionit është në një fazë shumë të hershme të zhvillimit të tij, kështu që ky status vjen së bashku me disa sfida (ndërtimi i kapaciteteve, stafi etj.).

Reforma 09: Përmirësimi i aksesit në financë për NVM-të

1. Përshkrimi

NVM-të në Shqipëri janë kontribues të rëndësishëm në ekonomi. Më 2017-ën, NVM-të krijuan 80.3% të totalit të punësimit, që korrespondon me pothuajse katër nga pesë vende pune të ofruara në Shqipëri dhe gjeneruan më shumë se dy të tretat (68.3%) vende pune si vlerë të shtuar. Në drejtim të punësimit që sigurojnë NVM-të, tregtia me shumicë dhe pakicë ishte sektori me rritje më të shpejtë në Shqipëri në vitet 2016–2017, duke gjeneruar rritje prej 6.6% dhe duke tejkaluar ndjeshëm normën mesatare të rritjes prej 1.5% të NVM-ve në BE, në të njëjtin sektor. Ndërsa numri i personave të punësuar është rritur me gati 50% që nga viti 2012.

Reforma synon të zbatojë politika proaktive për t’iu përgjigjur më mirë forcave të konkurrueshmërisë në tregjet rajonale dhe më gjerë. Kjo reformë do të zbatohet përmes zhvillimit të një kornize ligjore dhe institucionale, si dhe përmes bashkëpunimit me institucionet financiare.

Qëllimi i kësaj reforme është sigurimi i një aksesit adekuat në financa për secilën fazë të zhvillimit të NVM-ve, duke përmirësuar tregun financiar dhe atë të kapitalit, duke krijuar kushte për funksionimin dhe zgjerimin e instrumenteve të ndryshëm financiarë që nuk ishin të pranishëm në tregun e brendshëm (skemat garantuese etj.), duke optimizuar financimin publik dhe duke përmirësuar nivelin e informacionit dhe aftësive të NVM-ve për të pasur akses në lloje të ndryshme të financimit.

2. Aktivitetet e planifikuara

a) Aktivitetet e planifikuara më 2020-ën:

- krijimi i njësisë së veçantë brenda Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë për të promovuar zhvillimin e NVM-ve;

- kryerja e një analize të përshtatshme për krijimin e një platforme të centralizuar informacioni për burimet financiare nga donatorët, sektorët privatë dhe publik, si një mjet i rëndësishëm për NVM-të;

- studim për zbatimin e mundshëm të skemave të garancisë së kredisë, bazuar në praktikën më të mira ndërkombëtare për të lehtësuar kreditimin e NMVM-ve.

b) Aktivitetet e planifikuara më 2021-shin:

- krijimi i një platforme të centralizuar informacioni për burimet financiare nga donatorët, sektorët privat dhe publik të aksesueshme nga NVM-të;

- hartimi dhe konsultimi publik me të gjithë aktorët lidhur me miratimin e skemave të të pjesshme garantuese të kredive.

c) Aktivitetet e planifikuara më 2022-shin:

- miratimi i akteve ligjore lidhur me skemat e pjesshme garantuese të kredive.

3. Indikatorët e rezultateve

Indikatori	Bazë (viti)	Objektivi i ndërmjetëm (viti)	Objektivi (viti)
Miratimi i strukturës së re në MFE	0	Qershor 2020	Dhjetor 2020
Numri i përdoruesve të platformës së centralizuar të informacionit	0	1000	5000
Miratimi i akteve ligjore për skemat e pjesshme të garancisë	N/A	N/A	Miraturar
Rritje e normës të NVM-ve që përfitojnë nga rritja e aksesit në financa	0	5%	10%

4. Ndikimi i pritshëm në konkurrueshmëri

Akses i përmirësuar në financë për NVM-të dhe një ndikim i drejtpërdrejtë në konkurrueshmëri në atë pjesë të ekonomisë e cila ka kontributin më të madh në PBB dhe punësim në sektorin jofinanciar. Rritja e investimeve e nxitur nga një akses më i mirë në financë do të ketë një ndikim pozitiv në forcimin e kapaciteteve, modernizimin teknologjik të prodhimit, rritjen e produktivitetit dhe futjen e produkteve dhe të shërbimeve të reja inovative nga NVM-të.

5. Kostoja e parashikuar e aktiviteteve dhe burimi i financimit

Kostot e aktiviteteve dhe burimi i financimit janë të detajuara në tabelat 10a dhe 10b.

6. Ndikimi i pritshëm në rezultatet sociale, si: punësimi, ulja e varfërisë, barazia dhe gjinia

Prezantimi i instrumenteve të reja financiare për fillimin e një biznesi dhe zhvillimi i NVM-ve do të kontribuojë drejtpërdrejt në krijimin e vendeve të punës dhe vetëpunësim. Reforma është veçanërisht e rëndësishme, sepse do të ndihmojë në fuqizimin e grave sipërmarrëse duke lehtësuar kanalet e komunikimit drejt financimit, gjë që është e rëndësishme për gratë sipërmarrëse.

7. Ndikimi i pritshëm në mjedis

Masa nuk parashikohet të ketë ndikim në mjedis.

8. Rreziqet e mundshme

Ekzistojnë rreziqe të mundshme që lidhen me zbatimin e reformës, të tilla si: paqëndrueshmëria makroekonomike dhe fiskale, dhe bashkëpunim e koordinim i ulët ndërinstitucional midis qeverisë dhe organizatave joqeveritare.

Reforma 10: Modernizimi i instrumenteve të pagesave retail

1. Përshkrimi

Objektivi kryesor i “Strategjisë kombëtare të pagesave me vlerë të vogël” është promovimi i përdorimit intensiv të instrumenteve moderne të pagesave me vlerë të vogël në të gjithë vendin, me qëllim arritjen e 10 pagesave elektronike për frymë deri në fund të vitit 2022. Zgjerimi i mundësisë për aksesin në llogaritë është një kusht i domosdoshëm për të arritur objektivin kryesor. Në këtë drejtim, Shqipëria synon të arrijë një raport të zotërimit të llogarisë prej popullsisë në moshë madhore në nivelin 70% deri në vitin 2022.

1. Përmirësime ligjore dhe të kuadrit rregullator:

a) aprovimi i projektligjit “Mbi shërbimet e pagesave”, i cili transpozon direktivën e ndryshuar evropiane 2015/2366 deri në fund të vitit 2019;

b) hartimi i një akti ligjor që do të transpozojë direktivën e Bashkimit Evropian “Mbi llogarinë e pagesave”, brenda vitit 2021;

2. Përmirësime infrastrukturore dhe teknologjike, të tilla si:

a) mundësia e zbatimit të një platforme kombëtare të procesimit të kartave (SWITCH)/*instant payment* pagesave në kohë reale;

b) zbatimi i skemës së debitimit direkt ndërbankar;

c) vendosja e një sistemi për shlyerjen e pagesave në euro për pagesat kombëtare;

d) operacionalizimi i kategorisë së “ Pjesëmarrësve jo të drejtpërdrejtë” në sistemin AECH.

2. Aktivitetet e planifikuara

a) Aktivitetet e planifikuara më 2020-ën:

- hyrja në fuqi e ligjit “Mbi shërbimet e pagesave”, i cili transpozon direktivën e ndryshuar evropiane 2015/2366 dhe hartimi e aprovimi/miratimi i akteve nënligjore për këtë ligj;

- hartimi i aktit ligjor që do të transpozojë direktivën e Bashkimit Evropian “Mbi llogarinë e pagesës”;

- aprovimi i ndryshimeve rregullative dhe në infrastrukturë për skemën e debitimit direkt ndërbankar;

- zbatimi i sistemit për shlyerjen e transfertave në euro për pagesat kombëtare.

- aprovimi i ndryshimeve rregullative dhe në infrastrukturë për “pjesëmarrjen e jo të drejtpërdrejtë” në sistemin AECH;

- studimi i fizibilitetit për zbatimin e platformës kombëtare për procesimin e kartave (SWITCH) /*instant payment*/pagesave në kohë reale.

b) Aktivitetet e planifikuara më 2021-shin:

- hyrja në fuqi e akteve ligjore që transpozojnë direktivën e Bashkimit Evropian “Mbi llogarinë e pagesës”;

- termat e referencës (TORs) dhe projekti për zbatimin e platformës kombëtare për procesimin e kartave (SWITCH) /*instant payment*/pagesave në kohë reale.

b) Aktivitetet e planifikuara më 2022-shin:

- implementimi/zbatimi i një platforme kombëtare të procesimit të kartave (SWITCH)/*instant payment*/ pagesave në kohë reale.

3. Indikatorët e rezultateve

Indikator	Bazë (viti)	Objektivi i ndërmjetëm (viti)	Objektivi (viti)
Hyrja në fuqi e ligjit “Mbi shërbimet e pagesave”	Aprovimi i ligjit (tremujori i 2020)	Krijimi i akteve nënligjore në zbatim të ligjit	Zbatimi final i ligjit
Hartimi i një akti ligjor që do të transpozojë direktivën e Bashkimit Evropian “Për llogarinë e	Hartimi i aktit ligjor (2020)	Aprovimi i aktit ligjor (2021)	Zbatimi i aktit ligjor 2021–2022

pagesës”, brenda vitit 2021			
Miratimi i ndryshimeve rregullative dhe në infrastrukturë për skemën e debitit direkt ndërbankar			2020
Miratimi i ndryshimeve rregullative dhe në infrastrukturë për “pjesëmarrjen jo të drejtpërdrejtë” në sistemin AECH ndërbankar			2020
Studimi i fizibilitetit për zbatimin e platformës kombëtare të procesimit të kartave (SWITCH)/ <i>instant payment</i> / pagesave në kohë reale	Studimi i realizueshmërisë (2020)	Termat e referencës ToR (2021)	Zbatimi 2022

4. Ndikimi i pritshëm në konkurrueshmëri

1. Projektligji “Mbi shërbimet e pagesave” pritet të rrisë konkurrencën në tregun e shërbimit të pagesave nëpërmjet krijimit të një fushë të përshtatshme për institucionet financiare jobanka për të ofruar shërbime inovative të pagesave elektronike përmes:

a) duke i lejuar ato të hapin llogari pagesash dhe të ofrojnë pagesa elektronike (gjë e cila nuk lejohet me legjislacionin aktual);

b) krijimin e licencimit dhe të mbikëqyrjes së institucioneve që ofrojnë shërbime pagese në përpjesëtim me rrezikun që këto institucione mbartin;

c) garantimin e aksesit të tyre në sisteme pagesash;

d) garantimin e aksesit të palët e treta (TPP - ofruesit e shërbimit të informacionit mbi llogarinë dhe ofruesit e shërbimit të pagesës të informacionit mbi llogarinë) të informacionit mbi llogarinë e klientit pas pëlqimit të qartë të këtij të fundit përmes krijimit të infrastrukturës së Bankës së Hapur (*Open Banking*); si dhe

e) krijimin e një kornize prudenciale për mbrojtjen e konsumatorit.

2. Hartimi i aktit ligjor që do të transpozojë direktivën e Bashkimit Evropian “Mbi llogarinë e pagesës”:

Vlerësohet/pritet që të rrisë konkurrencën nëpërmjet përmirësimit të mëtejshëm të transparencës së shërbimeve të ofruara në treg, si dhe të rritjes së lëvizshmërisë së klientëve përmes vendosjes së procedurave të ndërrimit/ndryshimit me kosto më efektive ndërmjet ofruesve të ndryshëm të shërbimeve të pagesave.

3. Miratimi i ndryshimeve rregullative dhe në infrastrukturë për “pjesëmarrje jo të drejtpërdrejtë” në AECH - përmirësimin e kushteve të tregut ndërmjet bankave dhe institucioneve financiare jobanka, të cilat ofrojnë shërbime pagese.

4. Mundësia e zbatimit të një platforme kombëtare të procesimit të kartave (SWITCH)/ *instant payment*/ pagesat në kohë reale.

Rritja e konkurrencës për procesimin e kostove të pagesave të kartave dhe, gjithashtu, rritja e konkurrencës ndërmjet pagesave me karta dhe transfertave të kreditit në formë joletër.

5. Kostoja e parashikuar e aktiviteteve dhe burimi i financimit

Procesi i hartimit të ligjit “Mbi shërbimet e pagesave”, si dhe i akteve nënligjore të tij, si dhe projektligji që do të transpozojë direktivën e Bashkimit Evropian “Mbi llogarinë e pagesës” është financuar nga SECO.

Zhvillimet infrastrukturore do të mbulohen nga Banka e Shqipërisë (me përjashtim të SWITCH-it kombëtar i cili do të jetë një konsortium ndërbankar).

6. Ndikimi i pritshëm në rezultatet sociale, si: punësimi, ulja e varfërisë, barazia dhe gjinia

Duke marrë parasysh që projektligji “Mbi shërbimet e pagesave” nxit përfshirjen e kompanive *Fintech* në sferën financiare, vlerësohet se hyrja e ofruesve të rinj të shërbimeve të pagesave do të përmirësojë/do të nxisë, gjithashtu, edhe punësimin.

Nga ana tjetër është pranuar gjerësisht se përfshirja financiare është një komponent i rëndësishëm në uljen e varfërisë. Në këtë drejtim, duke marrë parasysh që strategjia ka si synim gjithëpërfshirës/themelor rritjen e përqindjes së popullsisë që ka akses në shërbimet financiare nga 40% në 70%, vlerësohet se strategjia ka një ndikim të drejtpërdrejtë në uljen e varfërisë.

7. Ndikimi i pritshëm në mjedis

Strategjia pritet të promovojë pagesa elektronike kundrejt pagesave në formë letër. Në këtë drejtim pritet që shërbimet e reja të pagesave do të promovojnë politika më miqësore ndaj mjedisit.

8. Rreziqet e mundshme

Rreziku	Probabiliteti (i ulët, i lartë)	Veprimi i planifikuar për uljen e rrezikut
Mosmiratimi i ligjeve dhe i rregulloreve në nivelin e duhur, në kohën e planifikuar për miratim të ligjeve të tjera të lidhura indirekt që pengojnë ose kanibalizojnë objektivat e synuar të ligjit/të ndryshimeve rregullative të planifikuara	I ulët	Koordinimi ndërmjet institucioneve të ndryshme nëpërmjet Komitetit Kombëtar të Sistemit të Pagesave
Mungesa e përfshirjes së të gjitha palëve të interesit që kontribuojnë në hartimin, zbatimin dhe ekzekutimin e ndryshimeve në ligje /rregullore dhe në infrastrukturën që planifikohen të zbatohen	I ulët	Koordinimi ndërmjet institucioneve të ndryshme nëpërmjet Komitetit Kombëtar të Sistemit të Pagesave
Mungesë ekspertize dhe/ose ekspertizë e kufizuar për të aplikuar ndryshime në ligj/rregullore dhe/ose zbatime teknike të parashikuara të përmirësimit të infrastrukturës	I ulët	Banka e Shqipërisë po punon intensivisht për të pasur ekspertizën e duhur nga Banka Botërore dhe Bankat Qendrore të vendeve të Bashkimit Evropian

5.3.4 Kërkim, zhvillim dhe inovacion, dhe ekonomia digjitale

a) Analiza e pengesave kryesore

Sektori TIK dhe telekomunikacionet përbëjnë një nga sektorët e rëndësishëm ekonomikë në vend. Infrastruktura digjitale dhe *broadband* janë thelbësore për të gjitha zhvillimet e tjera në integrimin digjital dhe ndikon në të gjithë sektorët e ekonomisë. Infrastruktura digjitale është një parakusht për zhvillimet e ekonomisë digjitale në industrinë inovative, e-qeverisjen, e-shëndetësinë, ofrimin e shërbimeve të ndërveprueshme, ofrimin e shërbimeve ndërkufitare etj. Zhvillimi i rrjeteve *broadband* kërkon investime të mëdha dhe në këtë aspekt, sektori privat është kontribuesi kryesor. Në Shqipëri, tregu i telekomunikacionit është i hapur plotësisht për konkurrencën që nga viti 2008. *Broadband* nga rrjetet e lëvizshme ofrohet gjerësisht bazuar në teknologjinë LTE. Ndërkohë, në treg ka një numër të konsiderueshëm të ISP-ve që ofrojnë lidhje *broadband*, bazuar në rrjetin fiks. Prej vitesh në treg ofrohen shërbime të kombinuara trefishe/katërfishe: telefoni, internet dhe TV. Përdoruesit e internetit dhe abonimet në *broadband* fiks në Shqipëri janë rritur çdo vit me 10–15%. Në fund të vitit 2018, numri i abonimeve *broadband* fiks ishte 361.000. Megjithatë, penetrimi i *broadband*-it fiks mbetet në nivele shumë të ulëta krahasuar me vendet e tjera të rajonit dhe me vendet e BE-së.

Situata e *broadband* në Shqipëri është si më poshtë:

- ekziston një boshllëk i madh për sa i përket depërtimit të *broadband*-it fiks midis zonave urbane dhe atyre rurale;
- penetrimi i *broadband*-it fiks është i ulët, përafërsisht 40% e familjeve;
- penetrimi i *broadband*-it të telefonisë celulare është më i lartë se ai fiks, mbulimi i popullsisë me LTE është mbi 85%;

- përdoruesit e *broadband*-it të telefonisë celulare arritën në mbi 1.8 milionë deri në fund të vitit 2018.

Situata aktuale e lidhjes *broadband* në arsimin publik është larg nga ajo e ofrimit të këtij shërbimi me shpejtësi mbi 30 Mbps. *Bandwidth* maksimal i ofruar është deri në 8–10 Mbps dhe gjysma e shkollave janë pa ose me lidhje internet shumë të kufizuara. E njëjta situatë ekziston edhe për institucionet e shëndetit publik, gjë që e bën të vështirë zbatimin e shërbimeve të e-shëndetësisë, veçanërisht në zonat e largëta të vendit.

Qeveria e Shqipërisë ka identifikuar zhvillimin e infrastrukturës digjitale dhe *broadband* si prioritet kyç në dokumentet strategjike, si: Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim (SKZHI), Strategjia e Agjendës Digjitale, Programi i Reformave Ekonomike (ERP) 2019–2021, Plani Kombëtar i *Broadband*-it. Prioriteti i dytë strategjik i Agjendës Digjitale 2020: “Politika për zhvillimin e komunikimeve elektronike në të gjithë sektorët (shëndetësi, arsim, mjedis, bujqësi, turizëm, kulturë, energji, transport etj.)” thekson se një nga drejtimet kryesore është zhvillimi i infrastrukturës së komunikimeve elektronike, së bashku me *broadband*-in e shpejtë dhe shumë të shpejtë.

Kuadri ligjor kryesor për telekomunikacionin dhe *broadband*-in është ligji nr. 9918, datë 19.5.2008, “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i amenduar. Ky ligj është bazuar në paketën e BE-së për komunikimet elektronike 2002, amenduar nga direktiva 2009. Shqipëria ka miratuar, gjithashtu, ligjin nr. 120, datë 24.11.2016, për zhvillimin e *broadband*-it¹⁹. Ky ligj synon të rrisë investimet, të përmirësojë depërtimin e *broadband*-it, të rrisë efikasitetin e infrastrukturës ekzistuese përmes ndarjes së infrastrukturës, si dhe do të rrisë konkurrencën. Përveç kësaj, ky ligj ka edhe disa përfitime sociale dhe mjedisore. Zbatimi i ligjit nr. 120/2016 është ende në fazat e hershme. Puna për të ndarë infrastrukturën, midis sektorit energjetik dhe sektorit telekom, është në proces.

Në dhjetor 2018, Bashkimi Evropian ka aprovuar kodin e ri të komunikimeve elektronike nga direktiva 2018/1972/EU. Kodi i ri i komunikimeve elektronike zëvendëson paketën rregullatore të BE-së për komunikimet elektronike 2002/19/EC, 2002/20/EC, 2002/22/EC, 2002/21/EC të amenduar. Dispozitat e kodit përfshijnë masa për të stimuluar investimet dhe marrjen e rrjeteve me kapacitet shumë të lartë në Bashkimin Evropian, rregulla të reja të spektrit për lidhjen mobile dhe 5G, si dhe ndryshimet në qeverisje, regjimin e shërbimit universal, rregullat e mbrojtjes së përdoruesit fundorë dhe rregullat e numërimit dhe të komunikimit urgjent.

Raporti i Komisionit Evropian 2019, rekomandon, gjithashtu, që Shqipëria duhet të adaptojë amendamentet e nevojshme të ligjit të komunikimeve elektronike, në përafrim me Kodin e Ri të Komunikimeve Elektronike dhe të përgatitë një plan veprimi për agjendën digjitale. Rishikimi i kuadrit ligjor ekzistues duhet të marrë në konsideratë rregullimin më të mirë të ofrimit të shërbimit universal për komunikimet elektronike, përfshirë mbulimin *broadband*, bazuar në rregullat e BE-së për ndihmën shtetërore në *broadband*.

Bazuar në urdhrin e Kryeministrit nr. 157, datë 22.10.2018, “Mbi masat për zbatimin e një qasjeje të gjerë sektoriale/ndërsektoriale, si dhe krijimin dhe funksionimin e mekanizmit të integruar sektorial/ndërsektorial, u krijuan komitetet GMIP (Grupet e Menaxhimit të Integruar të Programit) dhe Komitetet Sektoriale Drejtuese. Komiteti Drejtues Sektorial i “*Connectivity*” drejtohet nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë. Telekomunikacioni dhe *Broadband*-i është një grup specifik tematik pjesë e Komitetit të Lidhjes.

Grupi tematik i Telekomunikacionit dhe *Broadband*-it u krijua në shkurt 2019, nga një urdhër specifik i ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë. Grupi tematik i telekomunikacionit dhe i *broadband*-it, si pjesë e Komitetit Sektorial Drejtues të “*Connectivity*”, synon të sigurojë bashkëpunim dhe vendimmarrje të përbashkët në nivelin më të lartë politik dhe menaxherial për planifikimin, koordinimin dhe monitorimin e programeve ndërsektoriale dhe kombëtare në

¹⁹ Ligji “Për zhvillimin e rrjeteve të komunikimeve elektronike të shpejtësisë së lartë dhe sigurimin e së drejtës së kalimit” ka përafruar plotësisht direktivën 2014/61/BE.

fushat me përparësi, duke siguruar udhëzime për vijimin e zbatimit të koordinuar të politikave dhe reformave prioritare përmes raportimit dhe monitorimit të masave që lidhen me qëllimet dhe objektivat prioritarë në fushat prioritare, reformat dhe sektorët me rëndësi të veçantë etj.

Një studim i plotë i fizibilitetit për zhvillimin e *broadband*-it është duke u përgatitur me mbështetjen e WBIF-së. Ky studim do të mbështesë përgatitjen e një Programi Kombëtar për Zhvillimin e Infrastrukturës *Broadband* në zona ku mungon interesi i mjaftueshëm tregtar për investime, si dhe për të arritur objektivat për lidhjen *broadband*, me të paktën 30 Mbit/s dhe më shumë drejt *gigabit society*, bazuar në strategjinë “*Gigabit Society*” të BE-së. Për më tepër, është hartuar një udhërrëfyes 5G për Shqipërinë. Puna për të rishikuar Planin Kombëtar të *Broadband*-it filloi gjatë korrikut 2019. Zhvillimi i *broadband*-it është në përputhje me Agjendën Digjitale të BE-së, dhe një nga përparësitë e WB6 të Planit Shumëvjeçar të Veprimit për Zonën Ekonomike Rajonale (MAP-REA) të miratuar gjatë Samitit të Triestes, të mbajtur më 12 korrik 2017.

Mjedisi i kërkimit dhe inovacionit në Shqipëri është ende përballë sfidave që ngadalësojnë transformimin e tij në një shtyllë të qëndrueshme për zhvillimin ekonomik. Ndërkohë, korniza strategjike dhe ligjore vazhdojnë të përmirësohen për të lehtësuar një transformim të tillë në vitet e ardhshme. Një nga hapat më të rëndësishëm të ndërmarrë në vitin 2017 ishte miratimi i Strategjisë Kombëtare për Shkencë, Teknologji dhe Inovacion (SKSHTI), 2017–2022.

Shqipëria është në proces të miratimit të një Strategjie të Specializimit të zgjuar (S3). Në prill 2018 u krijua një grup pune nga ministri i Arsimit, Sportit dhe Rinisë. GG ka hartuar një hartë rrugore të aktiviteteve që do të ndërmerren deri në miratimin e saj përfundimtar. Tregu i vetëm digjital shqiptar paraqet një qasje të re për të nxitur rritjen dhe masat për të arritur atë janë pjesë e Agjendës Digjitale të Shqipërisë, 2015–2020. Një projektligj i ri “për kërkimin” është përfunduar dhe është planifikuar të paraqitet në parlament.

b) Masat e reformave

Reforma 11: Përmirësimi i kapaciteteve institucionale të sistemit të kërkimit dhe inovacionit

1. Përshkrimi

Masa përputhet me “Strategjinë për shkencë, teknologji dhe inovacion”, 2017–2022; Programin qeveritar 2017–2020; Planin Kombëtar për Integrimin Evropian, 2017–2021, kapitulli 25, “Shkenca dhe kërkimi shkencor”; SEE 2020. Qëllimi i tij është të zhvillojë infrastrukturën e kërkimit dhe inovacionit, të aktivizojë burimet financiare publike dhe private që mbështesin kërkimin shkencor dhe promovojnë studiuesit shkencorë. Për më tepër, ai synon të rrisë bashkëpunimin midis studiuesve dhe komunitetit të biznesit që mbështesin krijimin e vendeve të punës dhe zhvillimin ekonomik të vendit.

Masa përfshin nisma ligjore që do të zhvillohen gjatë viteve 2020–2022; aktivitete në lidhje me përmirësimin e infrastrukturës kërkimore; aktivitete promovuese të programeve shkencore evropiane; investime për të mbështetur kërkimin shkencor të lidhur ngushtë me zhvillimin ekonomik të vendit; aktivitete të promovimit të kapitalit njerëzor etj.

2. Aktivitetet e planifikuara

a) Aktivitetet e planifikuara më 2020-ën:

- rritja e kapaciteteve të Agjencisë Kombëtare të Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit përmes vendosjes së marrëveshjeve/projekteve dypalëshe dhe shumëpalëshe;
- krijimi i strukturave të koordinimit kombëtar për kërkimin shkencor (një strukturë ndërinstitucionale);
- AKSHI, në bashkëpunim me INSTAT-in dhe me MFE-në do të mbledhë dhe do të përpunojë të dhëna për matjen e treguesit GERD;
- infrastruktura kërkimore do të vazhdojë të mbështetet pas monitorimit të performancës së tyre;
- vazhdimi i hartimit të S3.

b) Aktivitetet e planifikuara më 2021-shin:

- finalizimi i S3 dhe sigurimi për fillimin e zbatimit;

- identifikimi i partnerëve për inovacion; eksplorimi i shanseve të reja brenda bashkëpunimit ndërmjet universiteteve dhe bizneseve;
- infrastruktura kërkimore do të vazhdojë të mbështetet pas monitorimit të performancës së tyre.

c) Aktivitetet e planifikuara më 2022-shin:

- përpos projekteve hulumtuese, projektet e inovacionit do të mbështeten dhe financohen, pasi ato kanë në thelb bashkëpunimin midis shkencës (universiteteve) dhe biznesit, duke promovuar modele të reja, si *hackathons* dhe *triple-helix* (BE për inovacion);
- përgatitja e udhëzimeve dhe e modeleve të nevojshme për financimin e projekteve të inovacionit. Siguroni miratimin e tyre nga bordi i administrimit.

3. Indikatorët e rezultateve

Indikatori	Bazë (2019)	Objektivi i ndërmjetëm (2020)	Objektivi (2022)
Numri i projekteve të kërkimit dhe inovacionit të themeluar	15 NPSR 12 infrastrukturë	20/20	25/25
% e fondit të kërkimit dhe inovacionit kundrejt PBB-së (GERD)	0.04 ²⁰	0.1	0.1
Numri i marrëveshjeve/projekteve bilaterale dhe multilaterale të krijuara	x	4+	5+

4. Ndikimi i pritshëm në konkurrueshmëri

Forcimi i kapaciteteve kërkimore institucionale do të kontribuojë në përmirësimin e pjesëmarrjes në programet “Horizont 2020” dhe do të forcojë lidhjet midis akademisë, biznesit dhe qeverisë në planin afatmesëm dhe afatgjatë. Ushqyerja e biznesit me kërkime dhe inovacion do të çojë në prodhimin e produkteve inovative në këto infrastrukturë dhe krijimin e vlerës së shtuar përmes komercializimit të këtyre produkteve.

5. Kostoja e parashikuar e aktiviteteve dhe burimi i financimit

Buxheti total i programit të kërkimit në Programin Buxhetor Afatmesëm.

6. Ndikimi i pritshëm në rezultatet sociale, si punësimi, ulja e varfërisë, barazia dhe gjinia

Synon të përmirësojë kapacitetet financiare dhe menaxheriale të infrastrukturave kërkimore në universitete, ku studiuesit e kualifikuar do të bashkëpunojnë me komunitetin e biznesit për biznes të ri inovativ që promovojnë krijimin e vendeve të punës.

7. Ndikimi i pritshëm në mjedis

Masa nuk pritët të ketë ndikim në mjedis.

8. Rreziqet e mundshme

Sfidat për zbatimin e masave të lartpërmendura në fushën e kërkimit dhe inovacionit përfshijnë vështirësi në koordinimin ndër-institucional, si dhe kufizimet e buxhetit.

Rreziku	Probabiliteti (i ulët, i lartë)	Veprimi i planifikuar për uljen e rrezikut
Kufizime buxhetore	I ulët	Sipas kornizës së buxhetit afatmesëm, fondet e planifikuara për infrastrukturën kërkimore shkencore janë rritur për tre vjetet e ardhshëm

Reforma 12: Zhvillimi i infrastrukturës të brezit të gjerë për ekonominë digjitale

1. Përshkrimi

Zhvillimi i infrastrukturës *broadband* është një nga çështjet më të rëndësishme të strategjisë rajonale. Zhvillimi *broadband* është në përputhje me Agjendën Digjitale të BE-së, pjesë e përparësive të strategjisë SEE-2020, nën shtyllën e rritjes inteligjente dhe, gjithashtu, pjesë e MAP-REA e WB6, të miratuar në Samitin e Triestes, më 12 korrik 2017, nën shtyllën e integritit digjital. Në përputhje me objektivat e SEE 2020, procesin e integritit në BE dhe programin kombëtar parashikohen një numër masash. Masat e reformave të propozuara do të rrisin

²⁰ It is supposed that the GERD indicator is calculated properly.

investimet, do të përmirësojnë depërtimin *broadband*, do të rrisin efikasitetin e infrastrukturës ekzistuese përmes ndarjes së infrastrukturës, si dhe do të rrisin konkurrencën. Për më tepër, ekzistojnë disa përfitime sociale dhe mjedisore përmes:

- mbulim më i mirë *broadband*, që do të thotë kohezion social dhe territorial;
- rrit sinergjitë nëpër sektorë, p.sh., rrjete inteligjente dhe sisteme inteligjente transporti;
- më pak dyfishime të punimeve civile, më pak gjurmime;
- përmirësim i mjedisit të biznesit përmes transparencës dhe procedurave të thjeshta për lejet e ndërtimit etj.

Zhvillimi i infrastrukturës *broadband* është duke ecur paralel me zhvillimin e rëndësishëm në e-qeverisje, e-shërbime, digjitalizim i sistemit TIK në administratën publike, që është një element i rëndësishëm për ekosistemin TIK dhe ekonominë digjitale. Kjo pjesë e investimeve është e lidhur me anën e kërkesës së *broadband*-it.

Pjesë e planit për të zbatuar këtë reformë gjatë vjetëve të ardhshëm, do të jenë:

- rishikimi i planit të veprimit të Planit Kombëtar të *Broadband*-it;
- kryerja e “Studimit të fizibilitetit dhe analizës kosto-përfitim për zhvillimin e infrastrukturës rajonale *broadband*”;
- ngritja e zyrave rajonale/kombëtare kompetente për *broadband*-in;
- fillimi i projekteve pilot për zhvillimin e infrastrukturës *broadband* në zonat rurale dhe të largëta;
- krijimi i sinergjive me projekte shërbimesh: ndjekja e rekomandimeve të studimit *Balkan Digital Highway*.

2. Aktivitetet e planifikuara

a) Aktivitetet e planifikuara më 2020-ën:

- miratimi i Planit të ri Kombëtar të *Broadband*-it;
- kryerja e “Studimit të fizibilitetit dhe analizës kosto-përfitim për zhvillimin e infrastrukturës rajonale *broadband*”;
- miratimi i udhërrëfyesit 5G për Shqipërinë.

b) Aktivitetet e planifikuara më 2021-shin:

- ngritja e zyrave rajonale/kombëtare kompetente për *broadband*;
- fillimi i projekteve pilot për zhvillimin e infrastrukturës *broadband* në zonën 1 (zona rurale dhe të largëta/turistike në veri të Shqipërisë (Shkodër, Kukës, Tropojë, Dibër);
- miratim i ligjit të ri për komunikimet elektronike, në përputhje me Kodin e Ri Evropian për Komunikimet Elektronike, miratuar nga BE-ja më 2018.

c) Aktivitetet e planifikuara më 2022-shin:

- Fillimi i projekteve pilot për zhvillimin e infrastrukturës *broadband* në zonën 2 (zona rurale dhe të largëta/turistike. Për t'u vendosur bazuar në rezultatet e studimit të fizibilitetit).

3. Indikatorët e rezultateve

Indikatori	Bazë (viti)	Objektivi i ndërmjetëm (viti)	Objektivi (viti)
Rritje e penetrimit të <i>broadband</i> -it fiks, duke përfshirë zonat rurale – penetrimi i <i>broadband</i> -it në shtëpi	38%		45%
Rritje e numrit të shkollave publike dhe e strukturave shëndetësore me lidhje <i>broadband</i> -in – shpejtësia mesatare e internetit	8 Mbps		20 Mbps
Rritje e lidhjes <i>broadband</i> për NVM			≥30 Mbps
Rritje e përqindjes së mbulimit me <i>broadband</i> me shpejtësi >30 Mbps			

4. Ndikimi i pritshëm në konkurrueshmëri

Reforma e propozuar parashikon rritjen e investimeve në vend, përmirësimin e penetrimit *broadband*, rritjen e eficiencës së infrastrukturës ekzistuese nëpërmjet ndarjes së infrastrukturës, si

dhe të rritjen e konkurrueshmërisë. Zhvillimi i zonave të largëta dhe rurale nëpërmjet përdorimit të TIK-ut për bizneset dhe fermerët, si dhe aksesit që vjen si rezultat i njohurive të metodave teknologjike, si pjesë e kësaj reforme, pritet të përmirësojë konkurrueshmërinë në këto fusha.

Disa nga përfitimet sociale të reformës janë: mbulim më i mirë me internet që përkthehet në kohezion social dhe territorial; rritje e sinergjisë midis sektorëve, p.sh., *smart grids* dhe sistemet inteligjente të transportit; më pak dyfishim të punëve civile që do të thotë më pak gjurmime dhe/ose më pak ndotje akustike; përmirësim i klimës së biznesit nëpërmjet procedurave transparente dhe më të thjeshta për pajisjen me leje ndërtimi etj.

5. Kostoja e parashikuar e aktiviteteve dhe burimi i financimit

1. Miratimi i Planit të ri Kombëtar të *Broadband*-it:

- 5.500 euro nga buxheti i shtetit për rishikimin e planit të veprimit të Planit Kombëtar të *Broadband*-it;

- mbështetje nga ITU-ja me një ekspert për hartimin e Planit Kombëtar të *Broadband*-it;

2. Studimi i fizibilitetit dhe analiza kosto-përfitim për zhvillimin e infrastrukturës rajonale të *broadband*-it:

- 520.000 euro nga granti i WBIF-së;

- 25.000 euro nga Buxheti i MIE-s.

3. Buxheti për aktivitetet nën planin e ri të veprimit të agjendës digjitale (digjitalizimi i shërbimeve/i sektorit TIK – ana e kërkesës e ekosistemit *Broadband*), për 2019–2020, **është afërsisht 26 mln euro si buxhet shteti dhe 12.5 mln euro donatorë/IPA/fonde të tjera (pritet të miratohet së shpejti me VKM).**

Ndikimi në buxhet për rishikimin e Planit Kombëtar të *Broadband*-it vjen si rezultat i kostove administrative të stafit. Kostoja e studimit të fizibilitetit do të mbulohet nga WBIF-ja.

Në total projekti për zhvillimin e *broadband*-it vlerësohet të jetë 48 milionë euro me kontribute të ndryshme.

Investimet për zhvillimin e infrastrukturës *broadband* në zonën 1 (zona të bardha) dhe në zonën 2 (zona gri) etj., do të jenë pjesë e këtij projekti.

Në kuptimin e rrjetit *broadband*, BE-ja propozoi klasifikimin e zonave sipas statusit të saj ekzistues ose të ardhshëm të infrastrukturës së rrjetit NGN, duke përcaktuar kështu situatën e tregut, si për rrjetet bazë dhe për rrjetet *broadband* NGN:

- zonë e bardhë nëse rrjeti *broadband* NGN aktualisht nuk është i pranishëm ose nuk është planifikuar të jetë funksional brenda tre vjetëve të ardhshëm; në këtë rast mund të lejohet ndihma shtetërore;

- zonë gri nëse ka vetëm një rrjet *broadband* NGN, që është në funksion (ose është planifikuar të jetë kështu brenda tre vjetëve të ardhshëm); në këtë rast, zona mund të jetë e pranueshme për ndihmën shtetërore, por do të jetë e nevojshme një analizë më e hollësishme.

6. Ndikimi i pritshëm në rezultatet sociale, si: punësimi, ulja e varfërisë, barazia dhe gjinia

Zhvillimi i *broadband*-it pritet të rrisë numrin e të punësuarve dhe, gjithashtu, të krijojë më shumë mundësi punësimi *online* për femrat. Referuar studimit “*Impakti i transformimit digjital në Ballkanin Perëndimor – Trajtimi i sfidave drejt stabilitetit politik dhe prosperitetit ekonomik*”²¹, investimet në rrjetin *broadband* mund të japin kontribut në dinamikën e krijimit të vendeve të reja të punës në ekonominë e Ballkanit Perëndimor. Sipas studimit, investimet në infrastrukturën *broadband* me një vlerë prej 100 milionë eurosh mund të krijojnë 3,000 deri në 10,000 vende të reja pune. Si rezultat i produktivitetit më të ulët të punës (nevojitet më shumë punë për njësi të prodhuar), mundësia e krijimit të vendeve të reja të punës, prej investimeve në rrjetin *broadband* është më e lartë në Shqipëri; afërsisht 10,000 vende të reja pune.

Sipas studimit, nxitja e kërkesës nëpërmjet investimeve prej 100 milionë eurosh në rrjetin *broadband*, do të rezultonte në një vlerë të shtuar bruto shtesë, deri në 0.9% në rastin e Shqipërisë. Përveç kësaj, investimet në rrjetin *broadband* do të përmirësojnë prodhimin në përgjithësi, pasi

²¹ <https://wb6digital.files.wordpress.com/2018/01/wb6-study.pdf>

efektet relative mbi vlerën e shtuar bruto tejkalojnë efektet në punësim. Duke shtuar përfitimet ekonomike dhe vendet e reja të punës, investimet në rrjetin *broadband* jo vetëm japin përfitime ekonomike, por, gjithashtu, promovojnë stabilitet politik, si dhe cilësi më të lartë të shërbimeve publike. Reforma krijon mundësinë e adresimit të çështjeve gjinore në TIK, nëpërmjet rritjes së mundësive të femrave si punonjëse *online* nga shtëpia në zonat e largëta dhe rurale.

7. Ndikimi i pritshëm në mjedis

Reforma nuk pritet të ketë ndikim në mjedis.

8. Rreziqet e mundshme

Rreziku	Probabiliteti (i ulët, i lartë)	Veprimi i planifikuar për uljen e rrezikut
Infrastruktura digjitale dhe infrastrukturat e tjera, të tilla si projektet e transportit dhe energjisë kanë nevojë të koordinohen në mënyrë që të përfitohet nga sinergia dhe investimet e përbashkëta	15%	Monitorim, raportim dhe bashkëpunim i ngushtë i vazhdueshëm midis grupeve të interesit
Mungesa e bashkëpunimit midis aktorëve të ndryshëm të përfshirë në këtë proces është një nga vështirësitë e identifikuara në këtë sektor	15%	Monitorim, raportim dhe bashkëpunim i ngushtë i vazhdueshëm midis grupeve të interesit

5.3.5 Reformat e tregtisë

a) Analiza e pengesave kryesore

Regjimi tregtar shqiptar nuk ka pësuar ndonjë ndryshim thelbësor dhe ka ruajtur nivelin e tij të përgjithshëm të hapjes gjatë vitit të kaluar. Hapja e tregtisë për vitin 2018, si një aksion për PBB-në, arriti në 56%, ndërsa koeficienti i mbulimit të eksporteve/importeve tregoi një rritje të lehtë nga 43.6% për 2017 në 48.4% për 2018. Shkëmbimi tregtar shqiptar tregoi një përmirësim gjatë vitit 2018 me një rritje të eksportet me (13.7%) dhe një rritje të vogël të importeve me (2.4%).

Partnerët kryesorë të BE-së për eksporte gjatë vitit 2018 ishin Italia dhe Spanja dhe për importet ishin Italia dhe Greqia. Gjatë vitit 2018 eksportet në Itali dhe Spanjë ishin 10.2% dhe 62.9%, respektivisht i eksportit të përgjithshëm në BE; ndërsa importet nga Italia dhe Greqia ishin përkatësisht 43.7% dhe 13% e totalit të importeve nga BE. Eksportet për në Itali në vitin 2018, krahasuar me një vit më parë, u rritën me 2.1% dhe importet u ulën me 2.2%; ndërsa eksportet në Spanjë në 2018, krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2017, u rritën me 61.3% dhe importet nga Greqia u rritën me 4.5%.

Për më tepër, për integrim më të mirë dhe më të madh në tregjet rajonale, me synimin për të rritur pjesën e eksportit në rajon, për të adresuar më mirë pengesat në tregtinë dhe diversifikimin e eksporteve, do të prezantohet një qasje gjithëpërfshirëse në zbatimin e njëkohësisht të masave kombëtare dhe rajonale në fusha e lehtësimit të tregtisë. Për këtë arsye, në përputhje me rekomandimet e treguesit të tregtisë së OECD-së për konkurrencën 2018 dhe “Strategjinë e zhvillimit të biznesit dhe investimeve”, 2014–2020, është iniciuar një strategji e vetme dhe një plan veprimi për të përmirësuar performancën tregtare të vendit. Është ngritur një grup pune brenda Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, për të analizuar dhe identifikuar sektorët dhe produktet specifike që kanë potencial për t’u eksportuar. Ky dokument do të shërbejë si bazë për prezantimin e masave të reja për vitet e ardhshme. Bazuar në analizën dhe inputet në bashkëpunim me sektorin e biznesit, një seri rekomandimesh dhe plani i veprimit do të përgatiten dhe do t’u shpërndahen palëve të interesuara për zbatim.

Shqipëria mbetet shumë e përkushtuar për forcimin e kapaciteteve të Komitetit Kombëtar të Lehtësimit të Tregtisë. Për këtë qëllim, janë krijuar dy grupe pune *ad hoc* që përqendrohen në zvogëlimin dhe/ose eliminimin e tarifave dhe pagesave për importe dhe eksporte aty ku është e nevojshme dhe njohja e përbashkët e dokumenteve dhe certifikatave fitosanitare në mënyrë

bilaterale me palët CEFTA. Forcimi i kapacitetit administrativ dhe stafit të kualifikuar për tregti mbetet një sfidë.

Masat që janë futur në ERP, 2019–2021, të cilat janë në përputhje me MAP REA dhe synojnë uljen e kostove dhe kohën e procedurave të tregtisë ndërkufitare, do të vazhdojnë të zbatohen. Për më tepër, për të zbatuar angazhimet që rrjedhin nga protokoli shtesë 5, në nivelin rajonal, përparësia më e lartë do t'i jepet përgatitjeve të sigurimit të zbatimit të njohjes së ndërsjellë të dokumenteve kufitare dhe operatorit të autorizuar ekonomik.

a) Masat e reformave

Reforma 13: Lehtësimi i lëvizjes ndërkufitare të mallrave

1. Përshkrimi

Megjithëse Shqipëria renditet e 25-ta në aspektin tregtar përmes kufijve në raportin e *Doing Business 2020*, ajo nuk performon mirë në treguesit e tjerë të konkurrencës në raportet e infrastrukturës së tregtisë dhe transportit. Shqipëria renditet në vendin e 81-të në Indeksin Global të Konkurrencës 2019 nga 141 ekonomi, duke fituar 65.8 pikë nga 100 nën shtyllën e hapjes së tregtisë dhe 35.5 nga 100 nën shtyllën e infrastrukturës së transportit.

Koordinimi dhe veprimet kolektive janë të domosdoshme për të zvogëluar kostot e transaksioneve tregtare përgjatë korridoreve rajonale të tregtisë. Heqja e kufizimeve në korridoret e tregtisë mund të lejojë formimin e zinxhirëve të vlerës globale dhe të promovojë specializim më të mirë të industrive në vend. Lehtësimi i tregtisë dhe transportit janë elementet kryesore për thellimin e integritetit ekonomik në rajon, i cili ishte përfunduar gjatë vjetëve të fundit nga përpjekjet diplomatike të nivelit të lartë “Procesi i Berlinit”, i cili synon lehtësimin e tregtisë, çështjeve të zhvillimit të infrastrukturës dhe zhvillimit ekonomik.

Bazuar në analizat e mësipërme, dy masa të reja do të futen në ERP, 2020–2022, me fokus në lehtësimin e tregtisë dhe transportit në kufi.

i. *Përmirësimi i kalimit kufitar të pikës Qafëthanë (Shqipëri) me Maqedoninë e Veriut, përmes krijimit të një ndalese të vetme operative.* Masa e propozuar do të rezultojë në promovimin e lëvizjeve ndërkombëtare dhe tranzitore të njerëzve dhe mallrave me BE-në dhe fqinjët e saj rajonal. Ky përmirësim do të ketë një ndikim pozitiv në kostot logjistike të tërheqjes së më shumë përdoruesve ndërkombëtarë në transportin rrugor dhe rritjen e mundësive ekonomike për drejtuesit e kamionëve në distanca të gjata dhe përdoruesit lokalë të rrugës.

ii. *Zhvillimi i sistemit të ri të kalimit të kompjuterizuar* plotësisht i pajtueshëm me BE-NCTS.

2. Aktivitetet e planifikuara

a) Aktivitetet e planifikuara më 2020-ën:

- promovimi i konceptit AEO me palët e interesuara përkatëse dhe njohja e ndërsjellë e programeve të AEO nën AP5 me sektorin privat;
- rishikimi i gjendjes fizike ekzistuese dhe pajisjeve dhe nevojave të parashikuara në projektin me Maqedoninë e Veriut.

b) Aktivitetet e planifikuara më 2021-shin:

- rishikimi i praktikave të tanishme dhe planit për të promovuar integritetin e rrjedhave të informacionit midis agjencive kufitare dhe tregtarëve dhe harmonizimin e procedurave të tyre operative me Maqedoninë e Veriut;
- zbatimi i planit për të promovuar integritetin dhe harmonizimin;
- analiza e situatës dhe rishikimi i praktikës më të mirë ndërkombëtare në zbatimin e një NCTS të re.

c) Aktivitetet e planifikuara më 2022-shin:

- arkitektura dhe vendosja e aplikimit kombëtar të tranzitit dhe regjistrimi dhe identifikimi i operatorit ekonomik plotësisht i pajtueshëm me BE-NCTS;
- vendosja e moduleve për zbatimin e NCTS, duke përfshirë sistemin kombëtar të IT-së, që krijon lidhje me fushën e përbashkët të BE-së përmes “CCN/CSI”/“SPEED 2”.

3. Indikatorët e rezultateve

Indikatori	Bazë	Objektivi	Objektivi
------------	------	-----------	-----------

		ndërmjetëm	
Rritja e eksporteve në rajon	8%	10%	12%
Ulja e kostos së transaksionit	4	8	10
Koha e duhur për të zhdoganuar mallrat	9	9	8.5

4. Ndikimi i pritsbëm në konkurrueshmëri

Përfitimet kryesore të këtyre masave do të jenë kursimi i kohës për procedurat e zhdoganimit të importit dhe të eksportit, radhitja dhe ndjekja midis pikave të kryqëzimit që do të stimulojnë tregtinë ndërkufitare dhe do të kontribuojnë pozitivisht në rritjen ekonomike, duke sjellë efekte pozitive dhe produktivitet.

5. Kostoja e parashikuar e aktiviteteve dhe burimi i financimit

Kostoja e vlerësuar për zbatimin e NCTIS-së dhe një ndalesë operative të vetme me Maqedoninë e Veriut është afërsisht 2.7 milionë euro për një projekt 5-vjeçar, një kredi nga Banka Botërore.

6. Ndikimi i pritsbëm në rezultatet sociale, si punësimi, ulja e varfërisë, barazja dhe gjinia

Një ndikim i drejtpërdrejtë do të jetë në rritjen e vëllimit të tregtisë, nxitjen e rritjes ekonomike, promovimin e vendeve të reja të punës dhe mundësi të reja.

7. Ndikimi i pritsbëm në mjedis

Masa është neutrale për sa i përket ndikimit në mjedis.

8. Rreziqet e mundshme

Rreziku	Probabiliteti (i ulët, i lartë)	Veprimi i planifikuar për uljen e rrezikut
Kapaciteti institucional për zbatimin e reformës	I mesëm	Masat kanë nevojë për një koordinim të lartë ndërinstitucional me vendin fqinj, i cili mund të vonojë ose të ndalojë zbatimin

5.3.6 Arsimi dhe aftësimi

a) Analiza e pengesave kryesore

Cilësia e arsimit dhe gjithëpërfshirja mbeten prioritet kryesor për sistemin arsimor parauniversitar. Shqipëria ka miratuar kurrikul të re bazuar në kompetencat shoqëruar me setin e librave, në përputhje me përmbajtjen dhe metodologjinë e re e zbatuar gradualisht nga viti 2014, nga klasa 1 deri 12 në sistemin arsimor parauniversitar.

Për të siguruar arsim cilësor dhe zbatimin e kurrikulës së re të bazuar në kompetenca, është i nevojshëm për t'u adresuar: përmirësimi i mëtejshëm i infrastrukturës shkollore, sigurimi i mjeteve didaktike, përdorimi i teknologjisë në procesin e mësimi, rritja e numrit të laboratorëve, kabineteve të IT-së, dhe objekteve sportive në shkolla. Vijimi me trajnimin e vazhdueshëm të mësuesve për metodologjinë e mësimdhënies, vlerësimit të nxënësve si dhe trajnimi fillestar i mësuesve të rinj, bazuar në kurrikulën me bazë kompetencën, është thelbësore.

Arsimi gjithëpërfshirës synon sigurimin e kushteve që çdo fëmijë të arrijë potencialin e plotë në sistemin arsimor. Integrimi i të gjithë fëmijëve me aftësi të kufizuara në sistemin arsimor vijon të mbetet sfidë. Numri i nxënësve me aftësi të kufizuara në shkolla jospesiale, në vitet 2018–'19, ishte 3,683, të mbështetur nga 944 mësues ndihmës, rreth një mësues për katër nxënës me aftësi të kufizuara në nivel kombëtar. Duhet të adresohet më tej numri i pamjaftueshëm i mësuesve ndihmës në rajone ku numri i nxënësve me aftësi të kufizuara për mësues është më i lartë, siç janë Tirana, qarku i Tiranës, Durrësi dhe Kamza. Ashtë aprovuar udhëzuesi i ri për mësuesit ndihmës, duke ulur numrin raportin nxënës për mësues në 2–3 nxënës për 1 mësues në nivel kombëtar.

Gjatë vitit 2019 është adresuar një çështje thelbësore për përmirësimin e këtij shërbimi arsimor: mungesa e mësuesve të licencuar të arsimit special (mësuesit ndihmës). MASR-ja ka bërë ndërhyrjet e nevojshme ligjore për të legjitimuar licencimin e kësaj kategorie mësuesish dhe në dhjetor 2019 janë licencuar 20 mësuesit e parë të arsimit special.

Në kuadër të përmirësimit të cilësisë së arsimit dhe sigurimin e arsimit gjithëpërfshirës është edhe centralizimi i klasave të kombinuara (kolektive) duke transferuar nxënësit e këtyre klasave në shkolla ku mund të arsimohen në klasa normale, me bashkëmoshatarë të tyre. Mungesa e infrastrukturës së duhur rrugore sidomos në zonat rurale të largëta, është pengesa kryesore për transportin e nxënësve. Gjithashtu, rritja e mbështetjes dhe sensibilizimi i prindërve dhe komunitetit për këtë proces centralizimi dhe transferimi të fëmijëve në shkolla me klasa normale, ku mund t'i sigurohet një arsim më cilësor, është një sfidë aktuale.

Reforma e sistemit të arsimit dhe aftësimit profesional (AFP) në Shqipëri është përqendruar kryesisht në përmirësimin aksesueshmërisë, atraktivitetit të sistemit të AFP-së, dhe rëndësisë së lidhjeve/me tregun e punës, ndërsa përpiqet të sigurojë parimet thelbësore të gjithë përfshirjes, autonomisë, cilësisë, bashkëpunimit, pjesëmarrjes, lëvizshmërisë dhe diversitetit. Pavarësisht nga potenciali i sistemit të AFP-së për t'i materializuar këto parime, sfidat legislative, institucionale dhe të zbatimit vazhdojnë. Sistemi i AFP-së ende përpiqet të përgjigjet në mënyrë proaktive ndaj nevojave/kërkesave të sektorit privat, ofron një gamë të ngushtë të programeve/kurseve dhe, kryesisht mundëson përvetësimin e aftësive të ulëta në dëm të aftësive të mesme dhe të larta profesionale. Ofruesit e AFP-së kanë një autonomi të kufizuar me vendimmarrje të pavarur të centralizuar dhe të kufizuar financiare. Bashkëpunimi me sektorin privat e ka dhënë disa rezultate pozitive sidomos në fushën e mësimin të bazuar në punë dhe, për sa i përket pjesëmarrjes së tyre në bordet menaxhuese të bordeve të ofruesve të AFP-së. Megjithatë, është e nevojshme pjesëmarrja e sektorit privat në nivele më të larta qeverisjeje.

2019-ta ka shënuar politika të konsiderueshme të zhvillimit të aftësive, si dhe kornizën ligjore dhe institucionale që rregullon sektorin. Pas rishikimit afatmesëm të Strategjisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive, 2014–2020, strategjia dhe plani i saj i veprimt të lidhur janë rishikuar dhe zgjatuar deri në vitin 2022 (siç është aprovuar me një vendim të Këshillit të Ministrave në tetor 2019). Miratimi i ligjit nr. 15/2019, “Për promovimin e punësimit” në mars 2019, përfundoi kornizën ligjore që lidhet me politikat/programet e punësimit dhe zhvillimin e aftësive, por më e rëndësishmja i hapi rrugën përfundimit të akteve nënligjore të ligjit të AFP-së. Deri në nëntor 2019, 13 nga 23 akteve nënligjore janë miratuar, 2 ishin në fazën përfundimtare të miratimit, 5 hartuar dhe rreth të ndahet për konsultime të mëtejshme dhe vetëm 3 nuk ka filluar. Për më tepër, vendosi ofruesit e arsimit dhe aftësimit profesional nën menaxhimin e Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive (AKSH) - VKM-ja 554/2019. Struktura e aprovuar e NAES përfshin një rritje të konsiderueshme të burimeve njerëzore në nivelin qendror, duke lejuar që institucioni të kryejë të gjitha funksionet e dhëna me ligj. Rikonstruksioni i Agjencisë Kombëtare të AAP-së dhe i Kualifikimeve (NAVETQ), duke përfshirë të gjitha funksionet e reja të dhëna nga ligji për AAP-në dhe ligji për kornizën e kualifikimeve shqiptare, kompletton kryesisht kornizën institucionale që rregullon sektorin e AFP-së.

Sipas të dhënave të INSTAT²², norma e punësimit të personave me arsimin e mesëm profesional është 68.3% në krahasim me 53% për ata me arsim të mesëm të përgjithshëm, duke theksuar se rritja e mundësive të punësimit për ata që janë në posedim të aftësive profesionale. Që nga viti 2017, punësimi i të gjithë maturantëve të AFP-së (si studentë të arsimit të mesëm dhe të trajnuar të mesëm) në gjurmimin përmes një studimi vjetor gjurmues. Këto rezultate tregojnë se në 2019, 52% e të diplomuarve nga 2018 ishin të punësuar dhe 12% janë njëkohësisht duke punuar dhe studiuar, për një normë të përgjithshme të punësimit prej 64%. Rezultatet nga 2018 (duke kërkuar në të diplomuar nga 2017) tregojnë se 55% janë të punësuar dhe 8% ishin duke punuar dhe studiuar, për një normë të përgjithshme të punësimit prej 63%. Pjesa e studentëve që ndjekin studimet e mëtejshme u rrit në vitin 2019.

Pavarësisht, avantazh të qartë në tregun e punës të të diplomuarve të AAP-së, regjistrimi në arsimin e mesëm profesional në vitin akademik, 2019–2020, ra në 18,164 (nga 19,200 në

²² Shqipëria në shifra 2018, INSTAT: <http://www.instat.gov.al/en/publications/books/2019/albania-in-figures-2018/>

2018–2019) studentët, njëkohësisht theksuan si sfidë atraktivitetin, nevojën për promovim më të madh të arsimit profesional, si një rrugë e zbatueshme drejt punësimit dhe ndikimet e rënies demografike. Në vitin aktual akademik ka një rritje të konsiderueshme të numrit të studentëve nga zonat rurale dhe grupeve të marginalizuara. Më konkretisht, pjesëmarrja e romëve dhe egjiptianëve (R/E) u rrit me 12%, duke arritur në 580 studentë (krahësuar me 519 në vitin e kaluar), ndërsa pjesëmarrja e personave me aftësi të kufizuara u rrit nga 108 në 128. 45,3% e nxënësve janë nga zona rurale, një rritje prej 43% më 2018–2019.

Lidhur me sigurimin e kurseve profesionale afatshkurtra të trajnimit nëpërmjet Drejtorive Rajonale Publike të Trajnimit Profesional, gjatë janar–nëntor 2019 numri i të trajnuarve të regjistruar arriti në 25,411 persona (nga të cilët 11,109 ishin femra). Kjo paraqet një rritje në krahasim me vitin 2018, kur numri i përgjithshëm i trajnuarve arriti në 17,844. Pavarësisht nga kjo rritje e rëndësishme, pjesëmarrja në arsimin dhe trajnimin formal ose joformal në Shqipëri mbetet shumë e ulët.

Prioritet i është dhënë, gjithashtu, sigurimit të cilësisë në arsimin dhe aftësimin profesional, veçanërisht zhvillimin e vazhdueshëm profesional të mësuesve/instruktorëve. Për herë të parë në 20 vjet, një program trajnimi pedagogjik 24-ditor u zhvillua në 2016 në shënjestër të të gjithë mësuesve dhe instruktorëve të AFP-së. Njohuritë pedagogjike dhe teknike kërkojnë trajnim të vazhdueshëm dhe zhvillim të vazhdueshëm, në mënyrë që të mundësojnë mësimin e njohurive bashkëkohore në një mënyrë të kuptueshme. Gjatë 3 vjetëve janë trajnuar 491 mësues dhe instruktorë dhe një shtesë 120 janë trajnuar në vitin 2019. Përtej trajnimit pedagogjik 21-ditor, programe të tjera trajnimi u janë dorëzuar menaxherëve dhe mësuesve në arsimin profesional përmes programeve të donatorëve. Institucionalizimi i tyre dhe sigurimi i zhvillimit të vazhdueshëm profesional përtej kualifikimit fillestar është akoma i nevojshëm.

Një hap shtesë drejt sigurimit të cilësisë ishte vetëvlerësimi i kryer në të gjithë 45 ofruesit e AFP-së (35 shkolla dhe 10 QFP) në vitin 2019 - mbështetur nga UNDP-ja dhe NAVETQ-ja, dhe i cili do të shërbejë një bazë të mirë për përmirësime të mëtejshme në nivelin e ofruesit. Për të përmbushur nevojat e tregut të punës për punonjës të aftë, në vitin 2019 janë hartuar 13 përshkrime/standarde të kualifikimit profesional dhe 6 kurrikula kornizë. Aktualisht, AKAFPK-ja është në proces të zhvillimit të dy kualifikimeve të reja për të teknologjitë e programimit dhe bujqësore. Kurrikulat e rishikuar synojnë të përfshijnë grupe të marginalizuara për të ndjekur arsimin profesional.

Gjithashtu, Rregullorja Kombëtare e Elementeve Thelbësore të WBL-së (mësimi i bazuar në punë) është në pritje të aprovimit. Ai rregullon WBL-në në nivel kombëtar në role dhe përgjegjësi midis shkollave LFS dhe sektorit privat, në mënyrë që të rrisë cilësinë për shpërndarjen e WBL-së.

Përmes buxhetit të shtetit, investime të konsiderueshme në infrastrukturë janë bërë në shkollat profesionale dhe qendrat e trajnimit, si në aspektin e ndërtesave të reja, moderne dhe laboratorëve. Ndërsa, digjitalizimi është bërë një element i rëndësishëm i tregut të punës dhe disa investime në infrastrukturë digjitale janë ndërmarrë; ofruesit e AFP-së ende nuk duhet të përdorin avantazhet e tij dhe të angazhohen në mënyra të reja të të mësuarit/mësimdhënies moderne.

b) Masat e reformave

Reforma 14: Përfundimi i reformës kurrikulare parauniversitare, trajnimi dhe punësimi i mësuesve

1. Përshkrimi

Implementimi i kurrikulës së bazuar në kompetenca për klasën e pestë përmbylli procesin e reformës kurrikulare në vitin 2020 dhe do t'i japë mundësinë MASR-së të zhvendosë fokusin drejt vijimit të trajnimit të mësuesve dhe vlerësimit të kurrikulës së re. Reforma në arsimin parashkollor ka qenë në koherencë me reformat në të gjitha nivelet e tjera të sistemit arsimor parauniversitar. Në këtë kuadër janë hartuar dokumente të reja kurrikulare, si dhe zhvillimi profesional i mësuesve parashkollorë.

Një politikë tjetër e rëndësishme është “sigurimi i teksteve falas” për të gjithë nxënësit e arsimit të detyrueshëm (klasa 1–9) deri në vitin 2022, përveç fëmijëve nga kategoritë vulnerabël.

Në lidhje me zhvillimin e vazhdueshëm profesional të mësuesve, legjislacioni shprehet që mësuesit dhe drejtorët duhet të trajnohen të paktën 3 ditë në vit, bazuar në nevojat e mësuesve dhe ofertave nga agjencitë e akredituara të trajnimit. Përveç agjencive të akredituara, trajnime për mësuesit ofron edhe Agjencia për Sigurimin e Cilësisë në Arsimin Parauniversitar (ASCAP).

Bazuar në Memorandumin e Mirëkuptimit mes MASR-së dhe *British Council*, në kuadër të programit “Shkollat e shekullit 21”, financuar nga Qeveria e Mbretërisë së Bashkuar, një total prej 4.500 mësuesish do të trajnohen nga trajnues kombëtar, 23 500 *micro:bits* do të shpërndahen përgjatë programit dhe 1197 shkolla do të jenë përfituese. Ky program trajnimi është i fokusuar në të menduarin kritik, zgjidhjen e problemeve dhe aftësitë në kodim për të përdorur *micro:bits* dhe për të praktikuar aftësitë në klasë. Kurrikula e bazuar në kompetenca në Shqipëri përfshin në aftësitë themelore dhe kompetencën e të mësuarit gjatë gjithë jetës, të menduarit kritik, zgjidhjen e problemeve dhe aftësitë digjitale.

2. Aktivitetet e planifikuara

a) Aktivitetet e planifikuara më 2020-ën:

- vlerësimi i kurrikulës së re në arsimin parauniversitar bazuar në vlerësimin e brendshëm dhe raportet e jashtme;
- përfshirja e klasës së 6-të në politikën e “teksteve shkollore falas”;
- trajnimi i 1100 ToT, drejtuesit e rrjeteve profesionale, në kurrikulën e bazuar në kompetenca²³;
- rritja e kapaciteteve të stafit në njësitë arsimore vendore, mbi udhëzimet për sigurimin e cilësisë (200 specialistë);
- trajnimi i 92 ToT, drejtuesit e rrjeteve profesionale në arsimin parashkollor, në kurrikulën e bazuar në kompetenca;
- trajnimi i 1500 drejtuesve të arsimit parashkollor dhe mësuesit e nxënësve të moshës 5–6, mbi dokumentacionin e ri të kurrikulave;
- trajnimi i 2,200 mësuesve dhe implementimi i programit “Shkollat e shekullit 21” për 40,000 studentë.

b) Aktivitetet e planifikuara më 2021-shin

- rishikimi i kurrikulës për arsimin bazë dhe zbatimi i tij sipas rezultateve të vlerësimit;
- trajnimi i 1100 ToT, drejtuesit e rrjeteve profesionale në kurrikulën e bazuar në kompetenca;
- përfshirja e klasës së 7-të në politikën e “librave shkollorë falas”;
- ngritja e qendrave të formimit të mësimit gjatë gjithë jetës në universitete për organizimin e aftësimit të mësuesve në arsimin parauniversitar;
- vlerësimi i reformës së punësimit të mësuesve, përfshirë vlerësimin e portofolit, të procesit të testimit dhe të gjithë platformës;
- ngritja e kapaciteteve për zbatimin e udhëzimeve për sigurimin e cilësisë, të stafit në njësitë arsimore vendore (200 specialistë të trajnuar dhe të mentoruar);
- trajnimi i 4800 drejtorëve të arsimit parashkollor dhe mësuesit e nxënësve të moshës 5–6, mbi dokumentacionin e ri kurrikular;
- trajnimi i 1100 mësuesve të mbetur dhe implementimi i programit “Shkollat e shekullit 21” për 20,000 nxënës.

c) Aktivitetet e planifikuara më 2022-shin:

- rishikimi i kurrikulave për arsimin e mesëm të lartë, sipas rezultateve të vlerësimit dhe zbatimi i tij;
- trajnimi i 1100 ToT, drejtuesit e rrjeteve profesionale në kurrikulën e bazuar në kompetenca;
- përfshirja e klasës së 8-të dhe të 9-të në politikën e “teksteve shkollore falas”;
- vlerësimi i efektivitetit të programit të aftësimit fillestar të mësuesve për mësuesit e rinj;

²³ Një TOT trajnon rreth 20–25 mësues në të njëjtin profil.

- ngritja e kapaciteteve për zbatimin e udhëzimeve për sigurimin e cilësisë, të stafit në njësitë arsimore vendore (200 specialistë të trajnuar dhe të mentoruar);
- trajnimi i 4800 drejtuesve dhe i mësuesve të arsimit parashkollor të moshës 5–6, mbi dokumentacionin e ri kurrikular;
- analizimi i rezultateve të programit “Shkollat e shekullit 21”.

3. Indikatorët e rezultateve

Indikatori	Bazë (2019)	Objektivi i ndërmjetëm (2021)	Objektivi (2022)
Numri i mësuesve të trajnuar nëpërmjet rrjeteve profesionale	22 500	22500	22500
Rezultatet e OECD PISA në aftësitë bazë të 15-vjeçarëve	PISA 2018 literacy 405; matematikë 489; shkencë 417	2021 PISA	2022 (rezultatet e PISA 2021)
Numri i nxënësve që përfitojnë/përdorin tekste falas	Viti shkollor 2019–2020: rreth 155,000 nxënës, klasa 1–5; 70,000 nxënës nga 16 kategori vulnerabël ²⁴		

4. Ndikimi i pritsbëm në konkurrueshmëri

Në terma afatgjatë, sipas studimeve si ai i PISA-s i OECD-së, i cili bën një lidhje midis rezultateve më të mira në aftësitë bazë dhe zhvillimit ekonomik të vendeve, rritja e cilësisë së mësuesve rrit dhe rezultatet në aftësitë duke mundësuar gjeneratat e nxënësve të përgatiten më mirë për tregun e punës, si punëmarrës apo punëdhënës.

5. Kostoja e parashikuar e aktiviteteve dhe burimi i financimit

Në lidhje me programin “Shkollat e shekullit 21” kostot e vlerësuara janë 3 milionë e 484000 paund britanikë gjatë 3 vjetëve, të mbuluara nga Qeveria e Mbretërisë së Bashkuar.

Viti	Aktiviteti	Kostoja e vlerësuar	Burimi i financimit
2020	Vlerësimi i kurrikulës së re në arsimin parauniversitar bazuar në vlerësimin e brendshëm në arsimin bazë dhe atë të mesëm të lartë	10 000 euro	Buxheti i shtetit
	Vlerësimi i kurrikulës së re në arsimin parauniversitar bazuar në vlerësimin e jashtëm	27 300 euro	UNICEF
	Trajnim për 1100 ToT të fokusuar, veçanërisht, në shkencë	34 000 euro	Buxheti i shtetit
	Ngritja e kapaciteteve për 200 specialistë të zyrave vendore arsimore	3 000 euro	Buxheti i shtetit
	Trajnim për 92 ToT mbi kurrikulën e re.	1 500 euro	
	Trajnim për 1500 drejtorë të arsimit parashkollor dhe mësuesit e moshë 5–6 vjeç mbi dokumentacionin e ri kurrikular	20 000 euro	

²⁴ Raporti vjetor i MASR-së.

2021	Trajnimi i 1100 ToT (drejtuesi i rrjeteve profesionale) për zbatimin e kurrikulës së re, të fokusuar, veçanërisht, në gjuhë	40 000 euro	Buxheti i shtetit
	Rishikimi i kurrikulës për arsimin bazë dhe zbatimin e tij, sipas rezultateve të vlerësimit	2 000 euro	Buxheti i shtetit
	Ngritja e qendrave të formimit të mësimit gjatë gjithë jetës në universitete për organizimin e trajnimit të mësuesve në arsimin parauniversitar	750 820 euro	Erasmus+, buxhet BE
	Trajnim për 200 specialistë të zyrave vendore arsimore për zbatimin e udhëzimeve për sigurimin e cilësisë	4 000 euro	Buxheti i shtetit
	Trajnim për 4500 drejtues dhe mësues të arsimit parashkollor të moshës 5–6 vjeç mbi dokumentacionin e kurrikulës së re	60 000 euro	
2022	Trajnimi i 1100 ToT (drejtuesi i rrjeteve profesionale) për zbatimin e kurrikulës së re bazuar në kompetenca, të fokusuar, veçanërisht, në matematikë	40 000 euro	Buxheti i shtetit
	Rishikimi i kurrikulës për arsimin e mesëm të lartë dhe zbatimin e tij sipas rezultateve të vlerësimit	2 000 euro	Buxheti i shtetit
	Vlerësimi i efektivitetit të programit të aftësimit fillestar të mësuesve për mësuesit e rinj	2 000 euro	Buxheti i shtetit
	Mentorim 200 specialistë njësitë vendore arsimore për zbatimin e udhëzimeve për sigurimin e cilësisë	4 000 euro	Buxheti i shtetit

5. Ndikimi i pritshëm në rezultatet sociale, si: punësimi, ulja e varfërisë, barazia dhe gjinia

Masa ka efekt neutral në aspektin gjinor. Barazia gjinore do të respektohet gjatë gjithë zbatimit të masës së reformës.

6. Ndikimi i pritshëm në mjedis

Masa ka efekt neutral për sa i përket ndikimit në mjedis.

7. Rreziqet e mundshme

Rreziku	Probabiliteti (i ulët, i lartë)	Veprimi i planifikuar për uljen e rrezikut
Kufizimet buxhetore për politikën e “teksteve shkollore falas”	I ulët	I përfshirë në Planin Buxhetor Afatmesëm, 2020-2022
Performanca e ulët e stafit të sapopunësuar në LEO	I ulët	Planifikim për ngritjen e kapaciteteve për stafin e zyrave vendore arsimore të cilët do të vlerësojnë cilësinë në shkollë

Reforma 15: Arsimi përfshirës

1. Përshkrimi

Kjo reformë synon arsim gjithëpërfshirës përmes rritjes së mëtejshme të numrit të mësuesve ndihmës për fëmijët me aftësi të kufizuara në shkollat publike kryesore dhe uljen e mëtejshme të nxënësve që ndjekin klasa kolektive me cilësi të ulët. Përgjatë dy viteve të kaluara është dhënë prioritet mbështetjes profesionale të mësuesve ndihmës. Janë bërë përpjekje për të organizuar mësuesit ndihmës në rrjete profesionale dhe trajnimin e tyre. Janë ngritur 42 rrjete profesionale dhe rreth 500 mësues ndihmës janë trajnuar nga Agjencia e Sigurimit të Cilësisë për Arsimin Parauniversitar, si dhe nga partnerë joqeveritarë. Nevojat për mësues ndihmës për fëmijë me aftësi të kufizuara përcaktohen nga komisionet multidisiplinare, të ngritura në secilën zyrë vendore arsimore.

Sa i përket centralizimit të klasave kolektive, vitin e kaluar janë centralizuar 348 klasa të tilla duke i transferuar 2829 nxënës në shkollat më të afërta për t'u arsimuar në klasa normale me bashkëmoshatarët e tyre. Janë marrë të gjitha masat për të siguruar transportin e nxënësve. Aktualisht, çdo fëmijë që jeton mbi 2 km nga shkolla, përfiton transport falas. Gjithashtu është hartuar kurrikul e dedikuar bazuar në kompetenca dhe udhëzuesi për zbatimin e saj, për nxënësit në klasat kolektive me arritje bazike në arsim.

2. Aktivitetet e planifikuara

a) Aktivitetet e planifikuara më 2020-shin:

- rritja e numrit të nxënësve që ndjekin shkolla me cilësi më të mirë deri në 500²⁵ ose më shumë, duke i transferuar ata nga klasat kolektive²⁶;
- rritja e numrit të mësuesve ndihmës për fëmijët me aftësi të kufizuara në shkollat publike në 1,000;
- mbështetja e zhvillimit profesional të mësuesve ndihmës nëpërmjet trajnimit të 42 ToT (drejtuesit e rjetit profesional të mësuesve ndihmës) dhe 1000 mësuesve ndihmës.

b) Aktivitetet e planifikuara më 2021-shin:

- rritja e numrit të nxënësve që ndjekin shkolla me cilësi më të mirë deri në 500 ose më shumë, duke i transferuar ata nga klasat kolektive;
- rritja e numrit të mësuesve ndihmës për fëmijët me aftësi të kufizuara në shkollat publike në 1,050;
- mbështetja e zhvillimit profesional të mësuesve ndihmës nëpërmjet trajnimit të 1050 mësues ndihmës në të gjithë vendin;
- disenjimi i materialeve burimore (manuale, module, instrumente etj.) për mësuesit ndihmës.

c) Aktivitetet e planifikuara më 2022-shin:

- rritja e numrit të nxënësve që ndjekin shkolla me cilësi më të mirë deri në 500 ose më shumë, duke i transferuar ata nga klasat kolektive;
- rritja e numrit të mësuesve ndihmës për fëmijët me aftësi të kufizuara në shkollat publike në 1,100;
- mbështetja e zhvillimit profesional të mësuesve ndihmës nëpërmjet trajnimit të 1100 mësues ndihmës në të gjithë vendin;
- përmirësimi i materialeve burimore (manuale, module, instrumente etj.) për mësuesit ndihmës.

3. Indikatorët e rezultateve

Indikatori	Bazë (viti)	Objektivi i ndërmjetëm (viti)	Objektivi (viti)
Numri i nxënësve në klasa kolektive të transferuar në shkollat e afërta me cilësi më të mirë	2018–2019 2829 nxënës	2020 +500 referuar nivelit bazë	2022 +1000 referuar nivelit bazë
Numri i mësuesve ndihmës për fëmijët me aftësi të kufizuara në shkollat publike	944	1000	1100
Fëmijët me aftësi të kufizuara të integruar në shkollat publike jospesiale në raport me totalin e nxënësve me aftësi të kufizuara që ndjekin arsimim.	2019 85%	2020 86%	2021 87%

4. Ndikimi i pritshëm në konkurrueshmëri

Në terma afatgjatë, sigurimi i mundësive për arsimim më të mirë për fëmijët që janë në klasa kolektive dhe për ata me aftësi të kufizuara, u rrit mundësinë për të arritur aftësitë e nevojshme për t'u përfshirë në tregun e punës dhe për të jetuar një jetë të pavarur si të rritur.

5. Kostoja e parashikuar e aktiviteteve dhe burimi i financimit

²⁵ Numrat ekzaktë do të të përcaktohen bazuar në analizat vjetore.

²⁶ Për këtë aktivitet nuk është planifikuar kosto shtesë, pasi efektet në buxhet janë pozitive, pra sjell reduktim të shpenzimeve buxhetore.

Viti	Aktiviteti	Kostoja e vlerësuar	Burimi i financimit
<i>Mësues ndihmës për fëmijët me aftësi të kufizuara në shkollat kryesore është 6.8 milionë euro</i>		<i>6.8 milionë euro</i>	<i>Buxheti i shtetit</i>
2020	1000 mësues ndihmës për fëmijët me aftësi të kufizuara në shkollat publike	46 800 000 ALL	Buxheti i shtetit
	Trajnimi i 1000 mësuesve ndihmës në të gjithë vendin	27 000 euro	
2021	1050 mësues ndihmës për fëmijët me aftësi të kufizuara në shkollat publike	49 140 00 ALL	Buxheti i shtetit
	Trajnim të 1050 mësues ndihmës në të gjithë vendin	27 000 euro	
	Disenjimi i materialeve burimore (manuale, module, instrumente etj.)	12 000 euro	
2022	1100 mësues ndihmës për fëmijët me aftësi të kufizuara në shkollat publike.	51 480 000 ALL	Buxheti i shtetit
	Trajnim të 1100 mësuesve ndihmës në të gjithë vendin	29 000 euro	
	Përmirësim i materialeve burimore (manuale, module, instrumente etj.)	20 000 euro	

6. Ndikimi i pritshëm në rezultatet sociale, si: punësimi, ulja e varfërisë, barazia dhe gjinia

Përfshirje më e mirë, mundësi më të mira për fëmijët. Punësimi i mësuesve ndihmës. Barazia gjinore do të respektohet gjatë zbatimit të masës së reformës.

7. Ndikimi i pritshëm në mjedis

Masa ka efekt neutral për sa i përket ndikimit në mjedis.

8. Rreziqet e mundshme

Rreziku	Probabiliteti (i ulët, i lartë)	Veprimi i planifikuar për uljen e rrezikut
Ngurrimi i familjeve për të lejuar transferimin e fëmijëve të tyre në shkollat më të afërta	I ulët	Masa mbështetëse për fëmijët dhe prindërit Bashkëpunim me komunitetin për këtë proces
Mungesa e fondeve të mjaftueshme për të punësuar mësues ndihmës	I ulët	Planifikuar në Planin Buxhetor Afatmesëm, 2020 –2022

Reforma 16: Modernizimi i financimit të sistemit parashkollor

1. Përshkrimi

Në kuadrin e politikave efektive të decentralizimit fiskal, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë kanë punuar për të siguruar që transferimi i funksioneve në nivel vendor të shoqërohet me vendosjen e një skeme financimi të përshtatshme dhe efektive që synon përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së shërbimeve.

Në këtë kuadër, në buxhetin e vitit 2020 do të konsolidohet një formulë e re e ndarjes së fondeve për arsimin parashkollor, e cila implementon legjislacionin për arsimin parauniversitar, legjislacionin për qeverisjen dhe financat vendore dhe që bazohet në praktikën e mira ndërkombëtare.

Buxheti i vitit 2020 shënon vazhdimin e një reforme të rëndësishme që vendos një standard të ri në arsimin parashkollor. Kjo reformë e nisur në vitin 2019 do të vazhdojë në vitet e mëvonshme, konform kuadrit ligjor në fuqi dhe praktikave më të mira ndërkombëtare, ku fondet për arsimin parashkollor të ndahen kryesisht mbi bazën e numrit të nxënësve, si treguesi më i mirë i nevojës për fonde dhe shërbime, dhe pjesërisht do të bazohet në sistemin aktual të ndarjes së fondeve, sipas numrit të edukatoreve të transferuara në vitin 2016 deri në vitin 2018. Për sa më sipër, në buxhetin e vitit 2020, fondet e pagave për edukatoret do të ndahen kryesisht mbi bazën

e numrit të fëmijëve. Më specifikisht, 60% e fondeve për pagat e edukatoreve do të ndahen mbi bazën e numrit të fëmijëve (me moshë 3–6 vjeç) dhe 40% mbi bazën e numrit të edukatoreve. Kjo reformë siguron një ndarje më të përshtatshme të fondeve, duke u bazuar në numrin e fëmijëve që duhet t'u ofrohet edukimi parashkollor, por njëkohësisht siguron një tranzicion gradual që minimizon kostot, duke ruajtur 40% të sistemit aktual.

2. Aktivitetet e planifikuara

a) Aktivitetet e planifikuara më 2020-ën:

- evidentimi i edukatoreve të punësuar gjatë vitit 2019;
- në udhëzimin e zbatimit të buxhetit vjetor do të përcaktohen afatet dhe formatet e raportimit mbi ecurinë e kësaj reforme;
- monitorimi dhe ndjekja e ecures së implementimit të kësaj reforme dhe efekteve në përmirësimin e cilësisë së arsimit parashkollor.

b) Aktivitetet e planifikuara më 2021-shin:

- diskutimi me njësitë e vetëqeverisjes vendore mbi ecurinë dhe përmirësimin e kësaj reforme për vitet në vazhdim;
- monitorimi i vazhdimësisë së implementimit të reformës në arsimin parashkollor nga njësitë e vetëqeverisjes vendore;
- vlerësimi efektit që ka sjellë në arsimin parashkollor.

c) Aktivitetet e planifikuara më 2022-shin:

- diskutimi me njësitë e vetëqeverisjes vendore mbi ecurinë dhe përmirësimin e kësaj reforme për vitet në vazhdim;
- monitorimi i vazhdimësisë së implementimit të reformës në arsimin parashkollor nga njësitë e vetëqeverisjes vendore;
- vlerësimi efektit që ka sjellë në arsimin parashkollor.

3. Indikatorët e rezultateve

- ulja e madhësisë së grupeve/klasave të fëmijëve në kopshte nga raporti aktual mesatar 18 fëmijë për një edukatore në raportin 15 fëmijë për një edukatore.
- shtimi i fondeve në ato bashki, ku ka një nevojë reale dhe të menjëhershme për shtimin e numrit të edukatoreve, duke ulur madhësinë maksimale të grupeve nga 26 apo 23 fëmijë për një edukatore në 18 fëmijë për edukatore, një parakusht për përmirësimin e cilësisë së edukimit për fëmijët nga 3–6 vjeç që ndjekin kopshtet publike.

4. Ndikimi i pritshëm në konkurrueshmëri

Kjo reformë nuk ndikon në nivelin e konkurrueshmërisë në treg për sa kohë lidhet me rritjen e mbështetjes buxhetore me qëllim rritjen e cilësisë së ofrimit të shërbimit parashkollor. Në këtë mënyrë, rritja shkon plotësisht në drejtim të përmirësimit të shërbimit të arsimit parashkollor që ofrohet nga njësitë e vetëqeverisjes vendore, duke mos ndikuar në konkurrueshmërinë e tregut.

5. Kostoja e parashikuar e aktiviteteve dhe burimi i financimit

Kostoja e kësaj reforme është 327 milionë lekë, dhe mbulohet nga rritja e transfertës së pakushtëzuar për njësitë e vetëqeverisjes vendore në programin buxhetor afatmesëm për vitin 2020, 2021 dhe 2022. Burimi i financimit do të jetë rritja e transfertës së pakushtëzuar nga viti në vit, me qëllim mbulimin dhe krijimin e vazhdimësisë së reformës ndër vite.

6. Ndikimi i pritshëm në rezultatet sociale, si: punësimi, ulja e varfërisë, barazia dhe gjinia

Kjo siguron një rritje të numrit të edukatoreve nga 4410 në 4850, pra 440 edukatore më shumë, të cilat do të shpërndahen në 32 bashki, të cilat kanë nevojën më imediate për shtimin e numrit të edukatoreve. Kjo rritje e numrit të punonjësve nuk ka në thelb adresimin e çështjeve gjinore, pavarësisht se mbështetja me edukatore të shërbimit parashkollor do të rritë numrin e femrave të punësuar në sistemin arsimor. Nga përmirësimi i këtij shërbimi, në mënyrë indirekte do të lehtësohet puna dhe shërbimi i nënave ndaj fëmijëve përmes shërbimit cilësor në arsimin parashkollor.

7. Ndikimi i pritshëm në mjedis

Reforma nuk pritet të ketë ndikim në mjedis.

8. Rrezikët e mundshme

Risk i mundshëm i zbatimit të reformës është mosplotësimi brenda një afati të shkurtër kohor të numrit të punonjësve nga njësitë e vetëqeverisjes vendore. Për këtë risk të evindetuar janë marrë masat e nevojshme nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, përmes përcaktimit në kuadrin nënligjor të zbatimit të buxhetit mbi procedurat dhe rregullat që do të ndiqen në zbatimin e këtij fondi për mbështetjen e reformës në arsimin parashkollor.

Reforma 17: Përmirësimi i cilësisë dhe mbulimit të AFP-së duke siguruar lidhjet me tregun e punës

1. Përshkrimi

Strategjia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive, 2019–2022, është dokumenti kryesor i politikës që udhëzon zbatimin e veprimeve që lidhen me punësimin dhe zhvillimin e aftësive në vend. Objektivat (rritja e cilësisë së rezultateve të arsimit, zhvillimi i kualifikimeve, tërheqja dhe rëndësia e sistemit të arsimit profesional dhe parashikimi i aftësive për të korrigjuar mospërputhjet dhe përmirësimi i njohjes së aftësive) do të arrihen përmes disa aktiviteteve që lidhen me modernizimin e përfshirjes në AFP, duke synuar zhvillimin e tregut të punës.

Sigurimi i arsimit dhe aftësimit profesional cilësor për të rinjtë dhe të rriturit janë prioritetet e përgjithshme strategjike të AFP-së.

2. Aktivitetet e planifikuara

a) Aktivitetet e planifikuara më 2020-ën:

- plani i optimizimit të ofertës së VET-së, në përputhje me nevojat rajonale për zhvillim të aftësive hartuar dhe miratuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe të fillojë procesi riorganizimit të ofruesve të AFP-së;
- rishikimi i mekanizmave të financimit dhe buxhetimit të ofruesit të AFP-së dhe përfundimi i akteve nënligjore të autonomisë financiare;
- zhvillimi i kompetencat për 200 mësues të AFP-së, si dhe të trajnuesve të mësuesve (fillimi i një trajnimit profesional të vazhdueshëm), (MFE, NAVETQ, ofrues të AFP-së);
- analiza e sistemeve ekzistuese të informacionit për AFP;
- forcimi dhe zhvillimi i kapaciteteve të AKPA-së dhe AKAFPK-së;
- ngritja e Këshillit Kombëtar të AFP-së;
- rishikimi i kualifikimeve profesionale, në përputhje me KSHK-në dhe nevojave të tregut të punës.

b) Aktivitetet e planifikuara më 2021-shin:

- përmirësimi i cilësisë së AFP-së, përmes investimeve në infrastrukturë (MFE, NAES, NAVETQ);
- zhvillimi i kompetencave të 250 mësuesve të AFP-së, si dhe të trajnuesve të mësuesve;
- krijimi i sistemit të informacionit për AFP-në;
- zhvillimi dhe zbatimi i KSHK-së.

c) Aktivitetet e planifikuara më 2022-shin:

- rritja e cilësisë së AAP-së përmes investimeve në infrastrukturë;
- zhvillimi i kompetencave të 300 mësimeve të AAP-së dhe mbështetjen e stafit as dhe trajnuesit e mësuesve (MEF, NAES, AKAFPK);
- themelimi i Komitetit të Dytë sektorial (teknologjia e informacionit dhe komunikimi).

3. Indikatorët e rezultateve

Indikatori	Bazë (2014)	Objektivi i ndërmjetëm (2018)	Objektivi (2022)
% e të diplomuarve tani në punë			
% e mësuesve të trajnuar në trajnim gjatë gjithë jetës	0	70%	100%
Numri i regjistrimeve në AP dhe % e studentëve që ndjekin arsimin e mesëm të përgjithshëm	14%	19.8%	21%
% e studentëve femra që ndjekin shkollat e AP-së	10	16	20

4. Ndikimi i pritshëm në konkurrueshmëri

Reforma synon të aftësojë të rinjtë me trajnimin, aftësitë dhe kualifikimet e nevojshme për të konkurruar në tregun e punës dhe për të rritur mundësitë e tyre të punësimit. Një forcë pune e kualifikuar është një parakusht për tërheqjen e investimeve të bazuara në teknologji, zhvillim të mëtutjeshëm të sektorëve shqiptarë me avantazhe krahasuese dhe/ose mundësi dhe forca (si turizmi) dhe një faktor i rëndësishëm që nxit hyrjet e IHD-ve.

5. Kostoja e parashikuar e aktiviteteve dhe burimi i financimit

Shpenzimet për zbatimin e masave të AFP-së përfshihen në Programin Buxhetor Afatmesëm. Buxheti afatmesëm, 2020–2023, është në procesin e planifikimit.

6. Ndikimi i pritshëm në rezultatet sociale, si: punësimi, ulja e varfërisë, barazia dhe gjinia

Reforma synon të sigurojë arsim gjithëpërfshirës dhe me cilësi të barabartë dhe të promovojë mundësi të të nxëniet gjatë gjithë jetës. Gjithashtu, përqendrimi synon zhvillimin e aftësive, veçanërisht në lidhje me qasjen në aftësi profesionale për punësim, punë të mirë dhe ndërmarrësi, eliminimi i pabarazisë gjinore dhe sigurimi i aksesit për të prekurit.

7. Ndikimi i pritshëm në mjedis

Masa e reformës nuk pritet të ketë ndikim në mjedis.

8. Rreziqet e mundshme

Rreziku	Probabiliteti (i ulët, i lartë)	Veprimi i planifikuar për uljen e rrezikut
Disponueshmëri e pamjaftueshme për trajnime/praktikë në vend të punës në treg	I ulët	
Mosgatishmëria e mësuesve për të marrë pjesë në trajnime të vazhdueshme		
Niveli i pamjaftueshëm i koordinimit me bizneset për mbështetje më të mirë të AFP-së	I mesëm	
Mungesa e vlerësimit specifik rajonal për aftësitë që mungojnë në tregun e punës	I mesëm	

5.3.7 Punësimi dhe tregu i punës

b) Analiza e pengesave kryesore

Të dhënat e tregut të punës sugjerojnë se rritja ekonomike në Shqipëri gjatë katër vjetëve të fundit është përkthyer në përmirësime të konsiderueshme në tregun e punës. Krijimi i vendeve të punës u shoqërua nga një rënie e thellë në 2013 dhe rritja ekonomike dhe punësimi filluan të lëvizin paralelisht. Edhe pse shkalla e punësimit për personat e moshës 15–64 vjeç në Shqipëri u rrit nga rreth 50 për qind në fund të vitit 2013 në 61.4 për qind në Q2-2019, duke shënuar kështu raportin më të lartë në mesin e vendeve të Ballkanit Perëndimor, ai mbetet nën mesataren e vendeve të Bashkimit Evropian. Shkalla e punësimit është përmirësuar ndjeshëm, veçanërisht, në mesin e grave (nga 40 për qind në 2013 në 54.6 për qind në TM2-2019). Sidoqoftë, pabarazia gjinore mbetet problematike, duke qenë se, niveli i punësimit të burrave është rreth 14 për qind më i lartë se ai i grave, potencialisht një pasqyrim i normave kulturore, në lidhje me strukturën familjare dhe alternativa të kufizuara për kujdesin për fëmijë dhe të moshuar.

Rritja e punësimit është shoqëruar me një rritje të pjesëmarrjes së fuqisë punëtore, e cila arriti 69.8 për qind në TM2-2019. Pjesëmarrja e grave u rrit me pothuajse 12 për qind gjatë katër viteve, nga 50 për qind në 2013 në 61.9 për qind në TM2-2019. Sidoqoftë, nivelet e pjesëmarrjes së fuqisë punëtore mbeten, gjithashtu, nën mesataren evropiane, me një ndryshim të rëndësishëm midis meshkujve dhe femrave prej 15 për qind. Shkalla e pjesëmarrjes së të rinjve (15–29) është më e ulët se për pjesën tjetër të popullsisë (53.0% me një hendek gjinor prej 14%).

Përtej përmirësimeve të qëndrueshme, Shqipëria ende përballlet me sfida të rëndësishme në sigurimin e punësimit të sigurt dhe produktiv për të gjithë personat në moshë pune, nxitjen e produktivitetit më të lartë dhe sigurimin e integritetit në tregun e punës, të grupeve të cënueshme,

veçanërisht të varfërve, grave, të rinjve dhe grupeve të tjera të pafavorizuara. Një sfidë e madhe për vendin është përmirësimi i cilësisë së mundësive të punësimit.

Ndërsa papunësia ka rënë ndjeshëm, në 11.5 për qind në TM2-2019, ajo mbetet e lartë, veçanërisht në krahasim me vendet e BE-së. Vetëm më pak se gjysma e të papunëve kërkojnë punësim përmes shërbimeve publike të punësimit, duke dëshmuar se skema e ndihmës ekonomike, zyrat e punësimit dhe politikat aktive të tregut të punës duhet të strukturohen më mirë për të mbështetur të papunët. Shkalla e papunësisë së të rinjve në 2018 ka rënë në 20.9%, niveli më i ulët që nga viti 2012, por ende mbetet i lartë. Të rinjtë përballen me një sfidë të shtuar në tranzicionin e tyre në tregun e punës, me 24.8% të tyre që nuk ishin në punësim, arsim ose trajnim (NEET) në Q2-2019. Rinia e rrezikuar është në shënjestër të pamjaftueshme të PNP-së. Ndërsa numri i studentëve të regjistruar në arsimin e mesëm profesional (AP) është rritur gjatë viteve të fundit, ai është akoma i ulët. Kalimi nga AP-ja në tregun e punës është mjaft i ulët (46.9% e punësuar një vit pas diplomimit).

Përmirësimet e mëtejshme, veçanërisht, për ato që janë në kufijtë e tregut të punës, varen nga përmirësimi i politikave aktive të punësimit dhe ofrimit të shërbimeve sociale cilësore. Riintegrimi në tregun e punës të grupeve të cënueshme nuk mund të arrihet plotësisht, ndërsa shërbimet e kujdesit shoqëror mbeten të pamjaftueshme dhe të pazhvilluar. Kjo e fundit lidhet kryesisht me përparimin e procesit të decentralizimit, kapacitetet e dobëta të qeverisjes vendore dhe aftësinë e tyre për të planifikuar dhe shpërndarë burime për ofrimin e shërbimeve të kujdesit shoqëror. Ka filluar koordinimi midis Shërbimit Kombëtar të Punësimit (SHKP) dhe Shërbimeve Sociale Shtetërore (SHSSH), megjithatë angazhimi i pushtetit lokal duhet të ndiqet.

Kursi i aftësive të buta/bazike (*Start Smart*) u zbatua në mbarë vendin gjatë vitit 2019.

Me gjithë disa përmirësimet gjatë vitit 2018, në efikasitetin e ndërmjetësimit të vendeve të punës, fondet për politikat aktive të tregut të punës kanë mbetur të pandryshuara në vitet e kaluara (pas një rritje të konsiderueshme më 2014–2015). Programet e nxitjes së punësimit (PNP), të zbatuara më 2015–2016 u vlerësuan në vitin 2018, duke theksuar më tej nevojën për rishikimin e PNP-ve dhe ndryshimin e modaliteteve të zbatimit. Pas aprovimit të ligjit për nxitjen e punësimit, procesi i ridisnjimit të PNP-së ka filluar, me qëllim përfundimtar të përmirësimit të relevancës me tregun e punës, cilësisë dhe targetimin.

c) Masat e reformave

Reforma 18: Përmirësimi i punësueshmërisë të punëkërkuesve të papunë më vulnerabël përmes adresimit më të mirë të PNP-ve dhe shërbimeve të punësimit

1. Përshkrimi

Strategjia Kombëtare për Punësim dhe Aftësi (SKPA), 2014–2020, dhe plani i saj i veprimit në lidhje janë rishikuar dhe zgjatur deri në vitin 2022 miratuar me vendim të Këshillit të Ministrave nr. 659, datë 10.10.2019. Çdo masë do të zbatohet nga mbështetja e parashikuar në Kontratën e Reformës Sektoriale (KRS) të mbështetjes buxhetore të BE-së, si dhe nga projektet e donatorëve. Qëllimi kryesor i Strategjisë Kombëtare për Punësim dhe Aftësi, 2019–2022 dhe planit të saj të veprimit është të identifikojë dhe hartojë politikat e duhura të stimulimit në vend për punësimin dhe aftësimin profesional të fuqisë punëtore, në mënyrë që të krijojë vende pune cilësore dhe mundësi për punësim dhe aftësi në të gjithë ciklin e jetës. Plan i veprimit përqendrohet në rritjen e mundësive për punë të denjë, përmes politikave efikase të tregut të punës, sigurimit të arsimit dhe aftësimit cilësor të të rinjve dhe të rriturve, nxitjen e përfshirjes dhe kohezionit social dhe forcimin e tregut të punës dhe sistemit të kualifikimeve. Në përputhje me vizionin e qeverisë, kjo strategji e shikon aftësimin profesional dhe punësimin të lidhura së bashku, me qëllimin e ofrimit të shërbimeve të arsimit dhe formimit profesional të lidhura ngushtë me punësimin.

Në këndvështrimin e planit të veprimit të SKPA-së, reformat synojnë:

Të mundësojnë një profilizim më të mirë të punëkërkuesve përmes sistemit të rinovuar të informacionit të SHKP dhe hartimit të planeve individuale të punësimit. Rishikimi i programeve të nxitjes së punësimit për t'ju përgjigjur më mirë nevojave të punëkërkuesve të papunë,

veçanërisht grupeve më të cenueshme dhe harmonizimin e bashkëveprimeve dhe ndërhyrjeve të SHKP, Shërbimit Social Shtetëror dhe autoriteteve lokale.

10. Aktivitetet e planifikuara

d) Aktivitetet e planifikuara më 2020-ën:

- plani i punës 3-vjeçare i SHKP, 2020-2022, i zhvilluar në përputhje me SKPA-në të rishikuar 2019–2022 dhe funksionet e reja të agjencisë;
- protokollet dhe mjetet e shërbimit, bazuar në modelin e shërbimit me tri nivele, të projektuar dhe sistemin e IT-së, që profilizojnë në mënyrë adekuate punëkërkesit e regjistruar është i vendosur;
- moduli i ri i profilizimit në sistemin e informacionit është funksional dhe objektivat vjetorë janë të derivuara, sistemi i adresimit të synimeve është krijuar dhe ka filluar të ndërtohet metodologjia e planit të punësimit;
- programe të reja dhe të rishikuara të nxitjes së punësimit, në përputhje me ligjin e ri të nxitjes së punësimit 15/2019, synojnë të mbështesin grupet më të cenueshme dhe punëkërkesit e papunë të regjistruar, që përfitojnë nga këto programe;
- marrëveshje bashkëpunimi të nënshkruara me të paktën 3 bashki në zonat e pambuluara;
- sistemi i referimit të punëkërkesve në QFP është i vendosur.

e) Aktivitetet e planifikuara më 2021-shin:

- zbatimi i programeve të nxitjes së punësimit, me synimin që të mbështesin grupet më të cenueshme dhe aktivizimin, si dhe numri i punëkërkesve të regjistruar të papunë që përfitojnë nga programet e promovimit të punësimit synohet të arrijë në 6,7%;
- zbatimi i marrëveshjeve të nënshkruara me bashkitë në zonat e pambuluara;
- maksimizimi i bashkëveprimit dhe përmirësimi i shënjestrimit të politikave aktive të tregut të punës dhe zbatimi i paketës së përgatitur të arsimit dhe formimit profesional.

f) Aktivitetet e planifikuara më 2022-shin:

- përmirësimi i cilësisë dhe i efektivitetit të institucioneve dhe shërbimeve të tregut të punës, përmes rritjes së performancës së stafit;
- zhvillimi dhe publikimi i informacionit dhe analiza e cilësisë së tregut të punës dhe përmirësimi i marrëdhënieve me publikun;
- zbatimi i programeve të nxitjes së punësimit që synojnë mbështetjen e grupeve më të prekshme dhe aktivizimin dhe numri i punëkërkesve të regjistruar të papunë që përfitojnë nga programet e nxitjes së punësimit është targetuar të arrijë në 7%.

11. Indikatorët e rezultateve

Indikatori	Bazë (viti)	Objektivi i ndërmjetëm (viti)	Objektivi (viti)
Rritja e kualifikimit të punëkërkesve të papunë	50%	60%	65%
Rritja e punësimit të të papunëve nëpërmjet shërbimeve të ndërmjetësimit për punësim	28%	38%	43%
Rritja e pjesëmarrjes së punëkërkesve të papunë në programet e nxitjes së punësimit	6,4%	6,7%	7,0%

12. Ndikimi i pritshëm në konkurrueshmëri

Masa e reformës synon të përmirësojë aftësitë dhe kualifikimet e të papunëve; si pasojë rritet cilësia e forcës së punës. Në planin afatmesëm dhe afatgjatë, masa pritet të ndihmojë në tërheqjen e investimeve të huaja direkte, pasi një fuqi punëtore e aftë u përket faktorëve më të rëndësishëm të vendndodhjes.

13. Kostoja e parashikuar e aktiviteteve dhe burimi i financimit

	2020	2021	2022
	Parashikimi në EUR	Parashikimi në EUR	Parashikimi në EUR

Punësimet e realizuara nga zyrat e punësimit nëpërmjet ndërmjetësimeve	2,565,671	2,627,975	2,606,932
Zbatimi i programeve të nxitjes së punësimit	4,538,703	4,951,312	4,951,312
Trajnimi në QFP	2,414,523	2,430,615	2,438,785
Pagesa e papunësisë	4,621,225	4,951,312	4,951,312
Investimet	1,246,080	1,246,080	1,246,080
Shpenzime të tjera administrative	713,814	717,940	730,814
Totali	16,100,016	16,925,235	16,925,235

14. *Ndikimi i pritshëm në rezultatet sociale, si: punësimi, ulja e varfërisë, barazia dhe gjinia*

Ulja e papunësisë dhe pasivitetit të lartë, veçanërisht në grupin e të rinjve dhe grave. Rritja e kënaqësisë së grave dhe vajzave të përfshira në programe aktive të tregut të punës.

15. *Ndikimi i pritshëm në mjedis*

Masa është neutrale për sa i përket ndikimit në mjedis.

16. *Rreziqet e mundshme*

Rreziku	Probabiliteti (i ulët, i lartë)	Veprimi i planifikuar për uljen e rrezikut
